



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 476 Akti**

**Nr. 497 Vendimi**  
**Tiranë, më 13.1.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Alma Faskaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Relatore</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, më 11.1.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (Ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Artan Lulaj**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të

paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Lulaj, aktualisht me funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, Artan Lulaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët znj. Genta Tafa (Bungo), z. Lulzim Hamitaj dhe znj. Alma Faskaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja znj. Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e datës 19.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues zoti Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Artan Lulaj.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Lulaj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Lulaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- c) ka mosdeklarim të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, raportin<sup>2</sup> e vlerësimit të figurës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret, të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 3.12.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Lulaj; si dhe njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

15. Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike të datës 10.12.2021 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë, apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

16. Subjekti, në datën 29.12.2021 dhe në datën 10.1.2022, dërgoi nëpërmjet postës elektronike parashtrime në lidhje me rezultatet e hetimit, si dhe paraqiti prova e dokumentacion mbështetës.

17. Pas administrimit të parashtrimeve të subjektit, provave dhe dokumentacionit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>4</sup>.

## II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 11.6.2021.

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2018.

<sup>2</sup> Deklasifikuar me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë 26.5.2021.

<sup>3</sup> Me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2021.

<sup>4</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 6.1.2022.

**19.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 11.1.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic.

**20.** Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Lulaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**21.** Z. Artan Lulaj nuk ka qenë plotësisht bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Ai është përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, por përgjigjet e tij nuk kanë qenë të plota. Ai ka tentuar të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij dhe të personit të lidhur gjatë hetimit administrativ, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato. Trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka pasur për qëllim që procesi i kontrollit të verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të tij. Kjo mungesë bashkëpunimi, për të cilën është kryer një vlerësim i posaçëm më poshtë, e ka vendosur Komisionin në kushtet e pamundësisë për kryerjen e plotë e të detajuar të procesit të rivlerësimit.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**22.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**23.** Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017<sup>5</sup> dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**24.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shpresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shpresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me

---

<sup>5</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; dhe (g) shpjegimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore.

## **VLERËSIMI I PASURISË**

**25.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

**26. Apartament banimi<sup>6</sup>** me sip.117 m<sup>2</sup>, ndodhur në Njësinë Administrative nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, pallati “\*\*\*”, hyrja \*\*\*, ap. \*\*, Tiranë. Pjesa takuese 50%.

**26.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** blerë me të ardhurat e siguruara nga puna si noter; shitja e apartamentit të banimit dhe dy sipërfaqeve trualli në qytetin e Sarandës (shih tek konfidenciali). Vlera e apartamentit 3.950.000 lekë.

### **27. Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- i. deklarim i pasaktë lidhur me vlerën e apartamentit me sip. 117 m<sup>2</sup>, me adresë: \*\*\*, Tiranë, pasi në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës 2003, është deklaruar vlera 6.000.000 lekë, ndërsa referuar kontratës së shitblerjes vlera është 3.950.000 lekë;
- ii. subjekti ka deklaruar se në vitin 2001 ka shpenzuar shumën 2.000.000 lekë për rregullimin e apartamentit. Nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen dhe për shpenzimet e kryera;
- iii. nuk ka paraqitur dokumentacionin e porositjes/blerjes së apartamentit në vitin 2001;
- iv. subjekti nuk ka deklaruar pasurinë “truall” me sip. 662 m<sup>2</sup>, në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës 2003 dhe shitjen e kësaj pasurie në deklaratën e interesave privatë periodike vjetore 2004.

### **28. Hetimi<sup>7</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

#### **A) Në lidhje me çmimin dhe saktësinë e deklaramit**

**28.1.** Në datën 15.7.2004, subjekti së bashku me bashkëshorten e tij kanë nënshkruar kontratë shitjeje apartamenti nr. \*\*\*, për blerje apartament me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, kundrejt shumës 3,950,000 lekë.

**28.2.** Subjekti në deklaratën “Vetting”, tek të dhënat konfidenciale, në lidhje me këtë apartament, ka deklaruar se ka shpenzuar shumën 2,000,000 lekë në vitin 2001 për një rindarje të brendshme të apartamentit.

**28.3.** Në DPV/2003, në deklaramin për herë të parë, subjekti ka deklaruar se çmimi i këtij apartamenti është 6,000,000 lekë.

---

<sup>6</sup> Subjekti ka depozituar: kontratë shitjeje apartamenti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.7.2004; certifikatë për vërtetim pronësie, datë 18.10.2006; kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.9.2001; kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.1.2002; kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.12.2001; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 4.11.2003.

<sup>7</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021 drejtuar ASHK-së, Drejtoria Vendore Sarandë; kthim përgjigjeje nr.\*\*\* prot., datë 8.9.2021; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2021 drejtuar ASHK-së Drejtorisë Vendore Tirana Jug; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar UK-së Tiranë; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar OSHEE-së; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2020; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021 drejtuar KESH-it; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021, drejtuar ASHK-së Drejtorisë Vendore Tirana Jug; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021 drejtuar shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k; kthim përgjigjeje A.N., datë 30.9.2021.

**28.4.** Të njëjtën vlerë subjekti e ka konfirmuar edhe para ILDKPKI-së<sup>8</sup> në datën 3.3.2016, ku ka deklaruar se *ky apartament është blerë prej tij në vlerën 6,000,000 lekë, ashtu siç ka deklaruar. Vlera 3,950,000 lekë është vendosur nga firma ndërtuese e këtij apartamenti. Ai sqaron se fillimisht është lidhur një kontratë sipërmarrjeje dhe çmimi i përcaktuar ka qenë 6,000,000 lekë.*

**28.5.** Vlera 6,000,000 lekë e deklaruar nga subjekti përputhet dhe me çmimin e referencës të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave, ku sipas udhëzimit nr. 5, datë 31.5.2001, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit *k*”, çmimi në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2001, në Tiranë, është 56,306 lekë/m<sup>2</sup>. Apartamenti i subjektit, bazuar në këtë çmim, kushton 6,587,802 lekë, vlerë e cila është e përafërt me atë të deklaruar nga subjekti në deklaratën për herë të parë, si edhe përpara ILDKPKI-së.

**28.6.** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021, në lidhje me mospërputhjen e vlerës së çmimit të apartamentit, ka sqaruar se *me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., ka lidhur kontratën për blerjen e apartamentit të mësipërm, në shumën 3,950,000 lekë, dhe për arsye të nevojës së përmirësimit të cilësisë së punimeve elektrike, hidraulike dhe hidrosanitare ka kërkuar nga shoqëria e ndërtimit kryerjen e punimeve të mëtejshme, të cilat kanë qenë në vlerën rreth 2,000,000 lekë.*

**28.7.** Subjekti, në këtë pyetësor, për herë të parë, ka deklaruar faktin se *në vitin 2014 ka shpenzuar shumën 2,000,000 lekë për rindarje e apartamentit, për shkak të nevojës së krijimit të kushteve më optimale, pasi fëmijët ishin të rritur dhe ishin në prag punësimi. Duke qenë se babai i tij, ka qenë me profesion inxhinier ndërtimi, drejtimi i punimeve si dhe kontaktet me subjektet ndërtuese janë kryer prej tij. Shuma e këtyre punimeve është në vlerën 2,000,000 (dy milionë) lekë.*

**28.8.** Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi mospërputhje në deklaratimet e mësipërme të subjektit me ato të bëra në deklaratën “Vetting”, pasi në seksionin “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar se ka shpenzuar 2,000,000 lekë në vitin 2001 për rindarje të brendshme të apartamentit, por nuk rezulton të ketë deklaruar se në vitin 2014 ka kryer rikonstruksion të këtij apartamenti. Gjithashtu subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në DPV/2014 se ka shpenzuar shumën 2,000,000 lekë për rindarjen e apartamentit.

**28.9.** Në lidhje me këto mospërputhje, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 20.9.2021, ka deklaruar se *ka bërë lapsus në deklaratimin e qëllimit të përdorimit të shumës prej 2,000,000 (dy milionë) lekësh në vitin 2001, në deklaratën “Vetting”, e cila është përdorur për përmirësimin e punimeve. Rindarja e apartamentit është kryer në vitin 2014, provuar kjo nga leja për kryerjen e punimeve e lëshuar nga Njësia Administrative nr. \*\*\*, Tiranë, si dhe nga transferimi i fondit nga llogari depozite në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes së tij, në “\*\*\*\*” ku pasqyrohet qartë qëllimi i transferimit (rikonstruksion shtëpie).*

**28.10.** Zoti A.N., administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në lidhje me çmimin e apartamentit dhe pagesat e kryera, ka informuar Komisionin se kontrata e shitblerjes ka pasur vlerën 3,950,000 lekë, ndërsa vlera prej 2,000,000 lekësh janë punime të kryera me investimin e klientit (subjektit) për rritjen e cilësisë së materialeve dhe punimeve të kryera brenda ambienteve të shtëpisë. Pagesa për apartamentin është bërë me këste, vërtetuar me mandatet si më poshtë:

- a) Mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 30.5.2001; vlera 13.000 USD;
- b) Mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 6.9.2001; vlera 15.000 USD;
- c) Mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 26.9.2001; vlera 8.000 USD;
- d) Mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 14.11.2001; vlera 5.000 USD.

---

<sup>8</sup> Shih kthim përgjigjen e ILDKPKI-së nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2021.

Komisioni konstaton se në këto mandate është specifikuar pagesa për apartament 2+1, me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>, në katin e gjashtë të banimit, \*\*\*\*.

e) Mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 23.6.2001; vlera 230,000 lekë.

Komisioni konstaton se në këtë mandat është specifikuar pagesa për apartament 2+1 (Për ndryshime në muret e apartamentit etj), \*\*\*.

**28.11.** Bashkëlidhur shkresës, z. N. ka vënë në dispozicion:<sup>9</sup>

- i) mandatpagesat si më lart, për pagesën e kësteve të këtij apartamentit, si dhe një letër format A4 me emërtimin “Preventiv për Artan Lulaj”, firmosur nga ing. Y.Z., ku parashikohen punime shtesë në vlerën 1,967,080 lekë. Nga verifikimi i mandatpagesave rezulton se subjekti ka paguar a) në total shumën 41.000 USD (konvertuar me kursin e këmbimit mesatar në USD të vitit 2001 në vlerën 5,598,550.00 lekë), si pagesa për vlerën e apartamentit, shumë e cila përputhet dhe me deklaratimet e tij në DPV/2003 dhe përpara ILDKPKI-së, në lidhje me vlerën e apartamentit në shumën 6,000,000 lekë; dhe b) shumën 230,000 lekë për ndryshimet e kryera, ndërkohë që vlera e punimeve shtesë, bazuar në preventivin e depozituar nga z. N., është në shumën 1,967,080 lekë, shumë e cila përputhet dhe me deklaratimet<sup>10</sup> e subjektit në deklaratën “Vetting”.
- ii) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 17.9.2021 ku ai deklaron *se në vitin 2001 kanë rënë dakord me zotin Artan Lulaj për shitjen e një apartamenti në \*\*\*, Tiranë, me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup> kundrejt vlerës 3,950,000 lekë. Me kërkesën e subjektit në apartament janë kryer punime shtesë përtej vlerës së përcaktuar në kontratë, të cilat janë paguar nga porositësi....Vlera ekzakte nuk i kujtohet, por duhet të ketë qenë rreth 2,000,000 lekë dhe në shtator të vitit 2001 i ka dorëzuar apartamentin.*

**28.12.** Deklarimi i z. N. se për blerjen e apartamentit është paguar shuma 3,950,000 lekë, nuk përputhet me:

- i. mandatpagesat e depozituara nga ana e tij, ku për apartamentin është paguar shuma 41.000 USD (konvertuar me kursin e këmbimit mesatar në USD në vlerën 5,598,550.00 lekë) dhe jo shuma 3,950,000 lekë;
- ii. preventivin e punimeve shtesë në vlerën 1,967,080 lekë;
- iii. deklaratimet e subjektit në deklaratën e vitit 2003, por dhe në ILDKPKI, ku shprehimisht ka deklaruar se ka paguar shumën 6,000,000 lekë për blerjen e apartamentit.

**28.13.** Për pasojë, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” çmimin e blerjes së apartamentit në shumën 41.000 USD (përafërsisht 6,000,000 lekë).

**28.14.** Komisioni, në kushtet kur subjekti ka bërë deklarime kontradiktore në lidhje me vlerën reale të këtij apartamentit, me qëllim qartësimin e vlerës totale të paguar për blerjen e tij, si dhe të modaliteteve të pagesës (duke u bazuar në vetëdeklarimet e subjektit përpara ILDKPKI-së ku ai ka pranuar që çmimi 6,000,000 lekë është caktuar në kontratën e sipërmarrjes) i ka kërkuar subjektit, në dy pyetësorë, të vendosë në dispozicion kontratën e sipërmarrjes së këtij apartamenti, por nga subjekti është deklaruar se nuk disponon kopje të kësaj kontrate. Subjekti ka pasur të gjitha mundësitë për të administruar këtë kontratë, por ka refuzuar ta depozitojë atë, veprim i cili nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

**28.15.** Në përfundim të hetimit konstatohet se:

- i. subjekti nuk provon të ketë paguar shumën 3,950,000 lekë për blerjen e apartamentit;

---

<sup>9</sup> I njëjti dokumentacion është vënë në dispozicion dhe nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021 dhe 20.9.2021.

<sup>10</sup> Subjekti në lidhje me ndryshimet e kryera për këtë apartament ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, por dhe gjatë hetimit se ka shpenzuar shumën 2,000,000 lekë.

- ii. bazuar në mandatpagesat e depozituara rezulton se subjekti ka paguar shumën 41.000 USD (konvertuar me kursin e këmbimit mesatar në USD në vlerën 5,598,550.00 lekë) për blerjen e këtij apartamenti;
- iii. në deklaratën përpara fillimit të detyrës dhe në ILDKPKI, të cilat përbëjnë provë në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka deklaruar si vlerë të blerjes së apartamentit shumën 6,000,000 lekë;
- iv. subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se ka shpenzuar në vitin 2001 shumën 2,000,000 lekë për rindarje të brendshme të apartamentit;
- v. bazuar në preventivin e depozituar nga z. A.N., punimet shtesë përcaktohen në vlerën 1,967,080 lekë;
- vi. çmimi në tregun e lirë për këtë apartament, bazuar në udhëzimin nr. 5, datë 31.5.2001 të EKB-së, është në shumën 6,587,802 lekë.

**28.16.** Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit me arsyetimin se ka bashkëpunuar me shitësin e apartamentit, me qëllim shmangien nga pagimi i detyrimeve të plota tatimore të këtij të fundit. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti u ka qëndruar deklarimeve të mësipërme, sipas të cilave çmimi i shitjes është 3,950,000 lekë dhe vlera për punimet shtesë (punime elektrike, hidraulike dhe hidrosanitare), të kryera nga shoqëria ndërtuese është 2,000,000 (dy milionë) lekë.

**28.17.** Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit, të cilat ishin po të njëjtat të deklaruar gjatë hetimit administrativ, mbështetur në faktet e mëposhtme se:

i) subjekti, pranë ILDKPKI-së, ka deklaruar çmimin e këtij apartamenti në vlerën 6,000,000 lekë, ndërkohë në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se çmimi i këtij apartamenti ka qenë 3,950,000 lekë, duke iu referuar kontratës së shitblerjes, e cila ka shërbyer për efekt regjistrimi pranë ZVRPP-së, dhe se tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e kësaj pasurie është paguar sipas çmimit të shitjes të kësaj kontrate, që përfaqëson vlerën më të ulët të të ardhurave të “realizuara”;

(ii) nga mandatpagesat e depozituara gjatë hetimit administrativ rezulton se subjekti ka paguar për blerjen e këtij apartamenti shumën 41.000 USD, shumë e cila duhej të vendosej në kontratën e shitblerjes, por që sipas deklarimeve të subjektit përpara ILDKPKI-së nuk është pranuar të vendosej nga shoqëria ndërtuese;

(iii) subjekti nuk ka qenë bashkëpunues me Komisionin, duke mos vendosur në dispozicion kontratën e sipërmarrjes, dokument i cili do të zgjidhte përfundimisht paqartësitë e Komisionit në lidhje me çmimin real të këtij apartamenti;

krijon bindjen se mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese ka pasur një përputhje vullneti për të paraqitur përpara ZVRPP-së Tiranë, si çmim për transaksionin e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme objekt kontrolli, një vlerë më të vogël se ajo e realizuar dhe kjo, me qëllim shmangien e detyrimit tatimor mbi të ardhurat e realizuara.

**28.18.** Trupi gjykues vëren se apartamenti me të dhënat e mësipërme është blerë në vitin 2001, në vlerën 3.950.000 lekë, kohë e cila nuk ka pasur çmime reference të aplikueshme sipas zonave kadastrale. Në vitin 2001, kohë kur është blerë prona, aplikohet tatim për kalimin e së drejtës së pasurisë së paluajtshme, i cili, bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, llogaritet mbi totalin e çmimit të shitjes sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij ligji. Duke iu referuar vlerës së deklaruar në kontratë dhe tabelës<sup>11</sup> që i bashkëlidhet ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka preferuar të qëndrojë në vlerat minimale të pagimit të tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë, konkretisht në 1% tatim të çmimit të shitjes. Nga ana tjetër, duke u bazuar në udhëzimin nr. 5, datë 31.5.2001, të EKB-së, nga një përlllogaritje e sipërfaqes së apartamentit të mësipërm, rezulton në vlerën 6,587,802 lekë, një vlerë që është pothuajse dyfish me e ulët se çmimi i caktuar në kontratë. Nga kjo diferencë e konsiderueshme mes çmimit të përcaktuar

<sup>11</sup> 2, 000, 000 + 4, 000, 000, 1% çmimit të shitjes; 4, 000, 000 + 6, 000, 000, 2% çmimit të shitjes.



në kontratë dhe çmimit që rezultojnë në tregun e lirë në vitin 2001 për Tiranën, trupi gjykues çmon se duhet të ketë pasur dakordësinë mes palëve për të shkruar në kontratë një çmim më të ulët, të cilit i korrespondon minimumi i tatimit mbi fitimin.

**28.19.** Për sa më sipër rezultojnë e provuar ekzistenca e një çmimi fiktiv në kontratën e shitblerjes ose e një deklarimi të pamjaftueshëm në ILDKPKI, si dhe në deklaratën “Vetting”, pasi çmimi është pasqyruar gati më pak se dyfishi i atij që rezultojnë të jetë paguar nga subjekti. Këto veprime rezultojnë të jenë kryer në mosrespektim të ligjit nr. 9049, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 që, për rrjedhojë, çojnë në aplikimin e nenit 61, pika 3 e po këtij ligji<sup>12</sup>.

**29.** Në lidhje me mosdeklarimin e shumës 2,000,000 lekë në DPV/2014, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 20.9.2021 sqaron se *nisur nga fakti që këto punime janë realizuar pjesë – pjesë dhe kosto për çdo lloj punimi të kryer, ka qenë nën vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë, ai nuk i ka deklaruar shpenzimet. Ai nuk ka pasur arsye të fshehtë shpenzimin e kryer (në vlerën totale 2,000,000 lekë), sepse të ardhurat e përdorura për mbulimin e këtyre shpenzimeve janë likuiditete të tërhequra nga llogaria bankare nr. \*\*\*, në emër të bashkëshortes së tij pranë \*\*\*\*. Në lidhje me preventivin sqaron se disponon vetëm një kopje të panëshkruar, për shkak se drejtimi i punimeve dhe kontaktet me subjektet ndërtuese janë kryer nga babai i tij i ndjerë.*

**29.1.** Për të provuar pretendimet e tij, subjekti ka depozituar kthim përgjigjen e Njesisë Bashkiake nr. \*\*\*, me nr. \*\*\* prot., datë 28.8.2014, ku përcaktohet se: *“Z. Artan Lulaj është pronar i një banese në katin e tetë të pallatit \*\*\*\*”, në rrugën \*\*\*\*, ndërtim i viteve 2000. Nga vëzhgimi në vend rezultojnë se banesa ka shumë myk, si rezultat i lagështirës. Për sa më sipër, Njësia Bashkiake vihet në dijeni për punime riparuese brenda territorit të banimit.”*

**29.2.** Në kushtet kur subjekti, për herë të parë gjatë hetimit administrativ, deklaroi se kishte shpenzuar shumën 2,000,000 lekë në vitin 2014, për rikonstruksionin e apartamentit, me qëllim kryerjen e një analize financiare sa më të saktë, Komisioni i kërkoi subjektit të deklaronte kohën e përfundimit të punimeve. Në përgjigje të pyetësorit të datës 25.10.2021, subjekti ka deklaruar se punimet kanë përfunduar në mesin e muajit shtator 2014.

**29.3.** Si burim për rikonstruksionin e apartamentit në vitin 2014, subjekti ka deklaruar likuiditete të tërhequra nga llogaria bankare nr. \*\*\*, në emër të bashkëshortes së tij pranë \*\*\*\* sh.a.

**29.4.** Nga nxjerrja e kësaj llogarie rezultojnë se:

- i. Në datën 28.8.2014 është prishur depozita në shumën 3,050,000 lekë me shënim “Para afatit të maturimit për rikonstruksion shtëpie”;
- ii. Në datën 22.8.2014 bashkëshortja e subjektit ka tërhequr shumën 500,000 lekë;
- iii. Në datën 17.9.2014 bashkëshortja e subjektit ka tërhequr shumën 150,000 lekë;
- iv. Në datën 27.10.2014 bashkëshortja e subjektit ka tërhequr shumën 1,999,820 lekë.

**50.** Shuma e tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në fund të muajit tetor 2014, nuk mund të ketë shërbyer si burim për kryerjen e pagesave për rikonstruksionin e apartamentit, pasi nga ana e subjektit:

- i. është deklaruar se:
  - rikonstruksioni i apartamentit ka përfunduar në datën 17.9.2014;
  - punimet janë kryer pjesë-pjesë;
  - pagesat janë bërë *cash*; dhe
- ii. nuk është provuar me dokumentacion, dhe as nuk është deklaruar/pretenduar që pagesat janë kryer pas përfundimit të rikonstruksionit të banesës.

---

<sup>12</sup> I njëjti qëndrim është mbajtur nga KPA-ja në vendimin nr. 10, datë 18.4.2019 dhe nr. 20, datë 14.7.2021.

**29.5.** Për sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka qenë i saktë në deklarinimin e tij gjatë hetimit administrativ në lidhje me burimin që ka shërbyer për të mbuluar shpenzimet për rikonstruksionin e banesës.

**29.6.** Si rrjedhojë e konstatimeve të mësipërme, shuma prej 1,999,820 lekësh nuk është përfshirë në analizën financiare më poshtë për rikonstruksionin e apartamentit në vitin 2014:

	<b>17.9.2014</b>
<b>Pasuri</b>	<b>1,962,601.03</b>
<i>Shtesa / Pakësime likuiditete</i>	1,962,601.03
<b>Detyrime</b>	<b>275,397.41</b>
Shlyerje detyrimi i kredisë	275,397.41
<b>Pasuri neto</b>	<b>1,687,203.62</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>5,283,850.75</b>
Të ardhurat nga puna e subjektit	1,056,924.00
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	773,613.75
Të ardhura nga vendimi nr. ***, datë 25.5.2009, për largim të padrejtë nga puna	3,429,520.00
Të ardhurat e vajzave	23,793.00
<b>Shpenzime</b>	<b>4,555,478.40</b>
Shpenzime jetike	779,159.58
TIMS	276,318.82
Shpenzime për rindarje të apartamentit në shumën 2 milionë	2,000,000.00
Shpenzime mobilimi të apartamentit 114 m <sup>2</sup> gjatë vitit 2014	1,500,000.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-958,831.27</b>

**29.7.** Komisioni, në këtë analizë, nuk ka përfshirë shumën 1,000,000 lekë të deklaruar në deklaratën “Vetting”, të shpenzuar në vitin 2014, pasi subjekti ka pretenduar se kjo shumë është shpenzuar në vitin 2015, duke mos saktësuar kohën e kryerjes së këtyre shpenzimeve në vitin 2014 (për më shumë referohu në pikën 47.3 të këtyre rezultateve).

**29.8.** Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për rikonstruksionin dhe mobilimin e banesës në vitin 2014, në shumën 958,831.27 lekë. Subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**29.9.** Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka parashtruar të njëjtat pretendime si në rastin e mospërputhjes së çmimit të apartamentit dhe mosdeklarimit në shumës 2,000,000 në DPV/2014. Gjithashtu ka shtuar se *përfundimi i punimeve është realizuar në mes të shtatorit të vitit 2014 dhe pagesat për këto shpenzime janë kryer në muajin tetor 2014, sikundër vërtetohet edhe nga lëvizjet bankare. Ai ka pretenduar se nuk është shprehur se janë përdorur shumat cash të tyre, por pagesa është kryer cash.*

**29.10.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova, por mbeten thjesht në nivel deklarativ. Subjekti nuk ka depozituar asnjë provë për të provuar pretendimin e tij se pagesat janë kryer në fund të muajit tetor, kohë në të cilin apartamenti kishte më shumë se një muaj që kishte përfunduar. Vetë subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 20.9.2021, ka deklaruar se *rindarja e apartamentit është bërë në vitin 2014, siç provohet nga leja për kryerjen e punimeve dhe nga transferimi i fondit nga llogari depozite në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes në \*\*\*, ku përcaktohet edhe qëllimi i transferimit (rikonstruksion shtëpie), transaksion i kryer në datën 21.8.2014, në shumën 3,050,000 lekë /qeliza në font të kuq). Ky deklarinim i subjektit konfirmon faktin se pagesat janë kryer gjatë kohës së rikonstruksionit të apartamentit pasi, subjekti, si burim për pagesat, i referohet transferimit të shumës 3,050,000 lekë në datën 21.8.2014 dhe nuk rezulton të ketë deklaruar se këto pagesa janë kryer në fund të muajit tetor, apo të ketë deklaruar si burim tërheqjen e kryer në fund të muajit tetor.*

**29.11.** Duke marrë në konsideratë: (i) përgjigjet e subjektit gjatë hetimit administrativ; (ii) deklaratimet e tij se pagesat janë bërë pjesë-pjesë *cash*; (iii) kohën e përfundimit të punimeve në datën 17.9.2014; si dhe (iv) mungesën e provave shkresore për të provuar pretendimin e subjektit se pagesat janë kryer në muajin tetor; pagesat për rikonstruksionin e apartamentit do të konsiderohen të kryera në kohën e përfundimit të punimeve në shtator të vitit 2014.

**29.12.** Në konkluzion të kësaj analize, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën **-958,831.27 lekë** për rikonstruksionin dhe mobilimin e banesës në vitin 2014. Komisioni ka vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të mungesës së ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit, në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie në të gjitha elementet e saj.

**29.13.** Subjektit i është kërkuar në dy pyetësorë të deklarojë vlerën e mobilimit të këtij apartamenti në vitin 2001, por ai nuk është kthyer një përgjigje, duke penguar Komisionin në kryerjen e një analize të plotë financiare për këtë apartament, veprim i cili nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

**29.14.** Lidhur me këtë fakt, subjekti ka pretenduar se nuk është e vërtetë që ka refuzuar të bëjë deklaratimin mbi shpenzimet e mobilimit, por nuk është shprehur për këto, pasi shpenzime të tilla, të një vlere të konsiderueshme për t'u deklaruar, nuk ka pasur. Ai ka sqaruar se janë transferuar nga qyteti i Sarandës për në qytetin e Tiranës për qëllime banimi dhe, me shitjen e apartamentit në Sarandë, kanë transferuar dhe marrë me vete edhe mobiljet që kanë disponuar atje. Sipas subjektit, ata nuk kanë kryer asnjë shpenzim të konsiderueshëm në momentin e futjes në apartament, përveçse investimit të kryer për pajisjet sanitare, hidraulike etj., të deklaruara prej tij.

**29.15.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse, si dhe nuk përputhen me deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ. Subjekti në pyetësorin standard ka deklaruar se *mobilitimi i apartamentit në të cilin banon aktualisht është kryer në muajin shtator të vitit 2001; vlera nuk i kujtohet. Gjithashtu, nuk kujton detaje mbi emrat e firmave të shitjes, por deklaroi se një pjesë e mobilieve janë blerë në mobilieri në qytetin e Tiranës dhe një pjesë e tyre janë bërë me porosi.* Në pyetësorin e datës 7.9.2021, subjekti ka deklaruar se *mobilitimi është kryer pas hyrjes në apartamentin e sipërpërmendur, por nuk disponon të dhëna për vlerën e tij.*

**29.16.** Komisioni vlerëson se subjekti, me qëllim shmangien e një analize të mirëfilltë financiare, fillimisht, nuk ka deklaruar vlerë mobilimi, ndërsa pas kalimit të barrës së provës, ai ka ndryshuar deklaratimin, duke pretenduar se ka marrë me vete mobiljet nga apartamenti në qytetin e Sarandës, por pa specifikuar cilat prej tyre. Komisioni vlerëson se këto ndryshime në deklaratim duhet të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti ka bërë përpjekje për të mos pasqyruar saktë vlerën e mobilimit.

## **B) Në lidhje me aftësinë financiare të subjektit për blerjen e apartamentit**

Si burim për blerjen e apartamenti subjekti ka deklaruar:

### **A. Të ardhurat e siguruar nga puna si noter**

**30. Konstatimi i ILDKPKI-së:** nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me të ardhurat nga aktiviteti privat si noter, deklaruar në shumën 12.000.000 lekë.

**31.** Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti si noter në qytetin e Sarandës, për periudhën gusht 1994 -30.11.2000, në dijeninë e tij, nisur nga tatimi që ka paguar në shumën 12,000,000 lekë.

**31.1.** Nga aktet e administruara nga Komisioni në lidhje me aktivitetin si noter të subjektit të rivlerësimit rezulton se:

- i. bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2017, të DRT-së Sarandë, administruar në dosjen e ILDKPKI-së rezulton se subjekti është regjistruar me vendimin e Gjykatës së

Rrethit nr. \*\*\*, datë 8.9.1994, me aktivitet “noter”. Nga aktet tatimore rezulton se ka paguar tatim mbi të ardhurat si më poshtë:

Viti 1995-38,160 lekë;  
Viti 1996- 39,169 lekë;  
Vitet 1998- 60,000 lekë;  
Viti 1999-70,000 lekë.

Për periudhën e ushtrimit të aktivitetit nuk disponohen të dhëna për xhiron dhe fitimin e realizuar ndër vite, pasi subjekti nuk kishte detyrimin ligjor për të bërë pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Për vitin 1997 nuk disponohen të dhëna.

- ii. Bashkia Sarandë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2017, (administruar nga ILDKPKI-ja) informon se subjekti nuk ka pasur të regjistruar pranë Bashkisë Sarandë biznesin e noterit për periudhën deri më 27.1.2017;
- iii. Dega e Sigurimeve Shoqërore Sarandë<sup>13</sup> ka vendosur në dispozicion të Komisionit vërtetim për bazën e vlerësueshme të ardhurave të realizuar nga z. Lulaj për periudhën 1994-2000, si dhe dokumentacion nga arkiva e saj;
- iv. Subjekti, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit të noterit në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021, ka vënë në dispozicion:
  - Vërtetim nga Bashkia Sarandë, datë 13.9.2021, me anë të cilit vërtetohet se z. Artan Lulaj, me profesion noter, ka kryer aktivitet në Bashkinë Sarandë, lagjja nr. \*\*\*, prej vitit 1994-2000 dhe nuk ka detyrime fiskale kundrejt Bashkisë Sarandë.
  - Shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, ku rezulton se subjekti është regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit nr. \*\*\* , datë 8.9.1994, si noter, dhe ka paguar detyrimet si më poshtë:

Viti 1995-38,152 lekë;  
Viti 1996- 38,160 lekë;  
Viti 1997- 28,000 lekë;  
Viti 1998- 67,500 lekë  
Viti 1999- 70,000 lekë

Për vitin 2000 nuk ka të dhëna manualisht dhe as në sistemin tatimor.

**31.2.** Komisioni, me qëllim verifikimin e saktë të xhiros së subjektit, i ka kërkuar në pyetësorin e datës 7.9.2021, të vërë në dispozicion kopje të regjistrave të noterisë të viteve 1994-2000, të certifikuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Subjekti ka deklaruar se i është drejtuar Dhomës Kombëtare të Noterëve për t'i vënë në dispozicion këto regjistra, por deri në datën e pyetësorit nuk janë administruar.

**31.3.** Komisioni kreu një analizë financiare për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i noterisë për periudhën 1994-2000, bazuar në të dhënat për tatimin e paguar në organet tatimore. Këto të ardhura janë përlllogaritur si më poshtë:

- i. Qarkullimi i konsideruar ose i përlllogaritur nga aktiviteti si noter:
  - o Për vitet 1995-1997: për të nxjerrë qarkullimin e biznesit të vogël, Komisioni është bazuar në vlerën e detyrimeve tatimore të paguara.
  - o Për vitet 1998-1999 qarkullimi është përlllogaritur në bazë të detyrimeve tatimore të paguara, duke u bazuar në legjislacionin fiskal në fuqi dhe deklaratat e subjektit mbi xhiron, në deklaratat e tij pranë organeve tatimore.
  - o Për vitet 2000 organet tatimore nuk konfirmojnë pagesë të detyrimeve përkatëse nga subjekti i rivlerësimit.
- ii. Llogaritja e fitimit nga aktiviteti si noter:

---

<sup>13</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.7.2021.

Për të llogaritur fitimin e subjektit nga ushtrimi i aktivitetit si noter është konsideruar një *marzh fitimi* në masën 75% <sup>14</sup>mbi qarkullimin e deklaruar/ vlerësuar për periudhën 1994 -1999, bazuar në praktikën e aplikuar nga Komisioni në rastet e ngjashme.

Vitet	Deklaruar në Organin tatimor	Paguar tatim/taksa	Paguar detyrime në %	Qarkullimi i llogaritur	Marzhi i fitimit	Fitimi i përlllogaritur
1.8.1994						0
1995		38,152	5%	763,040	75%	572,280.00
1996		38,160	5%	763,200	75%	572,400.00
1997		28,000	4%	700,000	75%	525,000.00
1998		67,500		1,687,500	75%	1,265,625.00
1999	1,900,000.00	70,000		1,900,000	75%	1,425,000.00
Total	<b>1,900,000.00</b>	<b>241,812.00</b>		<b>5,813,740.00</b>		<b>4,360,305.00</b>

**31.4.** Nga analiza e kryer rezulton se në total subjekti i rivlerësimit nga aktiviteti si noter mund të ketë realizuar të ardhura në shumën 4,360,305 lekë, shumë e cila nuk përputhet me të ardhurat e deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting” në shumën 12,000,000 lekë.

**31.5.** Për pasojë, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar me dokumentacion të ardhurat e përfituara nga aktiviteti si noter në shumën 12,000,000 lekë.

**31.6.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se ka bërë vazhdimisht përpjekje për të tërhequr regjistrat, të cilët sipas informacionit nga Dhoma Kombëtare e Noterëve i kishin kaluar noterit A.A. dhe i janë vënë në dispozicion subjektit në momentin e dërgimit të rezultateve të hetimit. Me dorëzimin e këtyre regjistrave në vijim të parashtrimeve, subjekti ka pretenduar se provohet qartësisht se të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i noterit, përgjatë viteve 1991-2000, janë shumë më të larta se konkluzioni i dalë prej Komisionit.

**31.7.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe dokumentacionin provues të vendosur në dispozicion nga ana e tij, pas kalimit të barrës së provës, vendosi të korigjojë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar si noter i subjektit për vitin 1996, duke u bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, nga ku rezulton se për vitin 1996 subjekti ka paguar detyrimet tatimore në masën 77,328 lekë. Pas kësaj rillogaritjeje, të ardhurat totale të subjektit nga aktiviteti i noterisë janë në shumën 4,947,825.00 lekë.

**31.8.** Komisioni vlerëson se është e pamundur të llogariten të ardhurat e mundshme për vitet 1994 dhe 2000, bazuar në regjistrat noterialë të paraqitur, pasi mungon kolona e çmimit, e cila rezulton të mos jetë fotokopjuar nga subjekti.

**31.9.** Përpos këtij fakti, për sa kohë nuk është depozituar dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve tatimore për vitet 1994 dhe 2000, rezulton se nuk përmbushen standardet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për rrjedhojë, edhe sikur subjekti të kishte krijuar të ardhura, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme. Ky qëndrim i Komisionit mbështetet dhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>15</sup>.

**31.10.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të aktivitetit të noterisë, të cilat përmbushin standardet e ligjshmërisë, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, nuk

<sup>14</sup> Referuar vendimit të Komisionit nr. 339, datë 19.1.2021; vendimit nr. 40, datë 17.7.2018; vendim nr. 64, datë 10.9.2018.

<sup>15</sup> Vendimet nr. 3, datë 17.7.2018; nr. 4, datë 25.10.2018; nr. 6, datë 13.9.2018; nr. 9, datë 24.10.2018

përputhen në vlerë me të ardhurat e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë “Vetting”. Deklarimi i subjektit në këtë rast vlerësohet nga trupi gjykues si deklarim i pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, referuar parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016<sup>16</sup>.

## **B. Shitja e apartamentit të banimit në qytetin e Sarandës**

**32.** Subjekti, me kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 28.9.2001, ka shitur një apartament banimi me sip.70 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Sarandë, lagjja nr. \*\*\*, ap.\*\*\* (1+1). Çmimi i shitjes 1,500,000 lekë, shumë e cila është paguar tërësisht nga blerësi kundrejt shitësit, jashtë zyrës noteriale. Kjo pasuri është përfituar nga subjekti me privatizim.

**32.1.** Nga analizimi i mandatpagesave për blerjen e apartamentit në qytetin e Tiranës rezulton se vetëm shuma 5.000 USD<sup>17</sup> është paguar pas shitjes së këtij apartamenti. Për rrjedhojë, vlera e përfituar nga shitja e apartamentit në qytetin e Sarandës nuk mund të ketë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë.

**32.2.** Subjektit i është kërkuar të vërë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve tatimore nga të ardhurat e përfituara nga diferenca midis çmimit të blerjes dhe të shitjes të kësaj pasurie. Në përgjigje të pyetësorit të datës 25.10.2021, subjekti ka sqaruar se *bazuar në nenin 11, pika 2 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet pa u provuar më parë pagimi i detyrimit, por subjekti gjendet në pamundësi objekti për të gjetur dokumentacionin justifikues të pagesës së detyrimit. Subjekti pretendon se detyrimi i pagesës së tatimit provohet nga shkresa nr. prot. \*\*\*, datë 23.9.2021, bashkëlidhur pyetësorit të dytë, bashkëlidhur së cilës gjendet “kopje e dokumentacionit për procedurën e asgjësimit të aplikimeve dhe mandatpagesave”. Më tej ka saktësuar se kontrata midis palëve nuk është lidhur më 28.9.2021, por më 28.1.2001, duke saktësuar kështu një lapsus në datë të bërë nga ata.*

**32.3.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe shkresën e ASHK-së, Drejtoria Vendore Sarandë, të depozituar nga ai, konstaton se në dokumentacionin që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj prone<sup>18</sup>, nuk rezulton të jetë depozituar dokument që vërteton pagimin e detyrimeve tatimore nga subjekti i rivlerësimit, për rrjedhojë nga ai nuk është provuar që janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie si diferencë çmim shitjeje/çmim blerjeje.

**32.4.** Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se:

- i. apartamenti i banimit në Sarandë është shitur më vonë se pagesat e kryera nga subjekti për apartamentin me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>;
- ii. subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues pagesën e detyrimeve tatimore në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të banimit në qytetin e Sarandës;

nuk do të përfshijë në analizë financiare për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup> shumë e përfituar nga shitja e kësaj pasurie.

**32.5.** Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe ka dhënë të njëjtat shpjegime, siç janë pasqyruar në pikën 32.2. të këtij vendimi.

**32.6.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato nuk janë bindëse. Subjekti nuk arriti të provojë pagimin e detyrimeve tatimore për këtë apartament. Në seancë dëgjimore subjekti u pyet nëse kishte mundësi që të provonte datën kur kishte marrë paratë nga shitja e apartamentit dhe dy trojeve në qytetin e Sarandës. Ai sqaroi se për shkak të kohës të gjatë, datë të saktë, kur i ka marrë këto para nga blerësit, nuk mund të japë. Subjekti ka sqaruar se në vitet 2000-2001 ka qenë në kushte emergjente për strehim dhe nisur nga fakti që ka hyrë

<sup>16</sup> I njëjti qëndrim është mbajtur dhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelitimit në vendimin nr. 20, datë 14.7.2021.

<sup>17</sup> Mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 14.11.2001.

<sup>18</sup> Shih shkresën kthim përgjigjeje të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nr. \*\*\*, datë 9.10.2017, gjendur në dosjen e ILDKPKI-së.

në atë banesë në shtator 2001, ka bërë dhe gjithë likuidimet po para asaj periudhe. Në lidhje me kohën e prenotimit të këtij apartamenti subjekti në seancë dëgjimore deklaroi se e ka prenotuar kur ka ardhur në Tiranë, rreth muajit shkurt të vitit 2001.

**32.7.** Deklarimet e subjektit në lidhje me kohën e marrjes së parave janë kontradiktore, pasi ai pretendon se shumata janë marrë gjatë vitit 2000 -2001, ndërkohë që prenotimin e apartamentit e ka bërë në vitin 2001. Është e paqartë se cila ka qenë arsyeja që subjekti mund të ketë shitur këto pasuri në vitin 2000, ndërkohë që ai ende nuk kishte ardhur në Tiranë, apo të kishte prenotuar apartamentin objekt hetimi.

**32.8.** Komisioni, bazuar dhe në përgjigjen e subjektit në seancë dëgjimore, të cilat janë kontradiktore, vlerëson se edhe sikur subjekti të provonte pagimin e detyrimeve tatimore, për sa kohë subjekti nuk provoi me dokumentacion se të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit në qytetin e Sarandës janë përfituar para kryerjes së pagesave të apartamentit në qytetin e Tiranës, e bëjnë të parëndësishëm faktin nëse për këto të ardhura janë paguar ose jo detyrimet tatimore. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson të mos përfshijë në analizë financiare këto të ardhura.

**32.9.** Në përfundim të kësaj analize, Komisioni çmon se gjendemi të paktën para plotësimit të deklaratës “Vetting” jo në përputhje me kërkesat e ligjit, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë, për pasojë, zbatimi i nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, që e konsideron deklaratën “Vetting” të saktë, nuk gjen zbatim. Komisioni çmon të vlerësojë këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kësaj pasurie.

### **C. Shitja e dy trojeve në qytetin e Sarandës**

**33.** Subjekti, me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 9.1.2002, ka shitur një sipërfaqe truall prej 314 m<sup>2</sup>, për ndërtim (hotel turizëm), të ndodhur në Sarandë, lagjja nr. \*\*\*, kundrejt shumës 500.000 lekë.

**33.1.** Nga analizimi i mandatpagesave për blerjen e apartamentit në qytetin e Tiranës rezulton se pagesat për këtë apartament janë kryer të gjitha gjatë vitit 2001. Për rrjedhojë, vlera e përfituar nga shitja e truallit me sipërfaqe 314 m<sup>2</sup> në qytetin e Sarandës nuk mund të ketë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë.

**33.2.** Nga hetimi për këtë truall ka rezultuar se:

- i. subjektit, në cilësinë e investitorit të sheshit të ndërtimit, me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë, të datës 28.8.1999, i është dhënë sipërfaqja 314 m<sup>2</sup>, ndodhur në bllokun \*\*\*, parcela \*\*\*.
- ii. në datën 18.5.2001 është mbajtur procesverbali i piketimit, firmosur nga subjekti i rivlerësimit.
- iii. në datën 18.9.1999 është lëshuar leje për ndërtim të përkohshëm me objekt “rrethim truall”.
- iv. me vendimin nr. \*\*\* të KRRT-së, datë 20.12.1999, është lëshuar leja e ndërtimit në emër të subjektit ndërtues “\*\*\*\*” sh.p.k., për hotel në zonën e turizmit, \*\*\*. Investitor rezulton subjekti i rivlerësimit.
- v. në datën 21.12.2001 është nënshkruar kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 21.12.2001, me Bashkinë Sarandë për blerjen e këtij truall kundrejt shumës 105,720 lekë, e cila referuar kësaj kontrate është likuiduar tërësisht nga subjekti sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 12.12.2001.
- vi. në dokumentet e ZVRPP-së Sarandë gjendet një mandatarkëtimi, paguar nga subjekti në favor të Bashkisë Sarandës, i datës 18.12.2001, në shumën 56,212 lekë me emërtim “blerje truall/leje ndërtimi”.

**33.3.** Subjekti është pyetur në lidhje me marrëveshjen e lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe vlerën e ndërtimit për të cilin është pajisur me leje, ku ai vetë cilësohet investitor. Ai është

mjaftuar duke u përgjigjur se nga ai nuk është ndërtuar asnjë hotel, si dhe i është drejtuar Bashkisë Sarandë për informacion.

**33.4.** Subjekti, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me Komisionin, duke sqaruar çdo paqartësi për të cilën Komisioni e pyet. Në rastin e trullit me sipërfaqe 314 m<sup>2</sup>, subjekti ka refuzuar të kthejë përgjigje, pavarësisht faktit se ai ka bërë dhe pagesën përkatëse për lejen e ndërtimit. Moskthimi i përgjigjes nga subjekti është bërë pengesë për Komisionin për të kryer një llogaritje të saktë të analizës financiare të subjektit për periudhën 1992-2003.

**33.5.** Subjektit i është kërkuar të vërë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve tatimore nga të ardhurat e përfituara nga diferenca midis çmimit të blerjes dhe të shitjes së kësaj pasurie.

**33.6.** Subjekti, në përgjigje të dy pyetësorëve nuk ka depozituar dokumentacion provues, duke pretenduar se: *Agjenti për mbajtjen e detyrimit të tatimit në burim ka qenë Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme... Ashtu sikundër citohet në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2021, i lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Sarandë, në bazë të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", pasuritë e paluajtshme nuk regjistrohen pa kryer fillimisht pagesën e detyrimit tatimor pranë ZVRPP-së. Kjo vlen për të dy pasuritë e paluajtshme të shitura nga ana e tij. Fakti që janë regjistruar në hipotekë, tregon se janë likuiduar detyrimet tatimore.*

**33.7.** Së bashku me pyetësorin e datës 20.9.2021, subjekti ka vënë në dispozicion shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2021, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Sarandë, sipas së cilës: *Trualli me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup> dhe objekti 1-katësh me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> janë shitur për shumën 1,324,000 lekë... Për sa i përket tarifës së tatimit nuk mund të verifikohet, pasi është bërë asgjësimi i aplikimeve dhe mandatpagesave për vitin 2000-2007. Në bazë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, neni 11, pika 2, kalimi i pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme "Tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.", pas pagesës së tatimit është bërë regjistrimi i objektit të përfituar me kontratë \*\*\*.*

Bashkëlidhur shkresës gjendet procesverbal i datës 26.5.2018, ku deklarohet se janë nxjerrë jashtë përdorimit mandatet dhe aplikimet e viteve 2000-2007.

**33.8.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe shkresën e ASHK-së, Drejtoria Vendore Sarandë, konstaton se, bazuar në dokumentin inventar i brendshëm i dosjes<sup>19</sup> së kësaj pasurie, i cili është përpiluar nga tre punonjës të ZVRPP-së Sarandë, në janar të vitit 2008, nuk gjendet i inventarizuar dokumenti që provon pagesën e detyrimeve tatimore për regjistrimin e kësaj prone, për rrjedhojë subjekti nuk ka provuar se janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituar nga shitja e kësaj pasurie si diferencë çmim shitjeje/çmim blerjeje.

**33.9.** Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se:

- i. trualli me sipërfaqe 314 m<sup>2</sup> është shitur më vonë se pagesat e kryera nga subjekti për apartamentin me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>;
- ii. subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues pagesën e detyrimeve tatimore në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie;

nuk do të përfshijë në analizë financiare për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup> shumën e përfituar nga shitja e trullit me sipërfaqe 314 m<sup>2</sup> në qytetin e Sarandës. Për këtë subjektin iu kalua barra e provës.

---

<sup>19</sup> Shih shkresën kthim përgjigjeje të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nr. \*\*\*, datë 9.10.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.



**33.10.** Subjekti ka parashtruar të njëjtat pretendime si/më lart<sup>20</sup> në pikën 32.2., 33.6. dhe 33.7. të këtij vendimi.

**33.11.** Komisioni, në lidhje me këtë truall, bazuar në të njëjtin arsyetim si më lart<sup>21</sup>, vlerëson të mos përfshijë në analizë financiare të ardhurat e përfituara nga shitja e truallit me sipërfaqe 314 m<sup>2</sup> në qytetin e Sarandës.

**33.12.** Në përfundim, Komisioni çmon se gjendemi të paktën para plotësimit të deklaratës “Vetting” jo në përputhje me kërkesat e ligjit, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë; për pasojë, zbatimi i nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, që e konsideron deklaratën “Vetting” të saktë, nuk gjen zbatim. Në të njëjtën mënyrë si më lart, Komisioni do ta vlerësojë këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kësaj pasurie.

**34.** Subjekti, me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 4.11.2003, ka blerë nga Bashkia Sarandë një sipërfaqe trualli prej 662 m<sup>2</sup>, e destinuar për “banesë”, e ndodhur në Sarandë, kundrejt shumës 397.200 lekë. Kjo shumë është likuiduar tërësisht, sipas dokumentit bankar datë 30.10.2003, në favor të Degës së Thesarit.

**34.1.** Komisioni konstaton se shitja e pasurisë së mësipërme nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup> për sa kohë është shitur 2 vjet pas pagesës së çmimit të apartamentit.

**34.2.** Në dosjen e depozituar nga ZVRPP-ja Sarandë<sup>22</sup> pranë ILDKPKI-së (pasi nga ASHK-ja, Drejoria Vendore Sarandë, pavarësisht se janë dërguar disa shkresa, është refuzuar të kthehet përgjigje) rezulton se:

- i. me vendimin nr.\*\*\*, datë 28.8.1999 të Këshillit Bashkiak Sarandë, subjektit i është dhënë si investitor sheshi i ndërtimit, blloku \*\*\*, parcela nr. \*\*\*, sipërfaqja 662 m<sup>2</sup>;
- ii. në datën 1.11.2003 është mbajtur procesverbali i piketimit;
- iii. në datën 3.11.2003 subjekti ka paguar shumën 105,800 lekë, si pagesë për leje ndërtimi.
- iv. me vendimin e KRRT-së nr. \*\*\*, datë 10.9.2003 është lëshuar leja e ndërtimit me subjekt ndërtues “\*\*\*\*” (kjo shoqëri, bazuar në shkresën e QKB-së nr. \*\*\*, datë 3.2.2020 ka pasur për administrator dhe ortak të vetëm z. M.L., babai i subjektit të rivlerësimit) me objekt banesë, blloku \*\*\*, parcela nr. \*\*\*; objekti financohet nga z. Artan Lulaj;
- v. në datën 10.12.2003 është lëshuar leja e shfrytëzimit për objektin “banesë vetjake” në zonën turizëm \*\*\*, firma zbatuese “\*\*\*\*”, investitor Artan Lulaj. Sipas kësaj lejeje, objekti banesë vetjake investitor Artan Lulaj është i gatshëm për t’u vënë në shfrytëzim;
- vi. në datën 24.1.2004 subjekti me kontratën nr. \*\*\* ka shitur sipërfaqe trualli 662 m<sup>2</sup> dhe objekt njëkatësh ndërtuar mbi këtë truall, me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, në vlerën 1,324,000 lekë.

Bashkëlidhur gjendet dhe vërtetimi nga dokumenti hipotekor i datës 22.1.2004, sipas të cilit subjekti ka pasur të regjistruar pasurinë me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup>, si dhe një objekt njëkatësh me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> ndërtuar në këtë truall.

**34.3.** Subjekti, tek të dhënat konfidenciale në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar vetëm shitjen e truallit, ndërkohë që nuk ka deklaruar faktin që mbi këtë truall ishte ndërtuar një objekt me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>.

**34.4.** Komisioni i ka kërkuar subjektit informacion të detajuar në lidhje me:

<sup>20</sup> Shih pikat 33.6 dhe 33.7 të këtij vendimi.

<sup>21</sup> Shih pikat 32.6-32.8 të këtij vendimi.

<sup>22</sup> Shih shkresën kthim përgjigjeje të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nr. \*\*\*, datë 9.10.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

- i. kohën e lidhjes së marrëveshjes për ndërtimin e banesës me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., e cila rezulton në pronësi të babait të tij M.L., duke i kërkuar dhe dokumentacionin përkatës;
- ii. vlerën e shpenzuar për ndërtimin e banesës;
- iii. vlerën e mobilimit të kësaj banese dhe kohën e mobilimit;
- iv. burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e banesës.

**34.5.** Në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021, subjekti ka sqaruar se i është drejtuar me kërkesë Bashkisë Sarandë, për t'i vënë në dispozicion dosjen që ajo disponon për këtë marrëveshje, pasi nuk ka qenë asnjëherë në dijeni të saj. Midis tij dhe blerësit të truallit është bërë një marrëveshje verbale me të cilën kanë rënë dakord për shitjen e truallit dhe vlerën e kësaj shitjeje. Kontrata përfundimtare do të nënshkruhej në momentin që ai do të pajisej me vërtetimin hipotekor për truallin si dhe lejen e ndërtimit të objektit. Duke qenë në marrëdhënie mirëbesimi, blerësi ka nisur kryerjen e punimeve me investimet e tij për ndërtimin e kësaj banese. Pas marrjes së vërtetimit hipotekor kanë proceduar me lidhjen e kontratës në muajin janar të vitit 2004. Banesa me sipërfaqe prej 110 m<sup>2</sup>, është ndërtuar nga shtetasi me të cilin ka lidhur kontratën e shitblerjes së truallit. Kostoja e ndërtimit të saj nuk është mbuluar nga subjekti, si dhe nuk ka dijeni nëse kjo banesë ka qenë e mobiluar dhe as për shpenzimet e tjera të kryera për të. Nuk ka dijeni mbi mënyrën se si është ndërtuar banesa. Që prej vitit 2001, pas marrjes së kundërvleftës së truallit, nuk ka pasur apo ushtruar asnjë lloj tagri mbi këtë truall dhe banesë.

**34.6.** Ky deklarami i subjektit nuk përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ nga ku rezulton se:

- kolaudator i banesës ka qenë babai i tij, M.L.
- firma zbatuese për ndërtimin e kësaj banese ka qenë shoqëria “\*\*\*”, e cila rezulton të ketë qenë në pronësi të babait të tij.
- në kontratën e shitblerjes, të firmosur nga subjekti, përcaktohet se pasuria që shitet, është një sipërfaqe trualli dhe një objekt njëkatësh.

**34.7.** Në lidhje me këto konstatime, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 20.9.2021, ka sqaruar se për këtë marrëveshje me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., është vënë për herë të parë në dijeni nga pyetësi i datës 7.9.2021. Aktualisht është në pamundësi objektive për të sqaruar këtë situatë, pasi babai i tij, z. M.L., ka ndërruar jetë më 19.6.2019. Subjekti ka pretenduar se në asnjë nga deklaramet e tij nuk ka pohuar të ketë ndërtuar një banesë mbi truallin me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup>.

**34.8.** Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se subjekti ka ndërtuar një objekt me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> të cilin më pas në vitin 2004 e ka shitur. Këtë objekt subjekti nuk rezulton ta ketë deklaruar në asnjë nga deklaramet periodike dhe as në deklarametën “Vetting”.

**34.9.** Në përfundim, në lidhje me këtë objekt, subjektit iu kalua barra e provës me dyshimin se ai ka fshehur në deklarametën “Vetting” pronësinë që ka pasur mbi këtë objekt.

**34.10.** Subjekti, gjatë hetimit, ka refuzuar të deklarojë vlerën e investimit për objektin me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, si dhe të japë shpjegime të hollësishme në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, veprim i cili nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka kryer llogaritjen e ndërtimit të objektit me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, bazuar në vlerën e kostos së ndërtimit për qytetin e Sarandës nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2003<sup>23</sup> në shumën 23,121 lekë/m<sup>2</sup>. Shuma e investimit për këtë pasuri rezulton në vlerën 2,544,410 lekë (110 m<sup>2</sup> x 23,121 lekë)

**34.11.** Në kushtet kur subjektit ka refuzuar të deklarojë burimin e ligjshëm të ardhurave për banesën me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, Komisioni ka kryer një analizë financiare, bazuar në të dhënat e administruara për vitin 2003 nga hetimi administrativ, si më poshtë:

<sup>23</sup> <https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/08/2003.pdf>

	<b>10.9.2003</b>
<b>Pasuri</b>	<b>2,544,410.00</b>
Banesë 110 m <sup>2</sup>	2,544,410.00
<b>Pasuri neto</b>	<b>2,544,410.00</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>1,576,793.25</b>
Të ardhurat nga puna e subjektit	1,115,669.25
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	461,124.00
<b>Shpenzime</b>	<b>332,789.17</b>
Shpenzime jetike	332,789.17
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-1,300,405.92</b>

**34.12.** Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën 1,300,405.92 lekë për të ndërtuar banesën me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>. Subjektit iu kalua barra e provës për këtë mungesë të ardhurash.

**34.13.** Subjektit i është kërkuar të vërë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve tatimore nga të ardhurat e përfituara nga diferenca midis çmimit të blerjes dhe të shitjes të kësaj pasurie.

**34.14.** Subjekti ka kthyer të njëjtat përgjigje si në pikën 33.6. dhe 33.7. të këtij vendimi.

**34.15.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe shkresën e ASHK-së, Drejtoria Vendore Sarandë, konstaton se, në dokumentacionin që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj prone pranë ASHK-së Sarandë<sup>24</sup>, nuk rezulton të jetë depozituar dokument që vërteton pagimin e detyrimeve tatimore nga subjekti i rivlerësimit, për rrjedhojë subjekti nuk ka provuar që janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie, si diferencë çmim shitjeje/çmim blerjeje.

**34.16.** Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se:

- i. trualli me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup> dhe objekti me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> janë shitur më vonë se pagesat e kryera nga ana e subjektit për apartamentin me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>.
- ii. subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues pagesën e detyrimeve tatimore, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie.

nuk do të përfshijë në analizë financiare për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup> shumën e përfitur nga shitja e truallit me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup> dhe objektit me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> në qytetin e Sarandës, duke i kaluar barrën e provës subjektit.

**34.17.** Subjekti, në lidhje me barrën e provës, të përcaktuar në pikat 34.9., 34.12. dhe 34.16, për këtë truall, ka parashtruar: *“Asnjë ndërtim nuk është realizuar prej meje, jo vetëm se nuk rezulton nga asnjë akt shkresor, por edhe për faktin e thjeshtë se blerja dhe shitja e këtij trualli, ka ndodhur në një hark të shkurtër kohor. Sipërfaqja prej 662 m<sup>2</sup> është përfitur nga unë sipas vendimit nr.\*\*\*, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak Sarandë, në cilësinë e investitorit të sheshit të ndërtimit. Më përfitimin e kësaj sipërfaqe prej Bashkisë Sarandë, ramë dakord me blerësin L. K. B. (dhe bashkëshortja e tij N. N. B.), që në vitin 2000-2001, për kalimin e të drejtave të mia tek kjo palë, me kusht që në momentin e regjistrimit të pasurisë pranë hipotekës në atë kohë, të realizohej kontrata e shitjes përfundimtare. Zhvillimin e këtij trualli në drejtim të ndërtimit, nuk e kam realizuar unë, por pala blerëse me mjetet e saj monetare. Ky fakt vërtetohet qartësisht edhe nga çmimi i kontratës së shitjes, çmim i cili nëse do të përfshinte edhe ndërtimin, do të kishte një vlerë shumë më të lartë të shitjes. Gjithashtu, vetë logjika e rrethanave kohore, pra, nga momenti i piketimit të objektit deri në momentin e shitjes së truallit, kanë kaluar dy muaj, një kohë logjikisht e pamjaftueshme për të ndërtuar një objekt*

<sup>24</sup> Shih shkresën kthim përgjigjeje të Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nr. \*\*\*, datë 9.10.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

*njëkatësh me këto kosto të pretenduara nga ana Juaj. Lidhur me shoqërinë e babait tim, ku cilësohet në dokumentacionet e lejes së ndërtimit, sqarohet se shënimi si shoqëri, për të ndjerin babain tim, ka qenë krejtësisht formal, pasi babai im në atë periudhë nuk ka ushtruar asnjë aktivitet tatimor, fakt që rezulton edhe nga shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Sarandë, Sektori i Shërbimit të Tatimpaguesve, të cilët shprehën se shtetasi M. L. nuk figuron të ketë qënë i regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, por ka disponuar vetëm licencën për ndërtime civile, industriale etj...”*

**34.18.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka depozituar shkresë të Bashkisë Sarandë nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2021, ku bashkëlidhur gjenden:

- leje ndërtimi, datë 10.9.2003, me objekt banesë dhe si financues rezulton z. Artan Lulaj;
- studim pjesor urbanistik për truallin me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup>, ku investitor sërish rezulton z. Artan Lulaj;
- pagesë, datë 3.11.2003, në shumën 105,800 lekë, me emërtim “pagesë për leje ndërtimi”, udhëruesi z. Artan Lulaj dhe e firmosur nga ai;
- kërkesë për miratimin e lejes së ndërtimit; kërkuar z. Artan Lulaj; projektuesi i objektit z. M. L.; zbatuesi shoqëria “\*\*\*\*”;
- vendim dublikatë i Këshillit Bashkiak për dhënien e z. Artan Lulaj si investitor të bllokut \*\*\*, parcela nr. \*\*\*, me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup>.
- procesverbal piketimi, datë 1.11.2003, ku deklarohet piketimi i sheshit për hotel, investitor Artan Lulaj.
- planvendosje në bazë të fotografimit satelitor të vitit 2003 ku rezulton se në truallin me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup> nuk ka objekt të ndërtuar.

**34.19.** Subjekti, në seancë dëgjimore, në lidhje me këtë objekt, deklaroi se ka qenë një objekt njëkatësh me kolona, sepse nuk mund të bëhej regjistrimi i pronës pa u bërë objekti, u morën aktet përkatëse dhe objekti u regjistrua në emër të tij, por, sipas subjektit, objekti nuk ka qenë godinë funksionale. Gjithashtu në seancë subjekti pranoi faktin se kontrata e shitjes parashikonte shitjen e truallit plus objekt njëkatësh, porse ky objekt nuk ishte funksional.

**34.20.** Komisioni, duke u bazuar në shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, por dhe në seancë dëgjimore, vlerëson se ato nuk janë bindëse, si dhe nuk janë të mbështetura në prova. Ndryshe nga sa deklaroi subjekti, ky truall, së bashku me ndërtimin, rezulton i regjistruar në emër të tij, bazuar në vërtetimin nga dokumenti hipotekor të datës 22.1.2004, sipas së cilit subjekti ka pasur të regjistruar pasurinë me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup>, si dhe një objekt njëkatësh me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, ndërtuar në këtë truall. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shoqëria e babait të tij ka qenë në lejen e ndërtimit thjesht formalisht, edhe ky pretendim nuk qëndron, pasi nga dokumentacioni i administruar rezulton se:

i) kolaudator i banesës ka qenë babai i tij, M. L.

ii) firma zbatuese për ndërtimin e kësaj banese ka qenë shoqëria “\*\*\*\*”, e cila rezulton të ketë qenë në pronësi të babait të tij.

**34.21.** Nga provat e sjella nga vetë subjekti provohet që të gjitha veprimet për ndërtimin e këtij objekti janë kryer nga subjekti. Gjithashtu nga foto e vënë në dispozicion prej tij vërtetohet fakti se ndërtimi i objektit është bërë në fund të vitit 2003, sikundër janë aktet shkresore (moment kur është bërë edhe llogaritja nga Komisioni).

**34.22.** Subjekti pretendon që objekti nuk është ndërtuar brenda dy muajve, ndërkohë që nga aktet shkresore rezulton që:

- i. në datën 1.11.2003 është mbajtur procesverbali i piketimit;
- ii. në datën 3.11.2003 subjekti ka paguar shumën 105,800 lekë si pagesë për leje ndërtimi;
- iii. në datën 10.12.2003 është lëshuar leja e shfrytëzimit për objektin banesë vetjake në zonën turizëm \*\*\*; firma zbatuese “\*\*\*\*”; investitor Artan Lulaj. Sipas kësaj lejeje,

objekti banesë vetjake, investitor Artan Lulaj, është i gatshëm për t'u vënë në shfrytëzim;

- iv. në datën 24.1.2004 subjekti ka regjistruar pasurinë me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup>, si dhe një objekt njëkatësh me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, ndërtuar në këtë truall.

Ky fakt është pranuar dhe nga subjekti në seancë dëgjimore, por duke pretenduar se ndërtimi ishte karabina, pretendim i cili nuk qëndron, pasi ndërtimi rezulton të ketë pasur leje shfrytëzimi, ku deklarohet se objekti është i gatshëm për t'u vënë në shfrytëzim.

**34.23.** Në përfundim, Komisioni çmon se në lidhje me truallin dhe objektin me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> gjendemi në kushtet e fshehjes së pasurisë në deklaratat periodike, por edhe në deklaratën "Vetting", si dhe subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar ndërtimin e objektit me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, si dhe fshehje të pasurisë, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave "b" dhe "c" të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

**34.24.** Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituar nga shitja e pasurisë së mësipërme, subjekti ka paraqitur të njëjtat argumente si në pikën 32.2., 33.6. dhe 33.7. të këtij vendimi.

**34.25.** Komisioni, bazuar në të njëjtin arsyetim si në pikën 32.6. dhe 32.8. të këtij vendimi, vlerëson të mos përfshijë në analizë financiare të ardhurat e përfituar nga shitja e truallit me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup> dhe objektit me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> në qytetin e Sarandës.

**34.26.** Në përfundim, Komisioni çmon se gjendemi të paktën para plotësimit të deklaratës "Vetting" jo në përputhje me kërkesat e ligjit, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë, për pasojë, zbatimi i nenit 33, pika 5, germa "a" e ligjit nr. 84/2016, që e konsideron deklaratën "Vetting" të saktë, nuk gjen zbatim. Në të njëjtën mënyrë si më lart, Komisioni do e vlerësojë këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kësaj pasurie.

**34.27.** Komisioni verifikoi deklaramin e parë të subjektit në vitin 2003, i cili në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016 përbën provë. Në këtë deklaram, subjekti, si burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>, ka deklaruar shitjen e apartamentit dhe dy trojeve në qytetin e Sarandës, në vlerën 3,500,000 lekë.

Nëse i referohemi këtij deklarami të subjektit (i cili është bërë në kohën e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>) rezulton se ai nuk ka deklaruar si burim të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktiviteti si noter, duke u prezumuar që ato janë përdorur nga ai për shpenzime të tjera dhe jo për blerjen e këtij apartamenti.

**34.28.** Për sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi rezulton se ka mospërputhje midis deklarameve të subjektit në deklaratën "Vetting" dhe në DVP/2003, në lidhje me burimin e ligjshëm të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë "apartament" me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>.

**34.29.** Në përgjigje të barrës së provës, subjekti sqaroi se nuk ekziston asnjë mospërputhje midis tyre, pasi, si në deklaratën "Vetting", ashtu edhe në DPV/2003, është deklaruar i njëjti burim krijimi, që janë tjetërsimi i pasurive truall dhe apartament banimi në qytetin e Sarandës. Në deklaratën "Vetting" ai pretendon se ka përfshirë edhe të ardhurat nga puna si noter përgjatë asaj periudhe, pasi ishin burimi tërësor i të ardhurave në atë periudhë.

**34.30.** Komisionit i rezulton se pavarësisht deklaramit të ardhurave nga noteria në deklaratën "Vetting", subjekti i rivlerësim, në deklaratën periodike/vjetore 2003, ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit dhe dy trojeve në qytetin e Sarandës. Trupi gjykues vlerëson se deklarami në deklaratën "Vetting" i një burimi të ndryshëm në strukturën e burimit të krijimit të kësaj pasurie, është i pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, referuar parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016. Ky deklaram është i shoqëruar dhe me problematika të tjera referuar burimeve të ligjshme të krijimit të saj, të cilat nuk janë të justifikuara.

**34.31.** Analiza financiare në lidhje me aftësinë e subjektit për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup> në vitin 2001, është kryer duke marrë në konsideratë:

- i. vetëm të ardhurat për të cilat rezulton se janë paguar detyrimet tatimore, ku përfshihen dhe të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, ndërkohë, Komisioni nuk ka përfshirë në analizë financiare të ardhurat për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore, si dhe ato të ardhura që janë siguruar pas pagesës për blerjen e apartamentit;
- ii. shumën 3,128,586 lekë, e cila është mundësia kumulative e subjektit për kursim deri në vitin 2000, pavarësisht faktit se në DVP/2003 nuk rezulton që si burim të këtij apartamenti, të ketë deklaruar kursime apo të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes së tij ndër vite<sup>25</sup>;
- iii. vlera e apartamentit në shumën 41.000 USD bazuar në mandatpagesat e vëna në dispozicion nga subjekti dhe z. A. N. (administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k), si dhe në deklaratimet e subjektit në DVP/2003 dhe përpara ILDKPKI-së .
- iv. vlerën e shpenzimeve shtesë në shumën 230,000 lekë, bazuar në mandatpagesat e depozituara nga subjekti.

	Analiza kumulative deri në vitin 2000	30.5.2001	23.6.2001	6.9.2001	26.9.2001	14.11.2001	Apartamenti 2001
		13 000 \$	0	15 000 \$	8 000 \$	5 000 \$	
<b>Pasuria</b>	<b>125,874.00</b>	<b>1,775,150.00</b>	<b>0.00</b>	<b>2,048,250.00</b>	<b>1,092,400.00</b>	<b>682,750.00</b>	<b>5,724,424.00</b>
Apartament banimi sip 117 m <sup>2</sup> Tiranë, blerë 15.7.2004		1,775,150.00		2,048,250.00	1,092,400.00	682,750.00	5,598,550.00
Automjet “****”	125,874.00						125,874.00
Likuiditete (shtesa /pakësime )	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>Të ardhurat</b>	<b>5,428,547.00</b>	<b>635,041.17</b>	<b>127,008.23</b>	<b>254,016.47</b>	<b>127,008.23</b>	<b>254,016.47</b>	<b>6,825,637.57</b>
Të ardhurat nga puna e subjektit	45,139.00	376,707.50	75,341.50	150,683.00	75,341.50	150,683.00	873,895.50
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	1,023,103.00	258,333.67	51,666.73	103,333.47	51,666.73	103,333.47	1,591,437.07
Të ardhurat si noter	4,360,305.00						4,360,305.00
<b>Shpenzime</b>	<b>2,174,086.40</b>	<b>225,000.00</b>	<b>275,000.00</b>	<b>90,000.00</b>	<b>45,000.00</b>	<b>90,000.00</b>	<b>2,899,086.40</b>
Shpenzime jetike 5 persona	2,042,486.40	225,000.00	45,000.00	90,000.00	45,000.00	90,000.00	2,537,486.40
TIMS	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Shpenzime për rindarje të apartamentit në shumën 2 milionë		0.00	230,000.00				230,000.00
Shpenzime doganore për automjetin “****”	131,600.00						131,600.00
<b>Mundësi kursimi</b>	<b>3,128,586.60</b>	<b>-1,365,108.83</b>	<b>-147,991.77</b>	<b>-1,884,233.53</b>	<b>-1,010,391.77</b>	<b>-518,733.53</b>	<b>-1,797,872.83</b>
<b>Mundësi kursimi kumulative</b>	<b>3,128,586.60</b>	<b>1,763,477.77</b>	<b>1,615,486.00</b>	<b>-268,747.53</b>	<b>-1,279,139.30</b>	<b>-1,797,872.83</b>	

<sup>25</sup> Këto të ardhura të paktën kanë shërbyer si mjet jetese.

**34.32.** Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 1,797,872.83 lekë, nëse në analizë do të përfshihen të gjitha të ardhurat e tij deri në vitin 2001, ndërsa nëse i referohemi burimit të deklaruar nga ana e subjektit në DVP/2003, ai nuk do të kishte të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 5,828,550 lekë. Në lidhje me këtë rezultat hetimi subjektit iu kalua barra e provës.

**34.33.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk dha shpjegime të veçanta në lidhje me këtë rezultat hetimi. Komisioni, duke vlerësuar të gjitha shpjegimet që ka dhënë subjekti të trajtuara më lart, duke pranuar si shtesë në të ardhura vetëm të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i noterisë në vitin 1996, kreu dhe një herë analizën financiare. Sërish subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1,386,608.83 lekë, nëse në analizë do të përfshihen të gjitha të ardhurat e tij deri në vitin 2001, ndërsa nëse i referohemi burimit të deklaruar nga ana e subjektit në DVP/2003, ai nuk do të kishte të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 5,828,550 lekë.

**34.34.** Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në:

- a. mosdeklarimin në deklaratën “Vetting” (i) të çmimit të blerjes së apartamentit në shumën 41.000 USD; (ii) të rikonstruksionit të këtij apartamenti në vitin 2014, në vlerën 2,000,000 lekë, vlerë e cila nuk është deklaruar as në DVP/2014; (iii) të destinacionit të saktë të përdorimit të shumës 2,000,000 lekë në vitin 2001;
- b. mungesën e dokumentacion provues për të ardhurat e përfituara nga subjekti nga aktiviteti si noter në shumën 12,000,000 lekë;
- c. mospërshirjen në analizë financiare të të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit në qytetin e Sarandës, truallit me sipërfaqe 314 m<sup>2</sup> dhe truallit me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup> dhe objektit 110 m<sup>2</sup>;
- d. mungesën e burimeve të mjaftueshme të ligjshme për të mbuluar shpenzimet për ndërtimin e objektit me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> dhe për rikonstruksionin e apartamentit në vitin 2014;
- e. refuzimin e subjektit (i) për të depozituar kontratën e sipërmarrjes; (ii) për të deklaruar vlerën e mobilimit të apartamentit në vitin 2001; (iii) për të dhënë shpjegime në lidhje me truallin me sipërfaqe 314 m<sup>2</sup> dhe truallin me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup> së bashku me objektin me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>;
- f. fshehjen në deklaratën “Vetting”, por dhe në deklaratat periodike të objektit me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, të ndërtuar në truallin me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup>.

**34.35.** Komisioni, në mënyrë të përmbledhur, i kaloi subjektit barrën e provës për këtë apartament si më poshtë:

- i. subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë burimin e ligjshëm të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqen 117 m<sup>2</sup>;
- ii. subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë “apartament” me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>;
- iii. subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup> në shumën 1,797,872.83 lekë, nëse në analizë do të përfshihen të gjitha të ardhurat e tij sipas deklaratës “Vetting”, ndërsa nëse i referohemi burimit të deklaruar nga ana e subjektit në DVP/2003, ai nuk do të kishte të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 5,828,550 lekë.

**34.36.** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk dha shpjegime të veçanta për këtë barrë prove.

**34.37.** Komisioni, pasi analizoi të gjitha shpjegimet e subjektit në lidhje me pasurinë “apartament” me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>, vlerëson se:

- i. rezulton e provuar ekzistenca e një çmimi fiktiv në kontratën e shitblerjes për këtë pasuri, si dhe subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën “Vetting” në lidhje me çmimin e blerjes së kësaj pasurie;
- ii. subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën **-958,831.27** për rikonstrukcionin dhe mobilimin e apartamentit në vitin 2014;
- iii. subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti si noter;
- iv. subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, në lidhje me burimin e ligjshëm të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie;
- v. subjekti ka fshehur në deklaratën “Vetting”, por dhe në deklarimet periodike ndërtimin e një objekti me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> në vitin 2003;
- vi. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar ndërtimin e objektit me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> në shumën 1,300,405.92 lekë;
- vii. subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie në shumën 1,386,608.83, nëse në analizë do të përfshihen të gjitha të ardhurat e tij deri në vitin 2001, ndërsa nëse i referohemi burimit të deklaruar nga subjekti në DVP/2003, ai ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 5,828,550 lekë.

**34.38.** Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer fshehje të pasurisë, në kuptim të nenit 33/5, germa “c” të ligjit nr. 84/2016.

**35. Apartament banimi<sup>26</sup>** me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen nr. \*\*\* Durrës. Vlera e apartamentit 40.000 euro. Pjesa takuese 50%.

**35.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** blerë me kredi nga “\*\*\*” dhe kursime nga të ardhurat.

**35.2. Konstatimi ILDKPKI-së :** subjekti nuk ka paraqitur dokumentacionin justifikues ligjor për porositjen në vitin 2006 të apartamentit të banimit me sip. 60.28 m<sup>2</sup>, në Durrës.

### **Hetimi<sup>27</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

**36.** Subjekti, së bashku me bashkëshorten e tij, me kontratë shitjeje apartamenti, nr. \*\*\*, datë 14.5.2009, kanë blerë apartamentin me sipërfaqe 60.28 m<sup>2</sup>, ndodhur në Durrës, me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*. Çmimi i shitjes së apartamentit 40.000 euro.

**36.1.** Si burim për blerjen e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në “Alpha Bank”, në datën 8.11.2006, me kontratën nr. \*\*\*, në shumën 30.000 euro dhe 3.000 euro me afat 15-vjeçar. Për të garantuar këtë kredi është nënshkruar kontrata e hipotekës nr. \*\*\*, datë 8.11.2006. Objekti i kontratës është hipotekimi i pasurisë “apartament” me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, në favor të Bankës, me qëllim sigurimin e kredisë së marrë nga subjekti.

Nga verifikimi i nxjerrjes së llogarisë në euro në “\*\*\*” rezulton se:

- në datën 14.11.2006 është disbursuar shuma 30.000 euro;

<sup>26</sup> Subjekti ka depozituar: kontratë shitjeje apartamenti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2009; vërtetim nga dokumentet hipotekore, nr. \*\*\*, datë 17.2.2009, të pasurisë me sipërfaqe 60.28 m<sup>2</sup>; kontratë hipoteke nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.11.2006; kontrata e kredisë është nënshkruar ndërmjet bankës dhe kredimarrësve, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.11.2006; deklaratë noteriale, datë 8.11.2006.

<sup>27</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020 drejtuar Bankave; kthim përgjigjeje “Alpha Bank” nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020; shkresë drejtuar “Alpha Bank”, nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021; kthim përgjigjeje “Alpha Bank” nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021, drejtuar shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k; kthim përgjigjeje A. N., datë 30.9.2021.



- në datën 14.11.2006 është depozituar shuma 29.700 euro, në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**36.2.** Në datën 20.9.2006, subjekti ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr.\*\*\*. Në nenin 2 të kësaj kontrate është përcaktuar që porositësi me nënshkrimin e kontratës paguan shumën 36.000 euro.

**36.3.** Në lidhje me mënyrën e pagesës së apartamentit, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021 ka sqaruar se shuma është paguar pas nënshkrimit të kontratës së huadhënies me bankën, ku 30,000 (tridhjetë mijë) euro janë shlyer nga kredia e marrë dhe pjesa tjetër *cash*. Ky fakt vërtetohet me transfertën bankare në emër të shoqërisë, e cila i referohet kësaj kontrate sipërmarrjeje. Vlera e mbetur e këtij apartamenti, në shumën e 5,000 (pesë mijë) euro është paguar gjatë viteve 2010, 2011. Subjekti deklaron se nuk disponon dokumentacion provues.

**36.4.** Ky deklaram i subjektit është konfirmuar dhe nga z. A.N., administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., i cili ka informuar se vlera prej 35.000 eurosh është paguar në vitin 2006, e ndarë në këste, nga të cilat 29.700 euro, likuiduar më 14.11.2006, transferuar me bankë pas lëvrimin të kredisë dhe shuma 5.000 euro është likuiduar gjatë mujave nëntor - dhjetor 2006. Më pas, diferenca është paguar në *cash* në shumat 2.500 euro në vitin 2010 dhe 2.868 në euro në vitin 2011.

**36.5.** Bashkëlidhur shkresës, z. N., ka vënë në dispozicion:

- i. deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 17.9.2021, ku ai deklaron se pagesa e këtij apartamenti është bërë me kredi bankare dhe me pagesë *cash*. E gjithë kjo shumë është paguar pas nënshkrimit të kontratës. Në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes nuk është bërë asnjë pagesë, por ajo ka shërbyer për procedurat e marrjes së kredisë;
- ii. detajet e nxjerrjes së llogarisë, datë 30.1.2007, e Bankës Amerikane të Shqipërisë, nga ku rezulton se në datën 16.11.2006 është transferuar shuma 29.655 euro nga subjekti i rivlerësimit, me emërtimin “*pagesë për blerjen e apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\**”.

**36.6.** Deklarimi i z. N. dhe i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me shlyerjen e shumës 5.000 euro në vitet 2010, 2011, nuk përputhen me parashikimet e kontratës së shitblerjes të nënshkruar në vitin 2009, ku përcaktohet se shuma 40.000 euro ishte likuiduar plotësisht nga subjekti i rivlerësimit.

**36.7.** Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë periodikë të subjektit të rivlerësimit rezulton se:

- i) në DPV/2006, subjekti deklaron apartament banimi me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, ndodhur tek zona e \*\*\*, vlera 40.000 euro. Në lidhje me burimin nuk rezulton të ketë deklaruar burim. Në seksionin e detyrimeve financiare në DPV/2006, subjekti deklaron kredi nga “Alfa Bank” në shumën 30.000 euro. Detyrim ndaj investitorit firmës “\*\*\*\*” sh.p.k., 10.000 euro, shlyer 5.000 euro nga kursimet e të ardhurat;
- ii) në DPV/2007 dhe 2008, në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar: detyrim ndaj firmës ndërtues, i pashlyer, në shumën 5.000 euro;
- iii) në DPV/2009, në seksionin e të dhënave konfidenciale, deklaron: apartamenti i banimit, ndodhur në zonën \*\*\* Durrës, deklaruar në deklaramin tim të vitit 2008, është regjistruar në ZVRPP-në Durrës. Në këtë DPV e në vijim, subjekti nuk ka deklaruar më detyrimin 5.000 euro ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**36.8.** Në procesverbalin e datës 3.3.2016<sup>28</sup>, në lidhje me shlyerjen e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar se 30.000 euro janë paguar me kredinë e marrë nëpërmjet sistemit bankar, kurse shuma 10.000 është paguar 5.000 euro në vitin 2007 dhe 5.000 euro në vitin 2008.

**36.9.** Për shkak të deklarimeve kontradiktore të subjektit, Komisioni ka vlerësuar ta konsiderojë të paguar në vitin 2009 shumën prej 5000 euro, sepse:

- i. në kontratën e shitblerjes, të nënshkruar në vitin 2009, deklarohet se vlera 40.000 është likuiduar plotësisht;
- ii. duke filluar nga viti 2009, subjekti nuk ka deklaruar më se i detyrohej shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shumën 5.000 euro.

### **36.10. Analizë financiare**

Në lidhje këstin e parë të paguar për këtë apartament në vitin 2007, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme, pasi burimi ka qenë kredia e marrë në “Alpha Bank”. Në lidhje me këstin e dytë në shumën 5.000 euro, i cili do të konsiderohet i paguar në vitin 2009, nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar këtë këst.

	<b>14.5.2009</b>
<b>Pasuri</b>	<b>157,947.05</b>
Automjet “****”	82,302.00
<i>Shtesa / Pakësime/ likuiditete</i>	<i>75,645.05</i>
<b>Detyrime</b>	<b>-873,396.25</b>
Shlyerje detyrimi i kredisë në “Alpha Bank”	-187,546.25
Shlyerje e detyrimit ndaj “****” sh.p.k.	-685,850.00
<b>Pasuri neto</b>	<b>1,031,343.30</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>933,409.58</b>
Të ardhurat nga puna e subjektit	622,851.25
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	310,558.33
<b>Shpenzime</b>	<b>610,661.83</b>
Shpenzime jetike	284,625.00
TIMS	40,894.83
Shpenzime shkollimi në shkollën “****”, A. L.	123,453.00
Shpenzime doganore për automjetin	161,689.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-708,595.55</b>

**36.11.** Në përfundim, subjektit i kaloi barra e provës për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar pagesën e këstit të dytë të apartamentit.

**36.12.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti parashtroi se vlera e mbetur e këtij apartamenti, në shumën 5.000 (pesë mijë) euro është paguar gjatë viteve 2010, 2011. Lidhur me dokumentacionin provues, edhe sipas përgjigjes së administratorit të shoqërisë shitëse, diferenca është paguar në *cash* në shumat 2.500 euro në vitin 2010 dhe 2.868 në euro në vitin 2011. Këto shuma janë paguar pikërisht në këto vite, pra në vitin 2010 dhe në vitin 2011, pavarësisht mosdeklarimit të këtij detyrimi të mbartur që prej vitit 2006. Subjekti ka pretenduar se mosdeklarimi i detyrimit pas vitit 2009, lidhet me faktin se ka menduar që ky detyrim është deklaruar në vitet e mëparshme. Subjekti ka prapësuar se shpenzimet jetike deri më 14 maj 2009, Komisioni i ka llogaritur me shumë, sesa duhet të llogariste për 4, 5 muaj të vitit 2009, në shumën 256,162 lekë.

<sup>28</sup> Shih kthim përgjigjeje ILDKPI-ja nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2021

Gjithashtu, nga llogaria bankare e kredisë në “Alpha Bank” sh.a., rezulton se në këtë periudhë janë shlyer 1003.9 euro - dhe të konvertuara me kursin zyrtar i këmbimit të Bankës së Shqipërisë - rezulton se në periudhën 1 janar - 14 maj 2009 është shlyer shuma prej 132,845 lekësh. Subjekti ka sqaruar se vajza e tij, A., në këtë shkollë jopublike ka filluar në tetor të vitit 2009 dhe pagesa është kryer në shtator të këtij viti, çka vërteton se është llogaritur gabim nga Komisioni vlera 123,453 lekë në periudhën deri në 14 maj të vitit 2009.

**36.13.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitur prej tij vlerëson se në lidhje me kohën e pagesës së shumës 5.000 euro, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për kryerjen e kësaj pagese në vitet 2010-2011. Deklarata noteriale e z. N. është thjesht në nivel deklarativ dhe është një dokument i hartuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe fuqia e saj provuese, bazuar dhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, merret me rezerva. Komisioni, referuar deklaramenteve të subjektit në deklaratat periodike që përbëjnë provë, në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe përmbajtjes së kontratës së shitblerjes do të konsiderojë që kësti i dytë në shumën 5.000 euro është paguar para lidhjes së kontratës së shitblerjes në vitin 2009. Në lidhje me pretendimet e tjera, Komisioni i ka pranuar, duke kryer një llogari të re financiare si më poshtë:

	<b>14.5.2009</b>
<b>Pasuri</b>	<b>157,947.05</b>
Automjet “****”	82,302.00
<i>Shtesa / Pakësime /Likuiditete</i>	<i>75,645.05</i>
<b>Detyrime</b>	<b>- 818,703.11</b>
Shlyerje detyrimi i kredisë	-132,853.11
Shlyerje e detyrimit ndaj “****” sh.p.k.	-685,850.00
<b>Pasuri neto</b>	<b>976,650.16</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>933,409.58</b>
Të ardhurat nga puna e subjektit	622,851.25
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	310,558.33
<b>Shpenzime</b>	<b>458,746.33</b>
Shpenzime jetike	256,162.50
TIMS	40,894.83
Shpenzime doganore për “****”	161,689.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-501,986.91</b>

**36.14.** Në përfundim, në lidhje me këtë pasuri, rezulton se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të financuar pagesën e këstit të dytë, në shumën 501,986.91 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaramente të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni vlerëson se, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të mungesës së burimeve të ligjshme për këtë pasuri, ka vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit, në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

**37. Automjet<sup>29</sup>**, markës “\*\*\*\*”, targa \*\*\*; Vlera e automjetit 200.000 lekë. Pjesa takuese 100%.

**37.1. Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** blerë me të ardhurat nga shitja e një autoveturë “\*\*\*\*”.

<sup>29</sup>Subjekti ka depozituar: kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.1.2012; deklaratë e zhdoganimit të automjetit, datë 13.2.2012.; Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor “\*\*\*\*”; kontratë shitjeje pasuri e luajtshme, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.12.2010.

## Hetimi<sup>30</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

**38.** Subjekti, me kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 14.1.2012, ka blerë automjetin “\*\*\*\*”<sup>31</sup>, kundrejt shumës 200.000 lekë. Në kontratë është përcaktuar se çmimi do të paguhet pas regjistrimit të mjetit nga pala blerëse. Bazuar në deklaratën doganore *Import 4* rezulton se vlera e detyrimeve tatimore është në shumën 62,755 lekë.

**38.1.** Si burim për blerjen e automjeti “\*\*\*\*”, në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “\*\*\*\*”. Bazuar në deklaratën doganore *Import 4* datë 7.3.2009 ai e ka blerë automjetin për shumën 600 euro dhe ka paguar detyrime doganore në shumën 161,689 lekë<sup>32</sup>.

**38.2.** Në DPV/2009, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” për shumën 200,000 lekë duke deklaruar si burim kursimet e të ardhurat gjatë vitit, si dhe shuma e përfituar nga shitja e autoveturës “\*\*\*\*”, e cila rezulton se është shitur në datë 13.11.2008 me kontratë nr. \*\*\* për shumën 60,000 lekë, për rrjedhojë nuk mund të shërbejë si burim.

**38.3.** Analizë financiare për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”

	<b>7.3.2009</b>
<b>Pasuri</b>	<b>264,267.99</b>
Automjet “****”	82,776.00
<b>Shtesa / Pakësime/ Likuiditete</b>	<b>181,491.99</b>
<b>Pasuri neto</b>	<b>264,267.99</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>373,363.83</b>
Të ardhurat nga puna e subjektit	249,140.50
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	124,223.33
<b>Shpenzime</b>	<b>324,920.20</b>
Shpenzime jetike	113,850.00
Shpenzime shkollimi A. L.	49,381.20
Shpenzime doganore për automjetet	161,689.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-215,824.36</b>

**38.4.** Subjektit iu kalua barra e provës, pasi nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” në shumën 215,825.36 lekë.

**38.5.** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, prapësoi se automjeti i markës “\*\*\*\*”, është blerë në vitin 2009, në shumën 200,000 lekë dhe si burim ka pasur shitjen e automjetit “\*\*\*\*”, sipas kontratës, datë 13.11.2008, nr. \*\*\*, për shumën 60,000 lekë. Në deklaratën periodike të vitit 2009, ka deklaruar saktësisht si burim jo vetëm të ardhurat nga shitja e automjetit “\*\*\*\*”, por edhe të ardhurat nga paga, të cilat mbulohen plotësisht në këtë periudhë. Subjekti ka prapësuar se në analizën financiare të kryer nga Komisioni janë llogaritur më pak të ardhura nga pagat, të cilat nga verifikimi i llogarive bankare rezulton se janë pasqyruar 119,655 lekë më pak. Gjithashtu, në lidhje me shkollimin e vajzës në këtë periudhë nuk janë kryer pagesa. Pagesa e

<sup>30</sup> Shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020; Kthim përgjigje DPSHTRR-ja nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020; shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor nr. \*\*\* prot., datë 14. 7.2021; kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2021.

<sup>31</sup> Deklaruar në DPV/2012.

<sup>32</sup> Shih kthim përgjigjen e DPSHTRR-së nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2021.

fundit në Kolegjin “\*\*\*\*” i Tiranës është kryer në fillim të vitit shkollor 2008-2009, ka pretenduar subjekti.

**38.6.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, verifikoi llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortes së tij, duke përfshirë në analizë financiare shumat e rezultuara nga këto llogari. Pas sqarimeve të subjektit për llogaritjen e shpenzimeve të shkollimit për A. L pranë Kolegjit “A” i Tiranës”, këto shpenzime janë ngarkuar në vitin 2008, ndërsa shpenzimet e shkollimit pranë shkollës jopublike “N” janë ngarkuar për muajt tetor –vazhdim 2009.

**38.7.** Analiza pas prapësimeve

	<b>7.3.2009</b>
<b>Pasuri</b>	<b>264,267.99</b>
Automjet “****”	82,776.00
<b>Shtesa / Pakësime/Likuiditete</b>	<b>181,491.99</b>
<b>Total likuiditete</b>	285,943.30
<b>CASH</b>	600,000.00
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuri Neto</b>	<b>264,267.99</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>438,513.00</b>
Të ardhurat nga puna e subjektit	310,176.00
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	128,337.00
<b>Shpenzime</b>	<b>275,539.00</b>
Shpenzime jetike	113,850.00
Shpenzime doganore për automjetet	161,689.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-101,293.99</b>

**38.8.** Në përfundim, në lidhje me këtë automjet, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar blerjen e tij në shumën 101,293.99 lekë. Komisioni, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të mungesës së burimeve të ligjshme, ka vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit, në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

**38.9.** Në datën 10.12.2010 me kontratë shitjeje pasuri e luajtshme nr. \*\*\*, subjekti ka shitur automjetin tip “\*\*\*\*” për shumën 230,000 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur kontratës së shitblerjes së automjetit tip “\*\*\*\*” (depozituar nga ana e tij së bashku me deklaratën “Vetting”) një deklaratë me shkrim dore të z. L. H., i cili deklaroi se ka marrë nga subjekti shumën 69,530 lekë, e cila përfaqëson tatimin për mjetin.

**38.10.** I pyetur në lidhje me këtë deklaratë, subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021 ka deklaruar *se nuk është në dijeni të kësaj deklarate dhe për këtë arsye nuk mund të shprehet. Gjithashtu, nga interesimi i tij pranë noteres znj. M. P. nuk rezulton që bashkëlidhur kësaj kontrate të jetë depozituar një deklaratë me shkrim dore nga z. L. H..*

**38.11.** Ky deklarami i subjektit nuk përputhet me inventarin e dokumentacionit justifikues/shoqërues të deklaratës së pasurisë “Vetting”, të nënshkruar nga ana e tij, nga ku rezulton se në faqen \*\*\*, me nr. rendor \*\*\* është shënuar kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep./kol., datë 10.12.2010, numri i faqeve 3, ku në numërtim është përfshirë dhe shkresa e dorës e z. L. H. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka refuzuar të përgjigjet në përgjigje të pyetësorit të datës 20.9.2021, duke kërkuar t’i vihej në dispozicion një kopje e këtij dokumenti të hartuar me shkrim dore nga blerësi. Komisioni konstaton se subjekti ka refuzuar të japë shpjegime në lidhje me një dokument të dorëzuar nga vetë ai, së bashku me deklaratën “Vetting”, veprimi i cili nuk përputhet me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

**38.12.** Nga verifikimi i deklaratave periodike rezulton se subjekti në DPV/2012, si burim për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” ka deklaruar të ardhurat e realizuara nga paga e të dy bashkëshortëve, ndërkohë në deklaratën “Vetting” ka deklaruar me të ardhurat nga shitja e automjetit “\*\*\*\*”.

**38.13.** Në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021, ka sqaruar se në deklaratën periodike të vitit 2004, ka deklaruar gjendje *cash* 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë, të cilat i ka mbajtur çdo vit gjendje *cash*. Ky veprim është kryer me qëllim që në rast nevoje gjatë vitit, të kishte një garanci në vlerë paraje. Në vitin 2010 ka shitur automjetin tip “\*\*\*\*”, me vlerë 230,000 (dyqind e tridhjetë mijë) lekë, por gjendja në fund të vitit ka mbetur përsëri e pa ndryshuar dhe nuk kishte arsye për të deklaruar ndryshim të gjendjes *cash*. Ai e ka përmendur si burim të ardhurash shitjen e automjetit “\*\*\*\*”, sepse ka qënë burim të ardhurash shtesë për atë vit.

**38.14.** Ky deklarimi i subjektit nuk përputhet me të dhënat e administruara, pasi automjeti “\*\*\*\*” është shitur në vitin 2010 dhe nuk kishte si të shërbente si e ardhur shtesë në vitin 2012, kohë kur është blerë automjeti tip “\*\*\*\*”. Gjithashtu nga ana e subjektit nuk rezulton të jetë deklaruar në DVP/2012 pakësimi i gjendjes *cash*. Për sa më sipër duket se subjekti nuk ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” burimin e ligjshëm të ardhurave për blerjen e automjetit “\*\*\*\*”.

**38.15. Analizë financiare për automjetin “\*\*\*\*”**

	<b>14.1.2012</b>
<b>Pasuri</b>	<b>195,340.07</b>
Automjet “****”	200,000.00
<b>Shtesa / Pakësime/Likuiditete</b>	<b>-4,659.93</b>
<b>Pasuri neto</b>	<b>615,505.97</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>158,395.92</b>
Të ardhurat nga puna e subjektit	122,807.42
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	35,588.50
<b>Shpenzime</b>	<b>120,900.00</b>
Shpenzime jetike	58,145.00
Shpenzime doganore për automjetin	62,755.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-157,844.15</b>

**38.16.** Në analizë financiare nuk janë përfshirë si burim të ardhurat nga shitja e automjetit “\*\*\*\*”, për sa kohë subjekti ka deklaruar se të ardhurat e përfituara nga ky automjet nuk kanë qënë shtesë e gjendjes *cash* në vitin 2010 dhe nuk rezulton që subjekti në DVP/2012 të ketë deklaruar pakësim të gjendjes *cash*. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar blerjen e tij, në shumën 157,844.15 lekë.

**38.17.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti shpjegoi se më 31 dhjetor 2011 ka pasur gjendje *cash* 600,000 lekë, në të cilën kanë qënë të përfshira edhe të ardhurat e automjetit të shitur. Kjo gjendje *cash*, e deklaruar prej vitesh, është marrë në konsideratë edhe në analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit. Duke pasur gjendje *cash*, e ka përdorur atë përgjatë vitit dhe e ka zëvendësuar me të ardhurat vjetore të tij dhe të bashkëshortes, duke qëndruar e pandryshuar në fund të vitit 2012. Subjekti ka pretenduar se automjetin e ka blerë me këtë gjendje *cash* në janar 2012. Sipas tij në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar burim automjetin “\*\*\*\*”, por të ardhurat nga shitja e automjeteve, kanë qënë gjithmonë në gjendjen *cash* e ruajtur në fund të vitit. “Nuk ka asnjë logjikë ekonomike që të kemi gjendje *cash* në shtëpi, me të ardhura të ligjshme dhe të arrini në konkluzione që nuk kemi pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, duke llogaritur vetëm të ardhurat e 14 ditëve të janarit 2012.”

**38.18.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti, në deklaratën “Vetting” ka deklaruar si burim për këtë automjet të ardhurat nga shitja e automjetit tip “\*\*\*\*”, ndërkohë në DVP/2012, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e tij të vitit dhe në asnjë moment nuk ka deklaruar si burim kursimet *cash*.

Në përfundim, Komisioni çmon se gjendemi të paktën para plotësimit të deklaratës “Vetting” jo në përputhje me kërkesat e ligjit, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë; për pasojë, zbatimi i nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, që e konsideron deklaratën “Vetting”

të saktë, nuk gjen zbatim. Gjithashtu, subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, në shumën 157,844.15 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016. Në të njëjtën mënyrë, si më lart, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të mungesës së burimeve të ligjshme, Komisioni do e vlerësojë këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

## **Në lidhje me automjet në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur ndër vite**

### **Hetimi<sup>33</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

**39.** Subjekti, në deklaratën fillestare të vitit 2003, ka deklaruar autoveturë “\*\*\*\*”, targa \*\*\*, vlera 40,000 lekë. Në DPV/2008 deklaroi shitjen e saj në datën 13.11.2008, për shumën 60,000 lekë.

**39.1.** Në lidhje me këtë automjet, nga hetimi ka rezultuar se është blerë në datën 30.12.2000 (nuk ka numër më pas), me kontratën nr. \*\*\*, në shumën 200,000 lekë. Ky automjet është shitur në datën 13.11.2008, me kontratën nr. \*\*\*, në shumën 60,000 lekë.

**39.2.** Nga të dhënat e AMF-së rezulton se vajza e subjektit, M. L., ka prerë polica sigurimi vjetore për automjetin tip “\*\*\*\*”, me targa \*\*\*\*, për periudhat: (i) 9.3.2013-8.3.2014; (ii) 26.7.2011-25.7.2012; (iii) 17.7.2010-16.7.2011.

**39.3.** Në lidhje me këtë automjet, subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021, ka deklaruar se pronari i automjetit tip “\*\*\*\*”, me targa \*\*\* është z. G. P., me të cilin vajza e tij ka marrëdhënie miqësie. Përdorimi i këtij automjeti ka filluar në vitin 2011 dhe ka vazhduar deri në momentin që automjeti kaloi në gjendje amortizimi, pasi ishte prodhim i vitit 1989. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 16.9.2021, të shtetasit G. P. dhe deklaratën noteriale nr. \*\*\*\*, datë 16.9.2021, të znj. M. L., përmbajtja e të cilave përkon me përgjigjen e subjektit në pyetësorin e mësipërm.

**39.4.** Në përgjigje të pyetësorit të datës 25.10.2021, subjekti ka sqaruar se ky automjet është përdorur nga vajza e tij për periudhën 2011-2014 dhe se vajza e tij nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën noteriale të datës 16.9.2021, se e ka këtë automjet ende në përdorim. Ajo ka deklaruar se autorizimi i z. P. është lëshuar në vitin 2011 dhe në vazhdim për shkak të faktit që nuk mban datë përfundimi të tagrave të përdorimit. Miqësia mes tyre vijon aktualisht kështu që nuk është vlerësuar i nevojshëm revokimi i autorizimit. Subjekti ka deklaruar se vajza e tij është pajisur me leje drejtimi në maj të vitit 2010, dhe si shofere e re, ka përdorur këtë makinë për t’u praktikuar.

**39.5.** Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 28.6.2010. Nëpërmjet kësaj prokure, z. P. i ka dhënë të gjitha tagrat ligjore vajzës së subjektit, që automjetin e mësipërm ta përdorë, ta shesë, ta dhurojë, t’ua japë në përdorim të tretëve, ta vetëblejë. Në këtë prokurë, z. P. shprehet se: *“Nga ky moment përfaqësuesja ka të drejtën e përfitimit të gjithë të ardhurave financiare në shitje, duke deklaruar unë likuidimin nga ana e këtij të fundit. Prokura është pa afat dhe nuk mund të revokohet nga ana ime pa pëlqimin e përfaqësueses.”*

**39.6.** Në përfundim, konstatohet se vajza e subjekti ka pasur të gjitha tagrat e përfaqësimit për automjetin e mësipërm, duke filluar nga viti 2010 e deri aktualisht, bazuar në prokurën nr. \*\*\*, datë 28.6.2010, e cila nuk rezulton të jetë revokuar. Ajo ka prerë polica sigurimi vjetore për këtë automjet për periudhën 2010-2014.

---

<sup>33</sup> Shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020; Kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020; shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor nr. \*\*\*prot., datë 14.7.2021; kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2021; shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2021; kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2021.



**39.7.** Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me këtë automjet, për të cilin lindin dyshime se (i) prokura është fiktive dhe ka përmbajtjen e një kontrate dhurimi; (ii) subjekti dhe vajza e subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, nuk kanë deklaruar posedimin e këtij automjeti nga ajo në deklaratat periodike vjetore 2011-2014, dhe as në pyetësonin standard.

**39.8.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti parashtroi se Komisioni pa të drejtë interpreton një akt të njëanshëm të lëshuar nga ana e pronarit të automjetit, siç është prokura e përfaqësimit, duke e veshur atë si kontratë dhurimi. Ai ka parashtruar se vajza e tij thjesht e ka përdorur atë mjet, për shkak të marrëdhënieve miqësore të ruajtura prej vitesh, por në asnjë rast nuk është menduar si i dhuruar apo i tjetërsuar me të drejta të plota reale tek ajo. Kontrata e dhurimit është një veprim juridik i dyanshëm, duhet nënshkruar nga dhuruesi dhe pranuesi i dhurimit, përndryshe është absolutisht i pavlefshëm, pasi nuk plotëson kushtet kryesore që kërkojnë dispozitat ligjore të Kodit Civil. Nga ana tjetër, prokura, është gjithnjë e njëanshme, dhe pavarësisht çfarë parashikohet në këtë prokurë, e cila nuk është nënshkruar nga vajza e tij, por nga vetë lëshuesi i prokurës, është një akt i cili mund të revokohet në çdo kohë, pasi vetë neni 75 e përcakton qartësisht këtë. Subjekti ka sjellë si referencë vendimin unifikues nr. 932, datë 22.6.2000, të Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë, që ka unifikuar qëndrimin në lidhje me vlerësimin e veprimeve fiktive, duke u shprehur se: *“Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik, të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre...”*

**39.9.** Lidhur me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit, subjekti ka sqaruar se nuk ka vlerësuar ta deklarojë këtë përdorim, për sa kohë ka menduar se nuk jemi as përpara fitimit të të drejtave pasurore të një pasurie, shitjes, dhurimit apo marrëdhënies së huas, veprime juridike të cilat detyrojnë subjektet që të deklarojnë në deklaratën e interesave periodikë vjetorë. Subjekti ka theksuar se pavarësisht kësaj, pasaktësitë në mënyrën e të plotësuarit të deklarimeve periodike nuk kanë të bëjnë me mosdeklarimin e pasurisë apo mosdeklarimin e burimit të krijimit të të ardhurave pasuritë, pasi në asnjë rast nuk dëshmojnë për përpjekje për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë, me qëllim, pasuritë në përdorim.

**39.10.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti nuk dha asnjë shpjegim se pse ende deri aktualisht nuk është revokuar prokura e lëshuar nga z. P., sipas së cilës vajza e subjekti ka pasur të gjitha tagrat e përfaqësimit për automjetin më lart. Subjekti nuk dha asnjë shpjegim se cilat kanë qenë arsyet që nuk ka deklaruar në pyetësonin standard përdorimin e këtij automjeti.

Në përfundim, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se (i) pjesë përbërëse e prokurës së nënshkruar nga z. P. është dhe karta e identitetit e znj. M. L.; (ii) në prokurë deklarohet qartë se prokura është pa afat dhe nuk mund të revokohet nga ana e z. Pohumi pa pëlqimin e vajzës së subjektit; (iii) subjekti nuk depozitoi asnjë dokument për të provuar që kjo prokurë është revokuar; vlerëson se jemi para një prokure fiktive, e cila duket sikur është kontratë dhurimi dhe se subjekti duhej të ishte transparent me Komisionin, duke deklaruar përdorimin e saj në pyetësonin standard. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me këtë automjet, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

**40. Llogari bankare pranë “Credins Bank”. Vlera 1.500 lekë. Pjesa takuese 100%.**

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** nuk deklarohet.

**40.1. Hetimi<sup>34</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

---

<sup>34</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020 drejtuar Bankave; kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2020.



Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit në “Credins Bank” rezulton se gjendja në datën 27.1.2017 është 1,500 lekë. Nuk rezultojnë paqartësi në lidhje me këtë.

**41. Llogari bankare<sup>35</sup> pranë “Alpha Bank”.** Vlera 35 euro. Pjesa takuese 50%.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** nuk deklarohet.

**41.1. Hetimi<sup>36</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit në “Alpha Bank” gjendja në datën 4.1.2017 është 8.98 Euro. Nuk rezultojnë paqartësi në lidhje me këtë.

**42. Llogari bankare pranë “Raiffeisen Bank”.** Vlerë 0 lekë. Pjesa takuese 100%.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** nuk deklarohet.

**42.1. Hetimi<sup>37</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se gjendja në datën 16.1.2017 është 0 lekë. Nuk rezultojnë paqartësi në lidhje me këtë.

**43. Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit**

**43.1. Konstatimi i ILDKPKI-së:** deklaram i pasaktë lidhur me të ardhurat e b/shortes së subjektit pranë shoqërisë “\*\*\*\*”, pasi në deklaratat e interesave private për periudhën 2008 - 2015 janë deklaruar të ardhura në shumën rreth 10.706.000 lekë, ndërsa vërtetimi i shoqërisë citon se të ardhurat për periudhën 2008 – 2015 janë në shumën 13.640.000 lekë. Për periudhën 2012 – 2015, të ardhurat e bashkëshortes pranë shoqërisë “\*\*\*\*” janë deklaruar në shumën rreth 6.550.000 lekë, ndërkohë sipas ISSH-së, për periudhën 2012 – 2016, të ardhurat neto janë në shumën 2.860.000 lekë.

**Hetimi<sup>38</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

**44.** Subjekti, në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka përfituar të ardhura nga paga në shoqërinë “\*\*\*\*” në shumën 13,640,000 lekë, për periudhën qershor 2008-shtator 2015. Për të provuar deklarinimin e tij ka depozituar vërtetimin, datë 28.10.2016, të shoqërisë “\*\*\*\*”, ku deklarohet se znj. F. L. ka realizuar të ardhura nga paga dhe bonuse sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Shuma/lekë
2008	1,400,000
2009	1,800,000
2010	1,800,000
2011	1,800,000
2012	1,800,000
2013	1,800,000
2014	1,800,000
2015	1,440,000

<sup>35</sup> Subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie në emër të F. L. dhe Artan Lulaj në “Alpha Bank”, për periudhën 1.1.2016 - 23.1.2017.

<sup>36</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar Bankave; kthim përgjigjeje “Alpha Bank” nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020.

<sup>37</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar Bankave; kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020.

<sup>38</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2021, drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2021; kthim përgjigjeje Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020 drejtuar Bankave; kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020; kthim përgjigjeje “Tirana Bank” nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020.

**44.1.** Në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortes nga kjo shoqëri si më poshtë:

Viti	Shuma
2008	400,000 lekë të ardhura nga paga në D.P.Tatime deri më 31.5.2008 dhe paga pranë kompanisë “****” nga data 1.10.2008.
2009	1,440,000 lekë
2010	1,818,000 lekë
2011	1,818,000 lekë
2012	1,800,000 lekë
2013	1,880,000; në këtë shumë përfshihet dhe shuma 250,000 lekë, paguar nga DPT nëpërmjet zyrës së përbarimit “****”, Tiranë, në ekzekutim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 25.5.2009.
2014	1,800,000 lekë dhe 3,500,000 lekë nga zyra e përbarimit “****”
2015	1,320,000 lekë dhe si ekonomiste pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nga muaji shtator 157,500 lekë

**44.2.** Duke krahasuar të ardhurat e deklaruara nga shoqëria “\*\*\*\*” në vërtetimin e datës 28.10.2016, me të ardhurat e deklaruar nga subjekti në DPV rezulton se ato nuk përputhen me njëra - tjetrën, më konkretisht:

- i. në vitin 2008, subjekti ka deklaruar shumën 400,000 lekë si të ardhura, ndërkohë shoqëria “\*\*\*\*” deklaroi shumën 1,400,000 lekë;
- ii. në vitin 2009, subjekti ka deklaruar shumën 1,440,000 lekë, ndërkohë shoqëria “\*\*\*\*” deklaroi shumën 1,800,000 lekë;
- iii. në vitet 2010-2011, subjekti ka deklaruar shumën 1,818,000 lekë, ndërkohë shoqëria “\*\*\*\*” deklaroi shumën 1,800,000 lekë;
- iv. në vitin 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 1,630,000 lekë, ndërkohë shoqëria “\*\*\*\*” deklaroi shumën 1,800,000 lekë.
- v. në vitin 2015, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 1,320,000 lekë, ndërkohë shoqëria “\*\*\*\*” deklaroi shumën 1,440,000 lekë.

**44.3.** ISSH-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2017, gjendur në dosjen e ILDKPKI-së, informohemi se bashkëshortja e subjektit ka pasur këto paga pranë shoqërisë “\*\*\*\*”:

Periudha	Paga bruto lekë	Paga neto lekë
Janar 2012-gusht 2012	90,000 lekë	56,531
Shtator 2012-gusht 2013	90,000	55,890
Shtator 2013-nëntor 2013	100,000	63,459
Janar 2014	100,000	63,293
Shkurt 2014-korrik 2014	100,000	64,193
Gusht 2014-nëntor 2014	100,000	63,828
Dhjetor 2014 - dhjetor 2015	100,000	63,727
Janar 2016	22,000	15,862

**44.4.** Komisioni ka administruar shkresa e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë<sup>39</sup>, sipas së cilës pagat e deklaruar në listëpagesat e shoqërisë “\*\*\*\*” për periudhën 2011-2015 për bashkëshorten e subjektit janë si më poshtë:

Periudha	Paga bruto/muaj/lekë	Tatimi i mbajtur/muaj/lekë
Dhjetor 2011	90,000	9,000
Janar 2012- dhjetor 2012	90,000	9,000
Janar 2013- gusht 2013	90,000	9,000
Shtator 2013- janar 2014	100,000	10,000
Shkurt 2014- dhjetor 2015	100,000	9,100

<sup>39</sup> nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2021

**44.5.** Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjekti të rivlerësimit në “Tirana Bank” rezulton se ajo ka përfituar në total shumën 5,125,057 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Vlera në lekë
2008	78,800
2009	673,367
2010	863,676
2011	860,492
2012	427,062
2013	238,035
2014	952,140
2015	952,140
2016	79,345
<b>Total</b>	<b>5,125,057</b>

Kjo shumë përputhet dhe me pagat e deklaruara nga shoqëria “\*\*\*” në organet tatimore dhe në ISSH.

**44.6.** Në lidhje me mospërputhjen midis deklarimeve të subjektit në deklaratën “Vetting” dhe të dhënave të administruara nga Banka, Tatimet dhe ISSH-ja për të ardhurat e bashkëshortes së tij, ai, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021 dhe 20.9.2021 ka sqaruar se bashkëshortja ka punuar pranë shoqërisë “\*\*\*” sha, përgjatë periudhës qershor 2008 - shtator 2015. Gjatë kësaj kohe, krahas pagës mujore për të cilën rezulton e pasqyruar edhe në sigurimet shoqërore, e siguruar me pagë maksimale, ka marrë rregullisht shpërblime nga arka e shoqërisë. Për këto shpërblime është paguar tatimi në burim nga shoqëria dhe njëkohësisht është reflektuar në bilancin e kësaj shoqërie. Shuma prej 6,309,596 (gjashtë milionë e treqind e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, konsiston në pagat mujore të deklaruara në sistemin tatimor dhe pranë Sigurimeve Shoqërore, mbi të cilat janë paguar kontribute dhe tatimi mbi pagat. Periudhat: tetor – nëntor 2008, qershor – dhjetor 2012 dhe janar – gusht 2013, janë deklaruar në listëpagesat mujore të depozituara pranë Sigurimeve Shoqërore dhe organeve tatimore, por janë tërhequr cash nga arka e shoqërisë për shkaqe subjektive të shoqërisë. Diferenca midis shumës së deklaruar 13,640,000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë, në deklaratën “Vetting” dhe pagave mujore në vlerën 6,309,596 (gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë është përfituar nga shpërblime gjatë vitit, të paguara nga arka e punëdhënësit, mbi të cilat shoqëria ka paguar tatimin në burim. Gjatë kohës që ka punuar në këtë shoqëri, është paguar me pagën maksimale mbi të cilën derdhen kontributet ose më të madhe se ajo. Gjithashtu, shuma vjetore pagë + shpërblime marrë në arkë dhe bankë, nuk e ka kaluar asnjëherë shumën prej 2,000,000 (dy milion) lekësh, çka do ta detyronte atë të deklaronte në DIVA”.

**44.7.** Subjekti, së bashku me pyetësorin e datës 7.9.2021, ka depozituar:

- i. vërtetim për bazën e vlerësuar të datës 16.9.2021, i cili është lëshuar për pagën kontributiv.
- ii. vërtetime të shoqërisë “\*\*\*” sh.a si më poshtë:
  - vërtetim, datë 20.3.2013, ku deklarohet se bashkëshortja e subjektit ka pagë mujore 150,000 lekë;
  - vërtetim, datë 20.3.2014, ku deklarohet se bashkëshortja e subjektit është e punësuar pranë shoqërisë “\*\*\*” sh.a dhe të ardhurat vjetore janë 1,630,000 lekë
  - vërtetim, datë 15.3.2015, ku deklarohet se bashkëshortja e subjektit është e punësuar pranë shoqërië “\*\*\*” sh.a dhe të ardhurat vjetore janë 1,800,000 lekë
  - vërtetim, datë 16.2.2016, ku deklarohet se bashkëshortja e subjektit ka përfituar të ardhura në formën e pagës dhe shpërblimeve në shumën 1,320,000 lekë.

Këto vërtetime nuk përputhen plotësisht me vërtetimin e datës 28.10.2016 të kësaj shoqërie për sa u përket viteve 2013<sup>40</sup> dhe 2015.<sup>41</sup>

**44.8.** Subjekti, së bashku me pyetësozin e datës 20.9.2021, ka depozituar kthim përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2021, të Drejtorisë së Arkivit të Rajonit Tiranë, ku pagat e bashkëshortes së tij janë si më poshtë:

Periudha	Paga bruto lekë	Paga neto lekë
Tetor - nëntor 2008	50,000	50,000
Dhjetor 2008	80,000	65,700
Janar - prill 2009	80,000	74,150
Maj- nëntor 2009	80,000	80,000
Dhjetor 2009	90,000	80,600
Janar- qershor 2010	90,000	80,600
Korrik 2010 - qeshor 2011	90,000	84,100
Korrik - dhjetor 2011	90,000	87,700

**44.9.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar prej tij, konstaton se në këtë dokumentacion vihen re mospërputhje në lidhje me vlerën e pagave të përfituara nga bashkëshortja e tij, ndër vite, pranë shoqërisë “\*\*\*\*”. Deklarimi i subjektit se është paguar tatimi në burim për pagat e bashkëshortes, të marra jashtë sistemit bankar, nuk përputhet me legjislacionin tatimor në fuqi, pasi për të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet e punës paguhet tatim mbi të ardhurat personale. Gjithashtu, subjekti nuk provoi me dokumentacion përfitimin e një shume më të lartë page nga bashkëshortja e tij se të shumës së kaluar nëpërmjet sistemit bankar.

**44.10.** Në përfundim në lidhje me të ardhurat nga puna e bashkëshortes pranë shoqërisë “\*\*\*\*” konstatohet se: (i) vërtetimet e shoqërisë “\*\*\*\*”, të depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ nuk përputhen plotësisht me vërtetimin e datës 28.10.2016 të kësaj shoqërie. (ii) vërtetimi i datës 28.10.2016 i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk përputhet me deklaratimet e subjektit në DPV; (iii) subjekti nuk provoi me dokumentacion provues pagimin e detyrimeve tatimore për shumën 13,640,000 lekë; (iv) subjekti nuk provoi me dokumentacion provues së bashkëshortja e tij ka përfituar shumën 13,640,000 nga shoqëria “\*\*\*\*”.

Për rrjedhojë, në analizë financiare do të përfshihet vetëm shuma e përfituar nga bashkëshortja e subjektit nëpërmjet sistemit bankar në vlerën 5,125,057 lekë, për të cilën janë paguar dhe detyrimet tatimore.

Subjekti iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**44.11.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se nga muaji qershor i vitit 2012 deri në muajin gusht të vitit 2013, pagat janë dhënë nga shoqëria “\*\*\*\*” pranë arkës së shoqërisë, për të gjithë punonjësit, për shkak të bllokimit të llogarive të saj për detyrime të pashlyera. Pra, paga e marrë pranë shoqërisë “\*\*\*\*” dhe e deklaruar në listëpagesat pranë Drejtorisë së Tatimeve e ISSH-së është 6,309,596 lekë dhe jo 5,125,057 lekë, sikurse pretendon Komisioni. Po kështu, shpjegon subjekti më tej, në përgjigje të pyetësorëve ka sqaruar qartësisht se bashkëshortja ka punuar pranë kësaj shoqërie përgjatë periudhës qershor 2008 - shtator 2015. Gjatë kësaj kohe, krahas pagës mujore për të cilën rezultoni e pasqyruar edhe në sigurimet shoqërore e siguruar me pagë maksimale, ka marrë rregullisht shpërblime nga arka e shoqërisë. Për këto shpërblime është paguar tatimi në burim nga shoqëria dhe njëkohësisht është reflektuar në bilancin e kësaj shoqërie.

<sup>40</sup> Të ardhurat në vërtetimin e datës 28.10.2016 janë deklaruar në shumën 1,800,000 lekë për vitin 2013, ndërkohë në vërtetimin e datës 20.3.2014 deklarohen 1,630,000 lekë.

<sup>41</sup> Të ardhurat në vërtetimin e datës 28.10.2016 janë deklaruar në shumën 1,440,000 lekë për vitin 2015, ndërkohë në vërtetimin e datës 16.2.2016 deklarohen 1,320,000 lekë.

**44.12.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Shpjegimet e subjektit në lidhje me faktin që bashkëshortja e tij ka përfituar të ardhura në formën e shpërblimit nga arka e shoqërisë mbeten në nivel deklarativ. Ai nuk ka provuar me dokumentacion provues pagimin e detyrimeve tatimore, si dhe këto të ardhura nuk rezultojnë të deklaruara në organt tatimore dhe as në ISSH. Në këto kushte, si dhe bazuar në praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,<sup>42</sup> Komisioni do të përfshijë në analizë financiare vetëm të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

Komisioni vlerëson të pranojë pretendimin e subjektit në lidhje me pagën e përfituar nga bashkëshortja për periudhën qershor i vitit 2012 deri në muajin gusht të vitit 2013, duke i përfshirë në analizë financiare pagat e përfituara prej saj, për sa kohë rezulton se janë paguar detyrimet tatimore, pavarësisht se nuk provohet marrja efektive e këtyre të ardhurave. Përfshirja e tyre në analizën financiare nuk ndikon rezultatin përfundimtar negativ të subjektit.

Në përfundim, Komisioni duke marrë në konsideratë se (i) vërtetimet e shoqërisë “\*\*\*\*”, të depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, nuk përputhen plotësisht me vërtetimin e datës 28.10.2016 të kësaj shoqërie; (ii) vërtetimi i datës 28.10.2016 i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk përputhet me deklaratimet e subjektit në DPV; (iii) subjekti nuk provoi me dokumentacion provues pagimin e detyrimeve tatimore për shumën 13,640,000 lekë; (iv) subjekti nuk provoi me dokumentacion provues se bashkëshortja e tij ka përfituar shumën 13,640,000 nga shoqëria “\*\*\*\*”, çmton se deklarimi i subjektit në këtë rast vlerësohet nga trupi gjykues si deklarim i pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, referuar parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

**44.13.** Subjekti, në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka përfituar të ardhura nga largimi padrejtësisht nga puna në shumën 4,996,520 lekë. Në datën 25.5.2009, me vendimin nr. \*\*\*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur rikthimi në punë i bashkëshortes së subjekti dhe detyrimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të paguajë pagën deri në ditën e ekzekutimit të vendimit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

Ekzekutimi i këtij vendimi është bërë nëpërmjet sistemit bankar në llogarinë e znj. F. L. nga shoqëria përmbarimore “\*\*\*\*” në:

i) Tirana Bank:

Data e veprimit	Shuma në lek
3.5.2013	250,000
12.2.2014	261,720
1.7.2014	3,167,800

Si dhe ii) në “Raiffeisen Bank” nga ku rezulton se në datën 20.1.2016 është depozituar shuma 1,317,000 lekë. Nuk rezultojnë paqartësi në lidhje me këtë deklaram.

## **DETYRIME FINANCIARE**

**45. Kredi<sup>43</sup>** e marrë për blerje apartamenti në Durrës, marrë në “Alpha Bank”, në shumën 30.000 euro, me afat për 15 vjet, me këste tremujore të ndryshueshme. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit është 10.000 euro principal dhe 981 euro interesa.

**45.1. Trajtuar në pikën 36.1. të këtij vendimi.**

<sup>42</sup> Vendim nr. 23/2020, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

<sup>43</sup> Subjekti ka depozituar deklaratën e datës 25.1.2017 nga “Alpha Bank”.

**46. Kredi**<sup>44</sup> konsumatore marrë nga “Tirana Bank” në shumën 700.000 lekë, me afat shlyerjeje për 5 vjet. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit është 556.612 lekë.

#### Hetimi<sup>45</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

**46.1.** Në datën 29.9.2015, subjekti, së bashku me bashkëshorten e tij, kanë lidhur kontratë kredie bankare konsumatore nr. \*\*\*, datë 25.9.2015, për marrjen e një huaje në shumën 700,000 lekë nga “Tirana Bank” me afat 5-vjeçar. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit rezulton se kredia është disbursuar në datën 30.9.2015 në shumën 700,000 lekë dhe është tërhequr në datën 2.10.2015 në shumën 691,000 lekë. Në kontratë përcaktohet se qëllimi i kësaj kredie është për mobilim shtëpie.

**47. Gjendje cash** në shumën 1,300,000 lekë

#### Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

**47.1.** Subjekti, bazuar në procesverbalin e datës 3.3.2016<sup>46</sup>, ka deklaruar përpara ILDKPKI-së se gjendja *cash*, në datën 31.12.2014, ka qenë 1,300,000 lekë, të cilën nuk e ka deklaruar si gjendje *cash*, por ka deklaruar vetëm të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit në shumën 3,500,000 lekë, nga të cilat, 1,500,000 lekë janë shpenzuar për arredimin e shtëpisë dhe pjesa tjetër janë kursime. Siç rezulton dhe në këtë deklaram të subjektit përpara ILDKPKI-së, ai në vitin 2014, të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor i ka deklaruar si kursim dhe nuk rezulton të ketë deklaruar faktin se ka kryer shpenzime për rikonstruksionin e apartamentit në shumën 2,000,000 lekë dhe se burimi i këtyre shpenzimeve ka qenë pikërisht këto të ardhura.

**47.2.** Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e subjektit për të krijuar kursime *cash* në shumën 1,300,000 lekë në vitin 2014, shumë e cila rezulton të jetë e mbartur në deklaratën “Vetting”.

#### Analizë financiare

	<b>2014</b>
<b>Pasuri</b>	<b>653,606.03</b>
Shtesa / Pakësime/ Likuiditete	653,606.03
<b>Detyrime</b>	<b>-378,297.00</b>
Shlyerje detyrimi i kredisë në “Alpha Bank”	-378,297.00
<b>Pasuri neto</b>	<b>1,031,903.03</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>5,901,961.00</b>
Të ardhurat nga puna e subjektit	1,409,232.00
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	1,031,485.00
Të ardhura nga vendimi nr. ***, datë 25.5.2009	3,429,520.00
Të ardhurat e vajzave	31,724.00
<b>Shpenzime</b>	<b>6,329,990.01</b>
Shpenzime jetike	1,099,990.00
TIMS	369,006.27
Shpenzime për rindarje të apartamentit	2,000,000.00
Shpenzime mobilimi të apartamentit 114 m <sup>2</sup> gjatë 2014	1,500,000.00

<sup>44</sup> Subjekti ka depozituar konfirmim nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2017 nga “Tirana Bank”.

<sup>45</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020 drejtuar Bankave; kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020; kthim përgjigjeje “Tirana Bank” nr.\*\*\* prot., datë 21.1.2020.

<sup>46</sup> Shih kthim përgjigjen e ILDKPKI-së nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2021.

Shpenzime për ceremoni familjare 1,000,000 lekë	1,000,000.00
Shpenzime blerje me kartë krediti	360,993.74
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-1,459,932.04</b>

**47.3.** Në analizën financiare për vitin 2014 është përfshirë edhe shuma 1,000,000 lekë, të cilën subjekti i rivlerësimi e ka deklaruar tek të dhënat konfidenciale në deklaratën “Vetting”, si shpenzim për ceremoni familjare. Në lidhje me këtë shumë, subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 25.10.2021 ka sqaruar se: *“...në deklaratën për rivlerësimin e pasurisë vetting, në rubrikën ‘të dhëna konfidenciale’, kam deklaruar shprehimisht se: “shpenzime për rimobilim të po këtij apartamenti të kryera gjatë vitit 2014 në shumën 1.500.000 lekë. dhe shpenzime për ceremoni familjare 1.000.000 lekë.” Si konstatohet lehtësisht nga leximi, kam vendosur pikë në fund të fjalisë së parë, pra të deklaratimit që kam shpenzuar 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për rimobilimin e apartamentit gjatë vitit 2014, ndërkohë që nuk kam filluar me shkronjë të madhe fjalinë e dytë, e ndoshta kjo ka shkaktuar konfuzion, “dhe shpenzime për ceremoni familjare 1.000.000 lekë.” Nuk kam specifikuar vitin kur janë kryer këto shpenzime. Për informimin tuaj, sqaroj se shpenzimet objekt analize, janë kryer në vitin 2015 për fillimin e bashkëjetesës së vajzës time D. L. (H.), në muajin tetor 2015, për shkak të një situatë të paparashikuar. Nuk disponoj dokumentacion për këtë shpenzim, pasi është bërë në kuadër të marrëdhënies së posaçme familjare, ndodhur në kushte emergjence.”*

**47.4.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato nuk janë bindëse. Nga verifikimi i deklaratës “Vetting” rezulton se subjekti, tek të dhënat konfidenciale, ka deklaruar në të njëjtën ndarje: *shpenzime për rimobilim të po këtij apartamenti të kryera gjatë vitit 2014 në shumën 1.500.000 lekë dhe shpenzime për ceremoni familjare 1.000.000 lekë.*

Siç rezulton, subjekti ka përdorur lidhëzën “dhe”, e cila nënkupton që këto shpenzime janë kryer në vitin 2014, pasi, nëse subjekti do të kishte dashur të deklaronte shpenzime për vitin 2015, ai do t’i kishte deklaruar në një ndarje tjetër, sikundër ka deklaruar shpenzimet në vitin 2001, për rindarjen e apartamentit, në shumën 2,000,000 lekë.

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për mungesë të ardhurash të mjaftueshme të ligjshme, për krijimin e kursimeve *cash* në shumën **-1,459,932.04 lekë.**

**47.5.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti parashtrori të njëjtat argumente si më sipër. Ai ka theksuar se nuk disponon dokumentacion për këtë shpenzim, pasi është bërë në kuadër të marrëdhënies së posaçme familjare, ndodhur në kushte emergjence. Po kështu, sipas subjektit, fakt i pakontestueshëm është marrja e kredisë pranë “Tirana Bank”, që daton pikërisht në vitin 2015, në shumën prej 700.000 lekë, shumë së cilës i është shtuar edhe vlera prej 300.000 lekë nga kursimet e tij familjare.

**47.6.** Komisioni, duke u bazuar në argumentimin e mësipërm konstaton se, subjekti, në deklaratën “Vetting”, nuk ka deklaruar se këto shpenzime janë bërë në vitin 2015. Gjithashtu, edhe sikur shuma prej 1,000,000 lekësh të mos përfshihej në analizë financiare të këtij viti, sërish subjekti do të ishte me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kursimeve të gjendjes *cash*. Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit në lidhje me shpenzimet me kartë debiti<sup>47</sup>, duke i hequr ato nga analiza financiare.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë të burimesh financiare të ligjshme në shumën **-1,098,938.30 lekë** për të financuar krijimin e kursimeve *cash*.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>47</sup> Shih pikën 52.2. të këtij vendimi.

## **DEKLARIM I BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT- F.L.**

**48. Llogari bankare<sup>48</sup>** pranë “Alpha Bank”, \*\*\*, vlerë 35 euro. Pjesa 50%. **Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** nuk deklarohet.

**48.1. Hetimi<sup>49</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri është** trajtuar në pikën 41. të këtij vendimi.

**49. Llogari bankare<sup>50</sup>** pranë “Tirana Bank” nr. \*\*\*, vlerë 0. Pjesa 100%. **Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** nuk deklarohet.

### **Hetimi<sup>51</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

**49.1.** Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes në “Tirana Bank” rezulton se kishte depozitime të familjarëve të saj. Subjekti, në lidhje me këto depozitime, deklaroi se, meqenëse vëllezërit e bashkëshortes kanë në pronësi të tyre aktivitete private dhe jetojnë në qytetin e Sarandës, shpeshherë kanë kërkuar nga bashkëshortja e tij, të kryente pagesa të faturave të ndryshme për nevoja të biznesit privat. Një pjesë nga këto depozitime janë kryer në emër dhe për llogari të familjes së bashkëshortes, për shkak të një ndërhyrjeje kirurgjikale të kryer në shtetin turk ndaj nënës së saj, të cilën e ka shoqëruar bashkëshorti i saj, z. L.Q. dhe znj. F. L. Të gjitha shpenzimet për këtë ndërhyrje kirurgjikale dhe trajtimet pas ndërhyrjes janë përballuar nga vëllezërit e bashkëshortes.

**49.2.** Subjekti ka depozituar:

i) Deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 14.9.2021, të shtetasit I. Q. dhe E. Q., të cilët deklarojnë se shumtë e depozituar në llogarinë bankare të znj. F. L. janë bërë për shkak të nevojave të biznesit që kanë në pronësi.

ii) Deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 14.9.2021 të shtetasit L. Q., A. Q. dhe A. Q., të cilët deklarojnë se shumtë e depozituara në llogarinë bankare të znj. F.L. janë bërë për shkak të nevojave të biznesit që kanë në pronësi dhe për shkak të shpenzimeve mjekësore të znj. F. Q., e cila ka kryer ndërhyrje kirurgjikale në shtetin turk në vitin 2010.

Për sa kohë subjekti deklaroi se këto shumtë nuk burojnë nga të ardhurat e tij, ato nuk do të përfshihen në analizë financiare.

**50. Llogari bankare<sup>52</sup>** pranë “Raiffeisen Bank” nr. \*\*\* Vlera 3.570 lekë. Pjesa 100%. **Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** nuk deklarohet.

### **Hetimi<sup>53</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni**

**50.1.** Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes në “Raiffeisen Bank” rezulton se gjendja e llogarisë në datën 17.1.2017 ka qenë 3,549.63 lekë. Nuk rezultuan paqartësi në lidhje me këtë deklaram.

**Në lidhje me pasuritë e paluajtshme të blera nga znj. D. H. -vajza e subjektit të rivlerësimit**

<sup>48</sup> Subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie në emër të F. L. dhe Artan Lulaj në “Alpha Bank”, për periudhën 1.1.2016 - 23.1.2017.

<sup>49</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar Bankave; kthim përgjigjeje “Alpha Bank” nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020.

<sup>50</sup> Subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie në emër të F. L. në “Tirana Bank” për periudhën 2013-2016.

<sup>51</sup> Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar Bankave; kthim përgjigjeje “Tirana Bank” nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020.

<sup>52</sup> Subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie në emër të F. L. në “Raiffiesen Bank” për periudhën 2015-2016.

<sup>53</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020 drejtuar Bankave; kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” nr.\*\*\* prot., datë 21.1.2020.



## Hetimi<sup>54</sup> dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

**51.** Në datën 8.3.2021, vajza e subjektit, D. H., së bashku me bashkëshortin e saj, R. H. kanë lidhur kontratë shitjeje<sup>55</sup> pronësie me rezervë nr. \*\*\*, duke blerë nga shitësit L., M. dhe I. Th. (përfaqësuar nga av. A. K.) dhe F. K., apartament me sipërfaqe 59.5 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*” dhe apartament me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”.

**51.1.** Bazuar në kontratën e shitjes rezulton se:

- i. Çmimi për apartamentin me sipërfaqe 59.5 m<sup>2</sup> është caktuar 3,648,000 lekë.

Në seksionin të drejtave reale të kartelës së pasurisë, për këtë apartament, përcaktohet se pasuria është rivlerësuar në shumën 5,950,000 lekë, në datën 10.12.2020.

- ii. Çmimi për apartamentin me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup> është caktuar 5,701,923 lekë.

Në seksionin të drejtave reale të kartelës së pasurisë, për këtë apartament, përcaktohet se pasuria është rivlerësuar në shumën 9,300,000 lekë, në datë 12.10.2020.

- iii. Shuma e paguar do të kalojë në llogarinë bankare të z. L.Th.

**51.2.** Në total, çmimi i përcaktuar në kontratë është 9,350,000 lekë, ndërkohë vlera e rivlerësimit është 15,250,000 lekë. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021, ka sqaruar se apartamentet janë blerë në gjendje karabinaje dhe për këtë shkak është negociuar për shumën e blerjes së tij. Burimet e përdorura për blerjen e këtyre pasurive vijnë nga kredi bankare e marrë pranë bankës “OTP”, pjesërisht nga kursime familjare, të ardhura nga biznesi dhe pagat e vajzës së tij dhe bashkëshortit të saj. Vajza e tij, D.H., është larguar nga banesa pindërore në muajin janar të vitit 2016. Prej atij momenti jeton në banesën e prindërve të bashkëshortit të saj, në adresën rruga “\*\*\*\*”, ndërtesa nr. \*\*\*, shkalla nr. \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, Tiranë.

**51.3.** Deklarimi i subjektit se apartamentet ishin në gjendje karabinaje nuk përputhet me të dhënat e administruara nga ASHK-ja, nga ku rezulton se:

- i. apartamenti me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup> është përfituar nga procesi i privatizimit që në vitin 1993, si dhe i është bërë rivlerësimi në datën 12.10.2020.
- ii. apartamenti me sipërfaqe 59.5 m<sup>2</sup> është shtesa anësore e apartamentit me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup>, regjistruar nëpërmjet lejes së legalizimit. Ky apartament është rivlerësuar në datën 10.12.2020.

**51.4.** Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 20.9.2021, ka sqaruar se *ka deklaruar në statusin “karabina”, duke dashur të përshkruajë një shtëpi, e cila, në kohën e blerjes, ka qenë e amortizuar, thujse e pabanueshme. Banesa ka qenë pa dritare dhe dyer të brendshme, me mure, dysheme dhe tavane të shkatërruara, siç dëshmohet edhe nga fotografitë e depozituara bashkëlidhur pyetësorit. Pallati në të cilin ndodhet kjo banesë është gjithashtu tepër i vjetër.*

**51.5.** Nga hetimi ka rezultuar se, bazuar në raportin e vlerësimit të datës 4.2.2021<sup>56</sup>, të përgatitur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për efekt të përfitimit të kredisë, vlera e apartamenteve është përcaktuar 85.000 euro si vlerë tregu dhe 68.000 euro si vlerë e shitjes së detyruar. Sipas këtij raporti, të dy apartamentet ishin në fazë rikostruksioni të thellë, si dhe kishin riorganizim total të ambienteve të brendshme, të cilat gjithashtu ishin në fazë rikonstruksioni të thellë.

<sup>54</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2021, drejtuar ASHK-së Drejtoria Vendore Tiranë Veri; kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.09.2021; shkresë nr. \*\*\* prot. datë 14.5.2021 drejtuar ASHK-së Drejtoria Vendore Tiranë Veri; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2021, drejtuar “OTP Bank”; kthim përgjigjeje nr. \*\*\*, datë 21.9.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2021, drejtuar noterit publik M. H.; kthim përgjigjeje e datës 3.12.2021.

<sup>55</sup> Shih kthim përgjigjeje e ASHK-së Drejtoria Vendore Tiranë Veri nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2021.

<sup>56</sup> Shih kthim përgjigjen e “OTP Bank” nr. \*\*\*, datë 21.9.2021.

Bashkëlidhur raportit ndodhen dhe foto të apartamenteve, nga ku vërtetohet se apartamentet janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe se janë në fazë rikonstruksioni.

**51.6.** Në përgjigje të pyetësorit të datës 25.10.2021, subjekti ka pretenduar se vajza e tij D. H. (L.), nuk është anëtare e trungut familjar prej muajit mars 2016 dhe se ai nuk ka asnjë marrëdhënie interesi ekonomik me vajzën e tij, personin e lidhur me të. Në këto kushte, gjykon se vajza e tij nuk mund të përkufizohet sipas parashikimit të nenit 3, pika 13 apo 14 të të njëjtit nen të ligjit nr. 84/2016, e për këto arsye, nuk i ka kërkuar dhe nuk mund t'i kërkojë informacion për shpenzimet që kryen në kuadër të nevojave të familjes së saj.

Subjekti, në lidhje me burimin, deklaroi se për blerjen dhe rikonstruksionin e apartamentit janë përdorur kursime familjare të familjes së vajzës së tij dhe kredi e financuar nga banka "OTP", me kontratë kredie bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.4.2021. Të njëjtin qëndrim subjekti e mbajti edhe gjatë seancës dëgjimore kur u pyet nga trupi gjygues.

**51.7.** Në lidhje me pretendimin e subjektit se vajza e tij nuk është person i lidhur me të ose person tjetër i lidhur, Komisioni vlerëson se nuk është i mbështetur në ligjin nr. 84/2016, ku në nenin 3/13 të këtij ligji përcaktohet se "Person i lidhur" është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë. Gjithashtu, subjekti ka qenë në dijeni të kualifikimit të vajzës së tij si person i lidhur, pasi në formularin e deklaratës "Vetting" tek seksioni "të dhëna personale të subjektit dhe personave të lidhur" në kutinë ku shpjegohet personi i lidhur përcaktohet se: rrethi i personave të lidhur me subjektin...janë fëmijët në moshë madhore (brenda ose jashtë trungut familjar). Për më tepër, deklaratata "Vetting" është plotësuar dhe nga vajza e subjektit, D. L. , në cilësinë e personit të lidhur.

Për sa më sipër, për sa kohë vajza e subjektit është personi i lidhur me të, për efekt të ligjit nr. 84/2016, ai kishte detyrimin ligjor për të depozituar dokumentacion provues në lidhje me sa i është kërkuar gjatë hetimit administrativ.

**51.8.** Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacion provues për të ardhurat e vajzës së tij për blerjen dhe rikonstruksionin e kësaj pasurie. Nga subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.9.2021, nuk është paraqitur dokumentacion provues.

**51.9.** Në përfundim, në lidhje me këtë apartament, në mungesë të bashkëpunimit nga subjekti i rivlerësimit për të deklaruar burimin e ligjshëm të ardhurave dhe për të depozituar dokumentacion, Komisioni konstatoi, duke i kaluar barrën e provës se: (i) subjekti është përpjekur të deklarojë në mënyrë të pasaktë këtë apartament të personit të lidhur, gjatë hetimit administrativ, duke deklaruar se ai ka qenë gjendje karabina, ndërkohë nga hetimi rezultoi se ai ishte në fazë rikonstruksioni nga vajza e tij dhe bashkëshortit të saj; (ii) subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues për të provuar burimin e ligjshëm të ardhurave të vajzës së tij për blerjen dhe rikonstruksionin e kësaj pasurie, duke u përpjekur të përjashtojë vajzën e tij nga rrethi i personave të lidhur; (iii) mbetet e paqartë arsyeja pse vajza e subjektit dhe bashkëshorti i saj i kanë blerë apartamentet në një vlerë gati dyfish më të ulët se çmimi i rivlerësimit; (iv) subjekti nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin, veprim i cili nuk përputhet me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

**51.10.** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, i qëndroi së njëjtës logjikë në lidhje me konceptin e personit të lidhur. Më tej, ai pretendoi se Komisioni nuk mund të ngarkojë me barrë prove subjektin lidhur me pasuri që nuk janë as objekt i këtij procesi rivlerësimi (pra, ky proces nënkupton rivlerësim dhe jo vlerësim) dhe as nuk lidhen me subjektin, për sa kohë këto pasuri janë krijuar nga persona që në kuptim të ligjit sot, nuk konsiderohen persona të lidhur. Përfshirja si persona të lidhur, në kuptim të nenit 4 pika 13 dhe 14, është në tejkalim të parashikimeve të ligjit dhe praktikës së organeve të rivlerësimit të mbajtur në raste të tjera. Konkretisht, në vendimin (JR) nr. 15, datë 17.7.2019, të KPA-së, në këndvështrim të Kolegjit, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të

verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave. Lidhur me sa më sipër, hetimi që është kërkuar të kryhet nga Komisioni, mbi pasuri të cilat ende nuk janë objekt i vlerësimit nga organi kompetent sikurse është ILDKPKI-ja, nuk janë pasuri që lidhen me të si subjekt apo me personat e tij të lidhur, nuk mund të bëhen objekt verifikimi ligjshmërie në këtë proces rivlerësimi.

**51.11.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato nuk janë bindëse.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se vajza e tij nuk është person i lidhur bazuar dhe në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ky pretendim i tij nuk qëndron dhe nuk është i mbështetur në ligjin nr. 84/2016.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se kemi të bëjmë me një pasuri të krijuar pas deklaratës “Vetting” dhe, si rrjedhojë, ajo nuk mund të jetë objekt hetimi Komisioni vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk është i mbështetur në ligj dhe as në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi në rast se ka dyshime për fshehje pasurie apo burimi i pasurisë është i krijuar deri në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting”, pasuria është objekt hetimi për Komisionin.

Komisioni i ka kaluar barrë prove subjektit, në kushtet kur ai nuk ka qënë bashkëpunues, duke mos deklaruar burimin që ka shërbyer për blerjen dhe rikonstrukcionin e kësaj pasurie, në mënyrë të tillë që, në kuadër të vendimeve të Kolegjit, të evidentohet saktë burim (nëse kishim të bënim me një burim të krijuar pas deklaratës “Vetting” apo përpara), si dhe duke marrë në konsideratë diferencën e madhe midis çmimit të rivlerësimit të kësaj pasuri me çmimin e blerjes nga vajza e subjektit, mund të ishim në kushtet e fshehjes së të ardhurave nga subjekti. Duke qenë se subjekti ka refuzuar të japë përgjigje, Komisioni nuk ka vazhduar më tej me hetimin, për të mos shkelur të drejtat e palëve të treta në këtë proces, por i ka kaluar barrën e provës subjektit për të sjellë dokumentacion dhe për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vajzës së tij.

**51.12.** Subjekti, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka depozituar asnjë dokument për të provuar burimin e ligjshëm të ardhurave të vajzës së tij dhe bashkëshortit të saj për blerjen e këtij apartamenti dhe rikonstrukcionin e tij. Subjekti ka refuzuar të deklarojë shpenzimet e kryera për rikonstrukcionin e apartamentit si dhe burimin e tyre. Për sa më sipër, Komisioni e ka të pamundur për të dhënë një vlerësim të plotë për këtë pasuri, ku në pamje të parë, bazuar në çmimin e ulët të blerjes së apartamenteve, të deklarimeve kontradiktore të subjektit në lidhje me statusin e kësaj pasurie dhe të mungesës së bashkëpunimit të tij, ngrihen dyshime për mungesë burimesh të ligjshme për blerjen dhe rikonstrukcionin saj, si dhe të fshehjes së mundshme të të ardhurave. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti ka tentuar të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e personit të lidhur, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit.

Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin, në kuptim të nenit 48 të po këtij ligji.

### **Analiza financiare nga fillimi i detyrës deri në deklaratën “Vetting”**

**52.** Nga analiza e kryer ndër vite, prej fillimit të detyrës deri në deklaratën “Vetting”, vlera e pamundësisë kumulative financiare të subjektit të rivlerësimit është 5,186,590.97 lekë. Subjektit iu kalua bara e provës për të provuar të kundërtën e këtij rezultati.

**52.1.** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, pretendoi se:

- a. Në analizë financiare duhej të merreshin në konsideratë:
  - të ardhurat nga aktivitet si noter për vitin 1994 dhe 2000;
  - të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit dhe dy trojeve në qytetin e Sarandës

- pagat e bashkëshortes për vitin 2012-2013;
- b. shlyerja e detyrimit ndaj “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën 5368 euro të llogaritej në vitin 2010 dhe 2011;
- c. në vitin 2015 ka marrë kredi konsumatore dhe i ka bërë dhuratë vajzës 1,000,000 lekë dhe jo në vitin 2014;
- d. paga në vitin 2010 duhej të llogaritej në shumën 1,533,965 leke dhe jo 1,228,064 lekë siç është llogaritur në analizën financiare të Komisionit;
- e. shpenzime për detyrim tatimi për shitjen e “\*\*\*\*” nuk ka pasur, sepse vlera e shitjes është më e vogël se vlera e blerjes së këtij automjeti, rënduar në analizën financiare 69,530 lekë;
- f. llogaritja e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit në disa raste nuk ishte e saktë.
- g. Komisioni, në analizë financiare, ka llogaritur shpenzimet për blerje me kartë krediti. Subjekti pretendon se këto shpenzime kanë qenë me kartë debiti, kryesisht për ushqime dhe veshmbathje, komponentë të cilat përfshihen në shpenzimet jetike.

**52.2.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se:

i. Në lidhje me pretendimet në germa a), b) dhe c), Komisioni i ka trajtuar gjërisht në këtë vendim këto pretendime.

ii. Në lidhje me udhëtimet:

- pretendimi i subjektit në lidhje me udhëtimin e datës 22.5.2010 dhe të datës 6.6.2010 nuk do të merret në konsideratë, pasi ai nuk ka depozituar dokumentacion provues.
- pretendimi i subjektit në lidhje me pushimet 10-ditore në Z, Greqi, më 20.8.2010 pranohet vetëm për koston e udhëtimit, jo për shpenzimet e qëndrimit, pasi ato janë përlllogaritur sipas vendimit të KPA-së nr. 11, datë 22.5.2019, në vlerën 50 euro në ditë qëndrimi për person.
- pretendimi i subjektit në lidhje me distancat e pretenduar nga ana e tij pranohet, duke u llogaritur distanca sipas pretendimeve të subjektit.
- pretendimi i subjektit në lidhje me udhëtimin e vajzës së tij A.L., për periudhën 1.8.2016 - 21.8.2016, pranohet, pasi subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacion provues;

iii. Në lidhje me pretendimin e subjektit për pagën në vitin 2010 ai pranohet, duke u llogaritur në analizë financiare shuma 1,536,064.00 lekë.

iv. Në lidhje me pretendimin e subjektit për llogaritjen e shpenzimeve me kartë krediti, Komisioni konstaton se jo çdo shpenzim i përket shportës, por për shkak të vlerës jodomethënëse, vlerëson të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit.

**52.3.** Në përfundim, pas pranimit të disa prej pretendimeve të subjektit, Komisioni konkludon se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 4,414,333.23 lekë, për periudhën nga fillimi i detyrës deri në deklaratën “Vetting”.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

### **Konstatime të tjera: bashkëpunimi i subjektit gjatë hetimit administrativ**

**53.** Nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, është refuzuar të kthehet përgjigje si dhe të vihet në dispozicion dokumentacion provues, pavarësisht kërkesave të Komisionit, si më poshtë vijon:

- i. subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratën e sipërmarrjes të lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për apartamentin me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>. Në këtë kontratë, sipas deklarimeve të tij në ILDKPKI, çmimi i apartamentit ishte përcaktuar 6,000,000 lekë.
- ii. subjektit i është kërkuar në dy pyetësorë të deklarojë vlerën e mobilimit të apartamentit me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup> në vitin 2001, por nga ai nuk është kthyer një përgjigje, duke penguar Komisionin në kryerjen e një analize të plotë financiare për këtë apartament.

- iii. subjekti, në lidhje me truallin me sipërfaqe 314 m<sup>2</sup>, ka refuzuar t'i kthejë përgjigje pyetjeve të dërguara nga Komisioni, pavarësisht faktit se ai ka bërë dhe pagesën përkatëse për lejen e ndërtimit. Moskthimi i përgjigjes nga subjekti është bërë pengesë për Komisionin për të kryer një llogaritje të saktë të analizës financiare të subjektit për periudhën 1992-2003.
- iv. subjekti ka refuzuar të deklarojë vlerën e investimit për objektin me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, si dhe të japë shpjegime të hollësishme në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, në lidhje me këtë objekt dhe truallin me sipërfaqe 662 m<sup>2</sup>. Moskthimi i përgjigjes nga subjekti është bërë pengesë për Komisionin për të kryer një llogaritje të saktë të analizës financiare të subjektit për periudhën 1992-2003.
- v. subjekti ka refuzuar të japë shpjegime në lidhje me një dokument të dorëzuar nga vetë ai së bashku me deklaratën "Vetting".

Për sa më sipër, rezulton se veprimet e subjektit nuk janë në përputhje me nenin 48 të ligjit 84/2016, duke iu kaluar barra e provës.

**53.1.** Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi se:

(i) në asnjë moment nuk ka pasur për qëllim të pengojë procesin e rivlerësimit të tij, por shkaqet dhe pamundësitë objektive, kanë passjellë pamundësinë për të paraqitur akte shkresore, të cilat për shkak të kohës së gjatë të kaluar, nuk i disponon. Është e vërtetë, pretendon subjekti, që si subjekt rivlerësimi, ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, por kjo nuk mund të përkthehet në imponim për të prodhuar akte juridike, të cilat nuk gjenden. Kontratën e sipërmarrjes të lidhur për apartamentin në Tiranë, nuk ka arritur ta gjejë pavarësisht vullnetit dhe përpjekjeve të tij. Subjekti ka pretenduar se ka deklaruar me sinqeritet të gjithë burimin dhe faktet e kërkuara nga Komisioni, për aq sa disponon sot, duke sjellë në vëmendje që kanë kaluar pothuajse 20 vite nga momenti kur ky akt është përpiluar dhe sigurisht që ekziston dhe mundësia e mosgjetjes së saj;

(ii) në lidhje me vlerën e mobilimit, subjekti ka pretenduar se, në momentin kur është pyetur nga Komisioni, nuk mund të përcaktonte saktësisht një vlerë të tillë, në kushtet e mungesës së kujtesës;

(iii) lidhur me refuzimin për dokumentin që i bashkëlidhet kontratës së shitjes së automjetit, të cilën parashtron se nuk disponon të dhënat e mjaftueshme, pasi është një deklaratë dore e nënshkruar nga vetë blerësi i automjetit, sqaron se ky dokument nuk përbën asnjë fakt apo akt provues që i shërben hetimit të Komisionit. Subjekti sqaron se i është drejtuar edhe noteres, por as ajo nuk e dispononte një dokument të tillë;

(iv) subjekti është mbrojtur duke parashtruar se qëllimi i dispozitave kushtetuese e ligjore që rregullojnë këtë çështje, si edhe fryma e procesit në tërësi, kërkon mbajtjen e qëndrimit për subjektet të cilët në mënyrë të qëllimshme kryejnë deklaratime të pavërteta, sepse besohet që, nëpërmjet tyre, subjektet të fshehin pasurinë. Pra, thelbi i këtij elementi është "të fshehurit e pasurisë", që nxjerr qartazi dashjen për të bërë një veprim të tillë. Prej këtej është e kuptueshme që kur nuk ke çfarë pasurie të fshehësh, atëherë nuk ka dashje për të deklaruar në mënyrë të pasaktë, sepse nuk do të kishte sens për ta kryer një veprim të tillë.

**53.2.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga ai nuk është depozituar asnjë provë për të provuar përpjekjet e tij për të siguruar dokumentacionin e kërkuar. Për më tepër, subjekti, në shumicën e rasteve ka refuzuar të japë përgjigje për veprime të kryera prej tij, siç janë renditur në pikën 53. të këtij vendimi. Moskthimi i përgjigjes nga subjekti është bërë pengesë për Komisionin për të kryer një llogaritje të saktë të analizës financiare të subjektit për periudhën 1992-2003.

**53.3.** Subjekti, dhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me truallin prej 314 m<sup>2</sup>. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e subjektit deklaroi që, për të kaluar pronësinë e truallit në qytetin e Sarandës, ishte e nevojshme kryerja e një ndërtimi, duke u ngritur dyshime që subjekti dhe në këtë truall kishte bërë ndërtim. Pyetjes së Komisionit nëse

dhe në këtë truall kishte ndërtim, bazuar në arsyetimin e përfaqësues së subjektit, subjekti iu përgjigj që jo, pasi është shitur më përpara si periudhë. Dhe ky deklaram i subjektit në seancë dëgjimore nuk përputhet me dokumentacion e administruar, pasi legjislacioni nuk ka ndryshuar për periudhën 2002-2004, kohë në të cilën janë shitur dy trojet, duke ngritur dyshime të arsyeshme që dhe në truallin me sipërfaqe 314 m<sup>2</sup> mund të ketë pasur ndërtim.

**53.4.** Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti ka tentuar të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit.

**53.5.** Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” dhe “c” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**54.** Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshëm të tyre në deklaratën e pasurisë “Vetting”, në përputhje me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklaram të pasaktë të ardhurave të krijuara, përkatësisht nga ushtrimi i profesionit të noterit dhe nga punësimi pranë shoqërisë “\*\*\*\*”, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016;
- iii. subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- iv. subjekti ka fshehur në deklaratën “Vetting”, por dhe në deklaramet periodike ndërtimin e një objekti me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> në vitin 2003, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016;
- v. Komisioni mban parasysh në vlerësimin e tij qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka tentuar të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij dhe të personit të lidhur, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka cenuar, qoftë edhe vetëm me këtë mënyrë sjelljeje, besimin e publikut te një funksionar i drejtësisë, i cili duhet të karakterizohet nga sjellja e denjë, serioze dhe e sinqertë, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe gjatë zbatimit të detyrimeve të tij përgjatë këtij procesi.

**54.1.** Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

### **B. KONTROLI I FIGURËS**

**55.** Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Lulaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**55.1.** Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin<sup>57</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Lulaj, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**55.2.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

**55.3.** Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**55.4.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

**56.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP;
- ii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- iii) denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

### **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe analiza e Komisionit**

#### **56.1. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore, të dorëzuara nga subjekti, nuk u konstatuan problematika.

#### **56.2. Analiza e pesë dosjeve penale, të përzgjedhura me short**

Në vlerësim të këtyre dosjeve penale, Komisioni ka konstatuar problematika vetëm në lidhje me një të njërin prej tyre.

**56.2.1.** Procedimi penal nr. \*\*\*, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, datë regjistrimi 15.6.2016, regjistruar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor: “Vendim për pushimin e procedimit penal”, datë 22.7.2016.

Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e akteve të referuara nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë nr. \*\*\*, Tiranë. Ka rezultuar se në datën 14.6.2016, rreth orës 15:55, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, shërbimet e patrullës së policisë kanë ndaluar dhe kanë ushtruar kontroll shtetasve B.K. dhe G. P. Këta shtetas, në momentin që kanë parë punonjësit e policisë, kanë hedhur në tokë një send të dyshimtë, që rezultoi të ishte masë bimore, e ngjashme në karakteristika me *cannabis sativa*. Pas sekuestrimit të lëndës së dyshuar, ka rezultuar se pesha e saj ishte 1.52 gram. Shtetasit e arrestuar kanë dhënë shpjegime, duke pretenduar se ishin përdorues të lëndës narkotike *cannabis sativa*. Ekspertët mjekoligjorë kanë konkluduar në

<sup>57</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë 26.5.2021.

aktet nr. \*\*\*, datë 18.7.2016 dhe nr. \*\*\*, datë 18.7.2016, se në mostrat e urinës së shtetasit B. K. nuk u gjetën prani të produkteve kanabinoidike, ndërkohë që u gjetën gjurmë të tilla në mostrën e urinës së shtetasit G.P.

**56.2.2.** Subjekti, mbi bazën e provave të administruara në fashikullin e hetimit ka konkluduar se shtetasi G. P. rezultonte të ishte përdorues i lëndës narkotike *cannabis sativa*, konfirmuar nga akti i ekspertimit toksikologjik. Në interpretim të përcaktimeve të nenit 283/1 të Kodit Penal, subjekti ka argumentuar që ligjvënësi ka përjashtuar nga përgjegjësia penale personat që mbajnë doza të vogla dhe për përdorim vetjak. Në rastin konkret, sasia e lëndës së sekuestruar ka rezultuar të jetë në masë të vogël, konkretisht 1.52 gram dhe poseduesi, njëri prej personave të arrestuar, shtetasi G.P., ishte përdorues i lëndës narkotike. Duke konkluduar që në rastin konkret ishin plotësuar të dy kriteret e përjashtimit nga përgjegjësia penale, prokurori ka vendosur që hetimet e procedimit penal duhej të pushoheshin, duke iu referuar nenit 328/1, germa “b” dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga aktet e fashikullit nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë ushtruar ankim.

Dokumenti ligjor, “Vendim pushimi”, është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese dhe pjesa konkluduese.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, konstatohet se janë respektuar përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit, akti është i strukturuar në paragrafë të ndarë, arsyetimi është i qartë dhe ligjor, duke u mbështetur në normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

**56.2.3.** Komisioni pasi analizoi fashikullin penal konstaton se:

- a. Në të mungojnë:
  - i. kërkesat për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimit të masës së sigurimit detyrim paraqitje për personat nën hetim;
  - ii. vendimi i plotë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me kërkesat e mësipërme;
  - iii. procesverbalet e pyetjes për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet të shtetasve G. P. dhe B. K., ku sipas subjektit të rivlerësimit ato kanë deklaruar se janë përdorues të lëndëve narkotike;
  - iv. Relacioni i OPGJ-së për përfundimin e hetimeve.
- b. Nga analizimi i kërkesës së shkurtuar për caktimin e masës së sigurimit është e paqartë se cilat kanë qenë arsyet që subjekti ka kërkuar masën e sigurimit “detyrim paraqitje”, duke marrë në konsideratë faktin që subjekti ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të shtetasve B. K. dhe G. P., për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal.
- c. Bazuar në raportin e shërbimit të datës 14.6.2015 rezulton se nga forcat “Shqiponja” janë konstatuar tre persona ku njëri prej tyre është larguar me vrap. Në lidhje me këtë fakt rezulton që nga subjekti nuk është ndërmarrë asnjë veprim hetimor për të gjetur se kush ishte personi i tretë.
- d. Bazuar në procesverbalin e datës 14.6.2016 për mbikëqyrjen dhe marrjen e provave materiale, të dy këto shtetas kanë mohuar që kartmonedha 1,000 lekëshe dhe masa bimore të kenë qenë të tyre.  
Është e paqartë se pse subjekti ka disponuar me kthimin e kartmonedhës të sekuestruarit, ndërkohë që asnjë prej personave në hetim nuk ka pranuar pronësinë mbi këtë kartmonedhë.
- e. Nga analizimi i aktit “Vendim Pushimi” të subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të jetë argumentuar se pse duhej të pushoheshin hetimet për z. B. K., i cili ka rezultuar të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike.

**56.2.4.** Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kërkuan shpjegime. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi se është i vërtetë fakti që në fashikullin hetimor mungon kërkesa e prokurorit për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës konkrete të sigurimit për personat nën hetim, por nga ana tjetër, në faqet \*\*\*dhe \*\*\* të fashikullit ndodhen të administruara shkresat përcjellëse të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor



Tiranë të firmosura nga titullari, çka tregon qartë për ekzistencën e këtyre kërkesave. Po ashtu, vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me kërkesat e mësipërme janë të administruara, pavarësisht se këto paraqiten në formën e shkurtimit të vendimit. Këto vendime nuk janë ankimuar e për shkak të zgjidhjes së shpejtë në kohë që subjekti i rivlerësimit i ka bërë çështjes konkrete, nuk janë administruar vendimet përkatëse gjyqësore të arsyetuara. Referuar procesverbalit të pyetjes për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet të shtetasit B. K., fq. \*\*\* e fashikullit, konstatohet lehtësisht se ai ka deklaruar se është përdorues i lëndës narkotike *cannabis sativa*, nuk është shpërndarës i tyre. Ndërsa relacioni i OPGJ-së për përfundimin e hetimeve mungon për faktin e thjeshtë se ky procedim penal nuk është deleguar për veprime hetimore, por janë administruar aktet e ekspertimit dhe mbi bazën e të dhënave shkencore është konkluduar.

Subjekti sqaron se po, është i vërtetë fakti që nga procesverbalet e kapjes në flagrancë flitet për një person të tretë që largohet me vrap, por lënda narkotike dhe kartëmonedha që u sekuestruan, rezultojnë të jenë hedhur nga njëri prej dy të arrestuarve, ndaj nuk paraqiste ndonjë interes për hetimin identifikimi i këtij personi, nisur edhe nga sasia e pakët e lëndës narkotike që ishte e pandarë në doza, pra, për përdorim vetjak. Nga procesverbalet e kapjes në flagrancë ka të dhëna për të konkluduar se lënda narkotike dhe kartëmonedha që u sekuestruan, rezultojnë të jenë hedhur nga njëri prej dy të arrestuarve. Po ashtu, nga fq. \*\*\* e fashikullit konstatohet lehtësisht se B.K.ka nënshkruar si person, të cilit i janë sekuestruar sasia e lëndës narkotike dhe kartëmonedha e prerjes 1000 lekë. Ndaj, ligjërisht në përfundim të hetimeve duhet të disponohet në këtë mënyrë. Pushimi i çështjes është vendosur pas shqyrtimit në tërësi të rrethanave të ngjarjes dhe provave të grumbulluara dhe duke ndjekur një vijë logjike arsyetimi. Në rastin konkret, pavarësisht faktit që B. K. nuk ka rezultuar përdorues në ditën e ngjarjes, provohet shkencërisht se përdorues ka rezultuar G. P. Ndaj, pushimi i çështjes është lidhur edhe me dozën e vogël e të pandarë që u sekuestrua, e cila nuk mund të ishte veçse për përdorim vetjak. Lidhur me konstatimin e Komisionit se procesverbalet e pyetjes për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, të shtetasve G. P. dhe B. K. mungojnë, subjekti shpjegon se në dosjen penale, faqja \*\*\*, ndodhet procesverbali i pyetjes i shtetasit B. K., i cili nuk ka dhënë shpjegime, por shprehet se ‘jam përdorues i lëndëve narkotike’. Ndërsa në faqen \*\*\* të kësaj dosje, është pyetur shtetasi G. P., ku në fund të përgjigjes së tij shprehet se do të japë shpjegime në një fazë të mëvonshme, në prani të avokatit të kërkuar prej tij.

**56.2.5.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse për sa i përket:

- a. mungesës së dokumentacionit të konstatuar, i cili duhej të ishte pjesë e fashikullit penal. Në këtë rast, fashikulli penal nuk është i plotë, për rrjedhojë subjekti nuk ka treguar aftësi për të administruar dosjen, sipas parashikimeve të nenit 74/5 të ligjit nr. 96/2016.
- b. mungesës së kryerjes së veprimeve hetimore në lidhje me personin e tretë, që është larguar me vrap. Subjekti duhej të kryente veprime hetimore në lidhje me këtë person, duke pyetur personat nën hetim, si dhe duke kryer veprime të tjera hetimore për gjetjen e identitetit të tij dhe marrjen në pyetje, për shkak të nevojave të hetimit që po kryente.
- c. argumentimit të vendimit në lidhje me pushimin e procedimit për shtetasin B. K.

**56.2.6.** Subjekti pretendon se Komisioni është futur në themelin e çështjes, duke i kërkuar shpjegime në lidhje me mungesën e argumentimit. Ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi Komisioni nuk ka vlerësuar vendimmarrjen e subjektit, por është shprehur për formulimin e vendimit. Në nenin 73/3 të ligjit nr. 96/2016, aspekti i arsyetimit ligjor përfshin dhe cilësinë e analizës dhe argumentimit të prokurorit. Në këtë rast, subjekti, në vendimin e pushimit, nuk argumenton se cilat kanë qenë arsyet që pushoi hetimin për z. B. K. Ai në këtë vendim shprehet vetëm për z. G. P., duke mos analizuar dhe argumentuar pushimin për z. K., ku sipas vetë përmbajtjes së vendimit të pushimit, subjekti ka deklaruar se ky shtetas nuk është përdorues i lëndëve narkotike. Kjo mungesë argumentimi klasifikohet si mangësi sipas nenit 73/3 të ligjit nr. 96/2016.

**56.2.7.** Në lidhje me këtë procedim rezulton se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në lidhje me shtetasin B. K., si dhe me personin e tretë, duke treguar mungesë të aftësive për njohuri ligjore, pasi nuk ka mbledhur të gjitha provat, duke u klasifikuar si mangësi, sipas nenit 73/2 të ligjit nr. 96/2016.

**56.2.8.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se në lidhje në këtë procedim penal konstatohen mangësi sipas nenit 73/2-3 dhe nenit 74/5 të ligjit nr. 96/2016. Këto mangësi duhet të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

## **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE**

### **I. TË DHËNAT ARKIVORE (Ankesat dhe masat disiplinore- vlerësimet)**

**57.** Nga verifikimi në arkivin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit, nuk janë marrë masa disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës.

**57.1.** Mbi bazën e kërkesës për informacion, dërguar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i është kërkuar informacion strukturave përkatëse të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha Prokurorive pranë Shkallës së Parë dhe janë administruar përgjigjet e shkresave ku ka rezultuar të jenë regjistruar 2 (dy) kallëzime penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për të cilat, në të dy rastet, është vendosur mosfillimi i procedimit.

## **DENONCIMET**

**58.** Komisioni ka administruar 11 denoncime nga publiku për subjektin Artan Lulaj. Subjektit iu kalua barra e provës për disa prej tyre si më poshtë:

### **Denoncim i shtetasit H. Sh.** <sup>58</sup>

**58.1.** Shtetasi, në ankimin e tij, pretendon se ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. \*\*\*. Subjekti i rivlerësimit, me shkresën nr. \*\*\*, datë 10.12.2020, e ka njoftuar për përfundimin e hetimeve paraprake, duke i dhënë të drejtën ligjore për tërheqjen e kopjeve të akteve të fashikullit, si dhe të paraqitjes së memorieve apo provave të reja brenda afatit 10-ditor. Në datën 15.12.2020 është paraqitur në Prokurori për të depozituar kërkesën për marrjen e një kopjeje të fashikullit të hetimit, por nuk i kanë dhënë mundësinë e dorëzimit të kërkesës në institucion, duke e drejtuar në një kuti teneqeje të vendosur tek dera e Prokurorisë, ku mund të hidhte kërkesën. Ai, në po të njëjtën datë, ka paraqitur kërkesën, duke e depozituar në postë. Kur është paraqitur në sekretarinë e Prokurorisë për tërheqjen e kopjes së fashikullit të hetimit, sekretarja i ka treguar me dorë subjektin e rivlerësimit, të cilit iu ka afruar dhe i ka thënë se nuk e kishte çuar në sekretari fashikullin e hetimit. Subjekti i është përgjigjur se e ka pushuar çështjen dhe nuk ka asgjë për t'i komunikuar, duke i thënë shko tek sekretaria për t'u sqaruar.

Ai është kthyer tek sekretaria, e cila e ka njoftuar se nuk ka dosje apo fashikull të dorëzuar. Ajo e ka marrë disa herë në telefon subjektin, por nuk i është përgjigjur.

Denoncuesi ka bashkëlidhur dokumentin “Njoftim për përfundimin e hetimeve”, të hartuar nga subjekti i rivlerësimit. Nga analizimi i këtij dokumenti rezulton se ai nuk ka të gjithë elementet e parashikuara nga neni 327/3 i K.Pr.Penale<sup>59</sup>, pasi mungon cilësimi juridik, si dhe subjekti shprehet se i komunikon të pandehurit të drejtat si më poshtë, ndërkohë që, sipas pretendimit të denoncuesit, ai e ka pushuar çështjen.

<sup>58</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2021.

<sup>59</sup> Njoftimi përmban përshkrimin e përmbledhur të faktit penal për të cilin procedohet, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje.

**58.1.1.** Në lidhje me këtë denoncim, subjekti parashtrori se ankesa e shtetasit H. Sh. është trajtuar edhe nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2021 ka vendosur arkivimin e ankesës së tij. Për të mos rënë në përsëritje me sa citohet në këtë vendim, rezulton se prokurori Artan Lulaj ka njoftuar ankuesin sipas shkresës nr. \*\* prot./A.L. datë 10.12.2020 për përfundimin e hetimeve, si dhe të drejtën e tij për t'u njohur me aktet e për të marrë kopje të tyre, jo me të drejtën për t'u paraqitur brenda 10 ditëve, siç e interpreton ankuesi. Pra, konstatohet mungesa e qëllimit të subjektit, si prokuror, për të penguar ankuesin të paraqesë memo, kërkesa për kryerje veprimesh, marrje provash etj., në respektim të aftit 10-ditor nga momenti i marrjes dijeni për përfundimin e hetimeve.

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit fashikullin penal si dhe vendimin nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka vendosur arkivimin e ankesës së shtetasit H. Sh.

**58.1.2.** Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar dhe shpjegimet e subjektit rezulton se subjekti ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal.

### **Denoncimi i shtetasës L. S.<sup>60</sup>**

**58.2.** Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim të padrejtë për mosfillimin e procedimit ndaj një shtetasi, ndërkohë që ky e ka kërcënuar për jetën. Ajo pretendon se ky shtetas vijon ta kërcënojë.

**58.2.1.** Në lidhje me këtë denoncim, subjekti parashtrori se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është tërësisht i bazuar në ligj dhe prova. Vetë kallëzuesja ka pranuar gjatë ripyetjes se nuk ka pasur asnjë përballje fizike me të kallëzuarin B.LI., kanë biseduar për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes tyre, por asnjëherë nuk ka pasur kontakt fizik me të. Pra, nga shqyrtimi në tërësi i akteve dhe provave të administruara, nuk ka rezultuar të ndodhemi para elementeve të veprës penale të “Kanosjes”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Lidhur me këtë vepër penale kërkohet që nga ana objektive të plotësohen disa kushte: kanosja të jetë serioze, d.m.th. për nga forma dhe nga përmbajtja të mos lënë asnjë dyshim tek i dëmtuari se vepra për të cilën ai po kanoset, do të realizohet patjetër, si dhe kanosja duhet të bëhet për vrasje ose për plagosje të rëndë dhe jo për çdo vepër tjetër penale. Por, duke u nisur nga deklaratimet dhe provat e tjera të administruara në këtë material kallëzues, nuk krijohet bindja që kanosja të ketë qenë serioze. Gjithashtu nuk rezulton që nga veprimet konkrete të ndërmarra në dëm të njëri-tjetrit, mekanizmi i ngjarjes etj., të krijohet përshtypja se ishin ndërmarrë veprime konkrete në dëm të jetës apo dëmtimit të rëndë të shëndetit, por debati i pretenduar ka mbetur në kuadrin e një telefonate.

**58.2.2.** Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë denoncim janë bindëse.

### **Në lidhje me denoncimet<sup>61</sup> e shtetasve P. M. dhe F. M.**

**58.3.** Shtetasit e mësipërm janë prindër të të ndjerit M. M., i cili është vrarë në datën 31.7.2017, pas një konflikti fizik. Denoncuesit pretendojnë se nga subjekti është abuzuar nëpërmjet pushtetit që i jep ligji, në këmbim të shumave në para, duke liruar tre nga kriminelët vrasës të birit të tyre, të të ndjerit M. M. Ata kanë listuar një sërë shkeljesh të pretenduara të kryera nga subjekti, duke depozituar edhe disa prova.

**58.3.1.** Komisioni, pasi analizoi këtë denoncim, administroi fashikujt penalë të procedimit nr. \*\*\*, me të pandehur: D. B., E.B., K. A. dhe M. A., akuzuar për konsumimin e veprës penale “Vrasje me paramendim, e kryer në bashkëpunim”, neni 78/1-25 i K.Penal.

**58.3.2.** Nga analizimi i fashikujve penalë rezulton se:

i) Në datën 1.8.2017, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Vrasjes me dashje” dhe “Prodhim, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”,

<sup>60</sup> Nr. \*\*\*, datë 17.9.2018.

<sup>61</sup> Denoncimet nr. \*\*\*, datë 17. 5.2019; nr. \*\*\*, datë 25.5.2018; nr. \*\*\*, datë 12.6.2018.

parashikuar nga nenet 76-25 e 279 të Kodit Penal. Subjekti, në datën 2.8.2017, ka kërkuar vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest me burg” për shtetasit M. dhe K. A., E. dhe D. B. akuzuar për veprën penale: “Vrasje dhe prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve”, të parashikuar nga neni 76-25, 278 i Kodit Penal. Kjo kërkesë rezultoi të jetë pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë dhe është lënë në fuqi dhe nga gjykatat më të larta.

ii) Nga subjekti janë kryer një sërë veprimesh hetimore nga data 1.8.2017 deri më 1.4.2018.

iii) Subjekti, në lidhje me këtë procedim, ka zgatur dy herë afatin e hetimeve, përkatësisht në datat:

- 1.11.2017, duke i shtyrë deri më 1.2.2018.
- 1.2.2018 deri më 1.5.2018.

Nga verifikimi i veprimeve hetimore rezultoi se subjekti ka vepruar drejt, duke vendosur zgjatjen e hetimeve, pasi gjatë kësaj periudhe janë administruar prova të ndryshme në lidhje me procedimin.

iv) Në datën 3.8.2017, bazuar në procesverbalin për sekuestrimin e sendeve rezultoi se nga kqyrja e automjeti tip “\*\*\*\*”, me targa \*\*\*, në përdorim të shtetasit E.B., në bagazhin e këtij automjeti janë gjetur një teh thike me mbishkrimin \*\*\*, *USA Balistic* dhe një pajisje metalike që përdoret për grirësen e duhanit (hashashit), ndërsa në sediljen e parë të pasagjerit, poshtë kësaj, në krahun e djathtë, u gjet një thikë biçak me hapje anësore, ku ka të stampuar formën e një ylli. Këto sende janë sekuestruar.

Në po të njëjtën datë është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik “thikë”, nëse tehu i thikës dhe biçaku i sekuestruar përmbushnin kushtet ligjore të armëve të ftohta. Por, pavarësisht këtij vendimi, nga verifikimi i fashikujve penalë, si edhe aktit “Njoftim për përfundimin e hetimeve”, rezultoi se nga subjekti nuk është analizuar sekuestrimi i sendeve të mësipërme.

Nga studimi i fashikullit rezultoi gjithashtu se gjatë pyetjes së shtetasit E. B., subjekti nuk është përqendruar në marrjen e informacioneve/të dhënave që do të çonin në zbardhjen e së vërtetës. Subjekti nuk e ka pyetur shtetasin E. B. se përse gjendeshin sendet e sekuestruara në automjetin e tij dhe për çfarë i përdorte, apo nëse ai ishte përdorues i lëndëve narkotike, për sa kohë i ishte sekuestruar një pajisje metalike që përdoret për grirjen e duhanit (hashashit), si dhe nga akti i ekspertimit nr. \*\*\*, datë 22.9.2017, rezultoi se mbetjet në mekanizmin grirës, objekt ekspertimi, janë *cannabis*, produkt herbal, bimë *cannabis sativa L.*

Subjekti, në lidhje me këto konstatime, ka sqaruar se: (i) vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik, nëse tehu i thikës dhe biçaku i sekuestruar përmbushnin kushtet ligjore të armëve të ftohta, ka qenë një ndër veprimet e para hetimore të kryera nga policia gjyqësore menjëherë pas ngjarjes. Ndryshe nga sa konstaton Komisioni, nga ana e tij është administruar akti i ekspertimit teknik të objekteve të gjetura në makinën e shtetasit E. B., akt i cili mban nr. \*\*\*, datë 5.8.2017; (ii) ka sqaruar se ky shtetas nuk është marrë në pyetje prej tij, por është pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore, i ngarkuar me kryerjen e veprimeve hetimore për këtë procedim penal, pyetje e cila është bërë mbi bazën e kërkesës së mbrojtësit të personit nën hetim. Në këto kushte, pyetja e këtij personi disa muaj pas ngjarjes, është parë e lidhur edhe me provat e tjera tashmë të administruara, pra vendimmarrja e tij si prokuror i çështjes nuk është bazuar thjesht e vetëm tek thëniet e E.B.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Drejtimi i hetimeve është detyrë e prokurorit, i cili mund ose jo t’ia delegojë oficerit të policisë gjyqësore. Në rastin konkret, nga subjekti nuk është bërë asnjë veprim për të kryer hetime të plota në lidhje me veprimet e këtij shtetasi, ndaj të cilit kishte nisur një procedim me dyshim që ai ishte autor i veprës penale të vrasjes në bashkëpunim. Në rastin konkret, nga fashikulli penal nuk rezultoi që subjekti të ketë pyetur shtetasin E. B. se përse gjendeshin sendet e sekuestruara në automjetin e tij dhe për çfarë i përdorte, apo nëse ai ishte përdorues i lëndëve narkotike, për sa

kohë i ishte sekuestruar një pajisje metalike që përdoret për grirjen e duhanit (hashashit), si dhe nga akti i ekspertimit nr. \*\*\*, datë 22.9.2017, rezultoi se mbetjet në mekanizmin grirës objekt ekspertimi janë *cannabis*, produkt herbal, bimë *cannabis sativa L.* Për sa më sipër, subjekti ka treguar mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore, duke u klasifikuar si mangësi sipas nenit 73/2 të ligjit nr. 96/2016.

v) Në datën 4.4.2018, subjekti ka njoftuar përfundimin e hetimeve.

Ky dokument u është njoftuar trashëgimtarëve të të ndjerit M. M. në datën 7.4.2018 me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 5.4.2018. Nga ana e trashëgimtarëve të të ndjerit M. M., brenda afati 10-ditor të parashikuar nga nenin 327 i K.Pr.Penale, është paraqitur një kërkesë<sup>62</sup> e regjistruar në organin e prokurorisë më 16.4.2018 me nr. \*\*\* prot. Në datën 17.4.2018 organi i prokurorisë ka njoftuar trashëgimtarët e të ndjerit se materialet e çështjes penale nr. \*\*\* i janë dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

vi) Në datën 10.4.2018 subjekti ka marrë vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin D. B., i cili akuzohet se ka kryer veprën penale “Vrasje me paramendim të shtetasit M. M.”, parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal.

Në këtë vendim, subjekti relatton si vijon “... Në lidhje me këtë ngjarje është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet shtetasi **D. B.**, i cili ka deklaruar se...Në momentin e parë, sapo ai djali që e thërrisnin B e ka parë, i ka thënë ti je ai dhe i kanë gjuajtur me grushta në fytyrë. Mbas tij, sipas shtetasit D., i janë hedhur në qafë edhe pesë shokët e vet, duke e qëlluar me sende të forta. Ky shtetas shpjegon se për momentin është hutuar, pasi i dhimbe dhe koka. Më pas sapo situata është qetësuar është ngjitur në shtëpi. **Ai deklaroi se nuk ka gjuajtur asnjë person me grusht apo me ndonjë send tjetër ...**

Në datën 31.10.2017 është ripyetur shtetasi D. B., si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet, ku ndër të tjera ka shpjeguar se: “Në këtë moment ka ardhur E. dhe është futur në mes për t’i ndarë. Ato ishin shumë persona dhe mes nesh ndodhi shkëmbim goditjesh me grushta, ndërsa ato kishin doreza metalike. Duke parë veten në rrezik, pasi ato ishin gjashtë persona, unë kam nxjerrë **një thikë** nga xhepi dhe e kam lëvizur me qëllim për të trembur personat që të largoheshin. Në këtë grindje e sipër është plagosur njëri prej tyre, i cili ngeli i shtrirë në tokë...Pas ngjarjes ka shkuar në Lanë dhe në distancë ka hedhur diku thikën në ujë.”

...në lidhje me ndryshimin e deklaramit, D.B. ka deklaruar se kishte qënë i frikësuar gjithashtu dhe nga presioni policor, pati frikë të thotë të vërtetën...

Në lidhje me këtë ngjarje është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet shtetasi **E. B.**, i cili ndër të tjera shpjegon: “...në momentin që ndodhi konflikti ndërmjet djalit të xhaxhait të tij D. dhe disa personave të panjohur nga ana ime, unë ndodhesha afër tyre. Në momentin që pashë se D. po e godisnin disa persona, unë u futa për t’i ndarë dhe më goditën në pjesën e kokës. Shtyva njërin nga personat që më goditi dhe nuk mbaj mend se si ka vazhduar rrjedhja e ngjarjes. Me vete kisha **një thikë, tip flutur**, e cila ka qenë ngjyrë gri me të zezë, këtë thikë unë e kisha rastësisht me vete, **pasi nuk mbaj thikë me vete**. Në momentin që mora disa goditje, unë vura re se njëri nga personat me të cilin po përlesheshim dhe të cilin nuk mund ta identifikoj, pasi nuk e kam fiksuar, ka nxjerrë një thikë, tip flutur, atëherë edhe unë nxora thikën dhe godita vetëm njëherë në drejtim të personave që po më godisnin me qëllim që t’i trembja. Pasi gjuajta unë me thikë, personat vazhdonin të më qëllonin dhe pas pak, kohën nuk mund ta përcaktoj, personat që po më sulmonin edhe mua edhe D. u larguan...” Ky shtetas vijon të deklarojë se u largua vetë dhe hodhi thikën nga ura e Lanës që ndodhet para gjykatës në drejtim të pallatit me shigjeta dhe nuk e ka të qartë nëse ka rënë në ujë apo në beton.

Ndërkohë, në datën 31.10.2017, pasi është ripyetur ky shtetas ka deklaruar si më poshtë:

“...Është afruar për t’i ndarë duke u futur në mes të D. dhe personit që e qëlloi dhe në këtë kohë është sulmuar nga disa persona të tjerë të cilët e godisnin nga shpina dhe në kokë me

<sup>62</sup> Me emërtim “memorie” dhe kërkesë me shkrim për modifikimin e cilësimit juridik.

grushta. Pas pak erdhën dhe dy persona të tjerë të cilët u përleshën me D. dhe po e godisnin atë me grushta dhe me doreza metalike. Ai shpjegon se personalisht ishte përleshur me dy persona dhe në mbrojtje e sipër i kishte goditur dhe ai me grushta. Pas pak ka parë një person, i cili ishte shtrirë në tokë dhe të gjithë personat e tjerë ikën me vrap. Më pas shpjegon se ishte larguar dhe ai me vrap.”

Në lidhje me deklarinimin se kishte pasur thikë, ai shpjegon se nuk ka pasur thikë dhe se deklarinimet nuk i kishte lexuar dhe ka qenë në presion psikologjik...

vii) Në datën 10.4.2018<sup>63</sup> subjekti ka marrë vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin E.B., i cili akuzohet se ka kryer veprën penale “Moskallëzim të krimit”, parashikuar nga neni 300 i K. Penal.

Subjekti relaton si vijon “...Në lidhje me këtë ngjarje është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet shtetasi E.B., i cili ndër të tjera shpjegon: në momentin që ndodhi konflikti ndërmjet djalit të xhaxhait të tij D. dhe disa personave të panjohur nga ana ime, unë ndodhesha afër tyre. Në momentin që pashë se D. po e godisnin disa persona, unë u futa për t’i ndarë dhe më goditën në pjesën e kokës....Pra ky i pandehur ka marrë pjesë në sherr dhe është larguar menjëherë pasi i ndjeri M. M. është goditur me thikë. Pas largimit nga vendi i ngjarjes megjithëse kishte detyrimin ligjor të kallëzonte për krimin në polici, nuk e ka bërë një gjë të tillë...Më datë 22.09.2017 është administruar akti nr. \*\*\* me konkluzion: “Mbetjet në mekanizmin grirës objekt ekspertimi janë cannabis produkt herbal bime cannabis sativa L.”

#### **Nga studimi i aktit rezulton se subjekti nuk pasqyron:**

- i. deklarinimet fillestare të shtetasit E.B., i cili kishte deklaruar:

*“Me vete kisha një thikë tip flutur, e cila ka qenë ngjyrë gri me të zezë, këtë thikë unë e kisha rastësisht me vete, pasi nuk mbaj thikë me vete. Në momentin që mora disa goditje unë vura re se njëri nga personat me të cilin po perlesheshim dhe të cilin nuk mund ta identifikoj pasi nuk e kam fiksuar ka nxjerrë një thikë tip flutur, atëherë edhe unë nxora thikën dhe godita vetëm njëherë në drejtim të personave që po më godisnin me qëllim që t’i trembja.”*

- ii. deklarinimin e datës 31.10.2017 të shtetasit E.B., ku ai ka mohuar të ketë pasur thikë dhe se deklarinimet nuk i kishte lexuar dhe ka qenë në presion psikologjik.
- iii. faktin se në automjetin e shtetasit E.B., ishin sekuestruar një teh thike me mbishkrimin \*\*\*, USA Balistic dhe një pajisje metalike që përdoret për grirësen e duhanit (hashashit), ndërsa në sediljen e para të pasagjerit, poshtë kësaj, në krahun e djathtë, u gjet një thikë biçak me hapje anësore, ku ka të stampuar formën e një ylli.

Për sa më sipër, Komisioni ka konkluduar se duket sikur subjekti nuk ka pasqyruar saktësisht të dhënat e administruara nga fashikulli hetimor në vendimin për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin E. B., duke iu kaluar barra e provës.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se thëniet e personit nën hetim janë parë me rezervë nga ana e tij, pasi nuk përputheshin me gjithë provat e tjera të administruara në fashikull. Personi nën hetim ka të drejtë të deklarojë çfarëdo lloj pretendimi gjatë procesit penal dhe nuk mban përgjegjësi për deklarinim të rremë apo dëshmi të rreme. Subjekti ka theksuar se vendimarrja e tij për të ngritur akuzat konkrete ndaj secilit prej të pandehurve është marrë në përputhje me të gjitha provat dhe sipas bindjes time të brendshme si prokuror i ngarkuar me hetimin e kësaj ngjarje. Ai ka kërkuar të mos konfondohej pasqyrimi i tyre saktësisht, me vlerën provuese të këtyre thënieve të personit nën hetim.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Subjekti, në vendimin për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin D. B., i ka pasqyruar këto deklarinime, ndërkohë në rastin e z. E. B. nuk rezultojnë të pasqyruara. Pasqyrimi i tyre ishte i nevojshëm për të njohur gjykatën me të gjitha aktet dhe provat, si dhe për të krijuar një

<sup>63</sup> Fq.\*\*\*, fashikulli \*\*.

panoramë të qartë të të gjithë dinamikës së ngjarjes dhe të veprimeve të këtij shtetasi. Për sa më sipër, subjekti nuk ka pasqyruar saktësisht të dhënat e administruara nga fashikulli hetimor në vendimin për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin E. B., duke u klasifikuar kjo si mangësi sipas nenit 73/3 të ligjit nr. 96/2016.

**viii)** Në datën 6.4.2018 subjekti ka marrë vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin M.A., i cili akuzohet se ka kryer veprën penale “Moskallëzim të krimit” parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Subjekti në këtë akt relaton: *“...Nga kqyrja e pamjeve filmike të lokalit \*\*\* dhe thirrjeve telefonike rezulton se të dy padehurit K. dhe M. A. kanë qenë në vendin e ngjarjes për një periudhë kohe prej minutash dhe për më tepër kanë marrë pjesë në përleshje duke e goditur me personat që kishin ardhur për A...Pra ky i pandehur ka marrë pjesë në sherr dhe është larguar menjëherë pasi i ndjeri M. M. është goditur me thikë. Pas largimit nga vendi i ngjarjes megjithse kishte detyrimin ligjor të kallëzonte për krimin në polici nuk e ka bërë një gjë të tillë.”*

**ix)** Në datën 6.4.2018 subjekti ka marrë vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin K. A., i cili akuzohet se ka kryer veprën penale “Moskallëzim të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Subjekti, në këtë akt, relaton: *“Nga kqyrja e pamjeve filmike të lokalit \*\*\* dhe thirrjeve telefonike rezulton se të dy padehurit K. dhe M. A. kanë qenë në vendin e ngjarjes për një periudhë kohe prej minutash dhe për më tepër kanë marrë pjesë në përleshje duke e goditur me personat që kishin ardhur për A....Pra ky i pandehur ka marrë pjesë në sherr dhe është larguar menjëherë pasi i ndjeri M. M. është goditur me thikë. Pas largimit nga vendi i ngjarjes megjithse kishte detyrimin ligjor të kallëzonte për krimin në polici nuk e ka bërë një gjë të tillë.”*

**x)** Në datën “s’ka”, subjekti ka dërguar çështjen në gjyq në ngarkim të pandehurve D.B., E.B., K. dhe M. A., sipas akuza të trajtuara më lart.

**xi)** Pas ndryshimit të kualifikimit ligjor të veprës penale nga ana e të pandehurve E. B., K. dhe M.A. është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit nga “arrest në burg” me “detyrim paraqitje”. Këto kërkesa janë miratuar nga gjykata përkatësisht për E.B. në datën 16.4.2018, K. A. më 20.4.2018, M. A. më 23.4.2018.

Subjekti në seancat gjyqësore të caktimit të masës së sigurimit është shprehur dakord me kërkesën për zëvendësimin e masës, duke u shprehur se kishin ndryshuar nevojat e sigurimit.

Subjekti, në datën 23.4.2018 ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 23.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zëvendësimin e masës së sigurimit për të pandehurin M. A.

**xi)** Bazuar në procesverbalin për këqyrjen e dokumenteve të datës 10.5.2018 konstatohet se shtetasi E. B është regjistruar në regjistrin e vizitorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në datën 23.04.2018. Ai është pajisur me leje hyrje nr.\*\*\* personi pritës ka qenë subjekti i rivlerësimit, arsyeja e takimit ka qenë detyrim paraqitje dhe ora e hyrjes 14:42.

Për Komisionin ishte e paqartë paraqitja e shtetasit E. B., në datën 23.4.2018, duke marrë në konsideratë faktin se në vendimin e ndryshimit të masës së sigurimit, ai duhej të paraqitej një herë në dy javë. Subjekti, në lidhje me këtë paqartësi, shpjegoi se në praktikën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çdo person nën hetim, ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit detyrim paraqitje, mund të paraqitet në Prokurori për të zbatuar këtë detyrim ligjor, sipas modaliteteve të vendimit gjyqësor, duke lënë shënimet përkatëse në regjistrin e vizitorëve. Në rastin konkret, nga një verifikim i thjeshtë në kalendar, rezulton se datat 16.4.2018 dhe 23.4.2018 kanë qenë ditë e hënë, pra personi nën hetim E. B. është paraqitur në Prokurori në zbatim të vendimit gjyqësor nr \*\*\* në të cilin është përcaktuar “Detyrimi i të pandehurit të paraqitet pranë Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Tiranë, një herë në dy javë, ditën e hënë ora 15:00”.

Komisioni vlerëson se subjekti ka sqaruar këtë situatë.

**xii)** Në datën 24.4.2018, një ditë pas ndryshimit të masës së sigurimit të shtetasit M. A., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga ky procedimi penal me pretendimin se ishte i paragjykuar nga prindërit e viktimës. Në kërkesë ai referon faktin se kishte një kërkesë të prindërve të viktimës për zëvendësimin e tij më 12.4.2018, protokollur në datë 13.4.2018. Në datën 25.4.2018, Drejtuesi i Prokurorisë ka pranuar kërkesën e subjektit, duke e zëvendësuar me një prokuror tjetër.

Komisioni i kërkoi shpjegime subjekti në lidhje me: (i) është e paqartë se cila ka qënë arsye që subjekti ka vijuar kryerjen e veprimeve procedurale edhe pas datës 13.4.2018, ndërkohë që përdor si shkak për heqjen dorë nga gjykimi kërkesën e prindërve të viktimës të datës 12.4.2018. (ii) është e paqartë se pse subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën më 24.4.2018, menjëherë pas kryerjes së veprimeve procedurale në lidhje me tre të pandehurit, të cilëve u është ndryshuar masa e sigurimit, duke u lënë të lirë me detyrim paraqitje dhe nuk e ka dhënë dorëheqjen që më 13.4.2018, duke marrë në konsideratë dhe faktin se nga prindërit e viktimës ka pasur kontestime për ecurinë e procedimit, provuar kjo me dokumentacionin e depozituar nga ana e tyre në ankesat e depozituar pranë KPK-së.

Subjekti, në lidhje me këto konstatime, shpjegoi se: *“Pas datës 13.4.2018 nuk kam kryer asnjë veprim procedural apo hetimor, përveçse kam përfaqësuar organin e akuzës në gjykim, konkretisht në seancat gjyqësore për zëvendësimin e masës së sigurimit. Këto seanca janë iniciuar nga kërkesat e avokatëve respektive të të pandehurve, në vijim datat e seancave janë caktuar nga gjykata dhe kam qënë në ushtrim të detyrimit ligjor si prokuror të paraqitesha në seancë e të mbaja qëndrim ligjor përse u përket kërkesave të mbrojtësve. Për asnjë moment vendimmarrja ime nuk është ndikuar nga qëndrimi subjektiv i palëve në procesin penal, qofshin këta viktimë apo persona nën hetim. Kërkesa ime për të hequr dorë nga përfaqësimi i mëtejshëm i këtij procedimi penal, është paraqitur në një moment që unë e kam vlerësuar si të përshtatshëm. Gjithsesi kërkesa ime për heqje dorë i jep efektet nga moment i pranimit të saj, pavarësisht se kur unë e çmova të nevojshme ta paraqes tek Drejtuesi.”*

Në seancë dëgjimore subjekti, i pyetur në lidhje me dorëheqjen, sqaroi se pjesëmarrja në gjykim nuk është veprim procedural, veprim hetimor, është detyrim që e ka çdo prokuror. Sipas subjektit, paraqitja në gjyq është veprim procedural normal, se prokurori është pjesë e procesit penal, por jo veprim që ka ndikuar në kryerjen e veprimeve hetimore apo marrjes së provave gjatë kësaj periudhe.

Subjekti ka pretenduar se nuk e konsideron se ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit, duke argumentuar se është shprehur pozitivisht në lidhje me kërkesën e mbrojtjes, pasi u kishte komunikuar akuzën të pandehurve dhe ndërkohë po kalonte dhe afati i masës së paraburgimit.

Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, por dhe në seancë dëgjimore, vlerëson se ato nuk janë bindëse.

Komisioni vlerëson se subjekti ka vepruar në dukje në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti ka kryer veprime procedurale, jo vetëm duke përfaqësuar organin e akuzës në seancat e zëvendësimit të masës së sigurimit, por ai është shprehur dakord për këto zëvendësime, si dhe ka nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e këtyre vendimeve. Vetëm pas kryerjes së këtyre veprimeve subjekti ka paraqitur dorëheqjen. Subjekti nuk kishte asnjë pengesë ligjore që të paraqiste kërkesën për dorëheqje që më 13.4.2018. Komisioni vlerëson se këto veprime të subjektit nuk përputhen me etikën e një prokurori, i cili, nëse në bazë të bindjes së brendshme të tij ndihej i paragjykuar, nuk kishte arsye të vijonte me veprime procedurale, që kanë një rëndësi të veçantë për procesin, pasi të tre shtetasit janë lënë të lirë dhe dy prej tyre më pas janë larguar nga Shqipëria. Për sa më sipër, këto veprime të subjektit do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të këtij procedimi penal.

**xiii)** Në seancën paraprake të datës 22.5.2018, organi i akuzës i përfaqësuar nga një prokuror tjetër, ka kërkuar ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale dhe çështja duhej të trajtohej sipas nenit 78-25 të Kodit Penal.



Kjo kërkesë është miratuar nga gjyqtari i seancës paraprake, i cili me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 28.5.2018, ka vendosur kalimin për gjykim të dosjes penale nr. \*\*\*, kundër të pandehurve E. dhe D. B. dhe M. dhe K.A. për veprën penale të “Vrasjes me paramendim, kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 78/1-25 të Kodit Penal.

Pas vendimit të gjykatës si më lart, në datën 13.6.2018, nga organi i akuzës është kërkuar ndryshimi i masave të sigurimit për tre të pandehurit, duke kërkuar masën e sigurimit “arrest në burg”. Kërkesa është pranuar nga gjykata për të tre të pandehurit, por vendimi është zbatuar vetëm për E. B., pasi shtetasit M. dhe K. A. rezultojnë se nuk janë dorëzuar dhe janë gjykuar në mungesë. Këta dy të pandehur nuk kanë zbatuar vendimin e gjykatës për masën e sigurimit “detyrim paraqitje”, pasi nga data 14.5.2018 nuk janë paraqitur më. Nga të dhënat e sistemit TIMS të administruar në fashikullin penal rezulton se të dy këto shtetas kanë dalë nga Shqipëria më 27.5.2018.

Bazuar në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 28.5.2018 rezulton se të pandehurit K. A. dhe M. A. kanë qenë të përfaqësuar nga av. A. K.. Në këtë procesverbal deklarohet se vëllezërit A., me prokurë të posaçme nr. \*\*\*, datë 5.5.2018 kanë zgjedhur znj. A.K. dhe z. L. S., që të dy së bashku ose veç e veç, të përfaqësojnë interesat e tyre. Ky fakt pasqyrohet dhe në vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake të datës 28.5.2018, ku rezulton se z. M. A. dhe K. A. janë përfaqësuar nga avokatja A. K.<sup>64</sup> me nr. licence \*\*\* dhe NIPT \*\*\*.

Në përfundim të procesit gjyqësor, Prokuroria ka kërkuar: dënimin e të pandehurve D. B., E. B., M.A. dhe K. A. për veprën penale “Vrasje me paramendim e kryer, në bashkëpunim”, neni 78/1-25 i K.Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 11.4.2019, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të katër të pandehurve, duke ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës penale nga “Vrasje me paramendim” në “Vrasje të kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 76-25 i K.Penal”.

### **58.3.3. Komisioni, pas analizimit të fashikujve penalë, si dhe të veprimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se:**

- i. Nga pamjet filmike rezulton se shtetasit E. B., K. dhe M. A. kanë goditur të ndjerin M. M. dhe gjatë kohës që këta shtetas po godisnin të ndjerin, është afruar shtetasi D. B., duke e goditur me thikë. Pas goditjes me thikë, shtetasi D.B. është larguar, ndërkohë shtetasit e tjerë kanë vijuar goditjen e të ndjerit dhe më pas janë larguar. Pra, nga dinamika e ngjarjes rezulton se shtetasit E. B., M. dhe K. A. kanë marrë pjesë aktive në konflikt, ku si pasojë ka ardhur dhe vdekja e të ndjerit M. M. dhe vetëm pas goditjes me thikë të të ndjerit, kanë ndaluar goditjet dhe janë larguar. Ky fakt është konfirmuar dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit në aktet e hartuara prej tij.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti sqaroi se ka vlerësuar ndryshe nga sa Komisioni konstaton. Qëndrimi i tij për këtë çështje dhe provat që kanë çuar në këtë kualifikim ligjor, janë të pasqyruara hollësisht në vendimin për njoftimin e akuzës. Po ashtu, për sa kohë kjo çështje penale rezulton të jetë ende në gjykim, nuk ka një qëndrim final mbi faktin nëse kualifikimi ligjor dhe akuza e ngritur për secilin nga të pandehurit është sipas vlerësimit të tij, apo sipas qëndrimit të gjykatës së rrethit dhe gjykatës së apelit.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se çështja është ende në gjykim në Gjykatën e Lartë, Komisioni vlerëson se ky fakt nuk përbën pengesë për t’i kaluar barrë prove subjektit apo për të analizuar veprimet e tij procedurale. Kjo praktikë tashmë është e konsoliduar, bazuar dhe në vendimin nr. 28, datë 23.10.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit ku është qartësuar se pas dhënies së vendimit nga subjekti i rivlerësimit çështja mund të analizohet nga Komisioni dhe

---

<sup>64</sup> E njëjta avokate, në vitin 2021, ka përfaqësuar tre prej shitësve të apartamentit të blerë nga vajza e subjektit të rivlerësimit, D. H.

nuk konsiderohet si çështje në gjykim, pavarësisht se mund të jetë në shqyrtim në gjykata më të larta.

- ii. Subjekti nuk rezulton të ketë analizuar dinamikën e ngjarjes me qëllim caktimin e përgjegjësisë penale për secilin të pandehur. Ai është referuar vetëm në deklaratimet e shtetasve të përfshirë në konflikt, por pa analizuar provat e tjera, si dhe shkallën e përgjegjësisë të secilit prej të pandehurve. Më konkretisht:
  - a. subjekti nuk ka analizuar veprimet aktive të shtetasve K. A., M. A. dhe E.B., ku del qartë që ato e kanë goditur viktimën, kanë komunikuar paraprakisht me shtetasin D. B., kanë pritur së bashku me të, si dhe janë përfshirë në veprime aktive.
  - b. subjekti nuk ka analizuar nëse veprimet aktive të shtetasve K. A., M. A. dhe E. B., duke goditur të ndjerin dhe ku si pasojë e këtyre goditjeve janë krijuar kushtet që shtetasi D. B. të qëllonte me thikë të ndjerin, përbëjnë vepër penale.
  - c. subjekti nuk ka analizuar veprimet e mësipërme të shtetasve K. A., M. A. dhe E. B., në mënyrë të tillë që të caktohej qartë shkalla e dashjes si dhe qëllimi i tyre për të bashkëpunuar apo jo me shtetasin D. B.
  - d. subjekti nuk rezulton të ketë pyetur shtetasit K. A., dhe M. A. në lidhje me veprimet e tyre aktive të goditjes së të ndjerit, duke marrë në konsideratë faktin se të dy këto shtetas gjatë gjithë hetimit kanë refuzuar përfshirjen e tyre në konflikt.
  - e. subjekti nuk analizon veprime e shtetasit E. B., i cili fillimisht ka deklaruar që e ka patur ai thikën, duke ngritur dyshime që në ngjarje mund të jetë përfshirë më shumë se një armë.
  - f. subjekti nuk ka analizuar elementët përbërës të figurës së veprës penale të moskallëzimit të krimit, ai nuk ka argumentuar se pse jemi përpara kësaj vepre, por është mjaftuar duke deklaruar se për sa kohë shtetasit E.B., K. dhe M. A. ishin në vendgjarrje dhe nuk kanë deklaruar kryerjen e veprës penale nga shtetasi D. B. jemi në kushtet e moskallëzimit të krimit, ndërkohë nga ai nuk është argumentuar se pse të tre këto shtetas kanë marrë pjesë aktive në konflikt.
  - g. subjekti ka përfunduar hetimet pa administruar aktin e ekspertimit teknik për biçakun dhe tehun e thikës të sekuestruar në automjetin e E. B., akti i cili do të përcaktonte nëse këto sende përmbushnin kushtet ligjore të armëve të ftohta dhe për rrjedhojë nëse ishim përpara konsumimit të veprës penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” parashikuar nga neni 279 i K.Penal.

**58.3.4.** Në përfundim, Komisioni, bazuar në konstatimet e mësipërme, i kaloi barrën e provës subjektit: (i) vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq nga subjekti i rivlerësimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna që nuk gjejnë pasqyrim në dosje. (ii) duket sikur subjekti ka shfaqur mungesë të theksuar të aftësive në administrimin e dokumentacionit dhe provave në këtë çështje, duke cenuar besimin e publikut tek drejtësia.

**58.3.5.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se në vlerësimin e tij, po anashkalohej nga Komisioni (i) pavarësia e prokurorit të çështjes në kryerjen e hetimeve dhe qëndrimin e tij në përfundim të hetimeve të kryera; si dhe (ii) konkluzionet e aktit të ekspertimit mjekoligjor, nga del qartë se në trupin e të ndjerit u konstatua vetëm një plagë e shkaktuar me mjet të mprehtë prerës-shpues në gjoksin e tij, pra autori i goditjes me thikë ka qenë vetëm një, e pikërisht D. B. Sipas subjektit, kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim nuk bazohet vetëm në thëniet e të pandehurve K. dhe M.A., por nga shqyrtimi në tërësi i të gjitha provave të tjera. Vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq, është i mirëanalizuar dhe i mbështetur vetëm në provat e administruara përgjatë hetimit, pa anashkaluar asnjërën prej tyre. Për vlerën e thënieve të E. B. del e qartë nga provat shkencore se vdekja e të ndjerit është shkaktuar nga një goditje e vetme me mjet shpues e llojit “thikë”. Sendet e gjetura në makinën e E. B., përveçse nuk

kishin asnjë gjurmë gjaku, për nga përmasat nuk plotësonin kushtet për të shkaktuar plagën përkatëse tek viktimat dhe nuk ishin të përshtatshme për atë kategori dëmtimi trupor në krahë.

Subjekti ka qartësuar se ndryshe nga sa Komisioni ka konstatuar, në dosjen hetimore ndodhet akteksperimenti teknik i objekteve tëh dhe thikë nr. \*\*\*, ku në përfundim të tij eksperti ka konkluduar se biçaku dhe tehu i thikës nuk plotësojnë kushtet teknike të armës së ftohtë.

Nga vendimet e njoftimit të akuzës dhe marrjen në cilësinë e të pandehurve për E.B., K. dhe M. A. del qartë mosveprimi që i ngarkon ata me përgjegjësi penale, pasi duke qenë në vendngjarje, kanë parë gjithë mekanizmin dhe pasojën e rëndë të saj, kishin detyrimin ligjor të paraqiteshin në organet e policisë menjëherë pas ngjarjes e të kallëzonin, por nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

**58.3.6.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga Komisioni në asnjë moment nuk është cenuar pavarësia e subjektit për qëndrimin e tij në përfundim të hetimeve. Komisioni ka konstatuar mangësi procedurale nga subjekti në lidhje me këtë procedim dhe për këto mangësi i ka kaluar barrën e provës. Më konkretisht, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk rezulton të ketë analizuar dinamikën e ngjarjes, me qëllim caktimin e përgjegjësive penale për secilin të pandehur. Ai është referuar vetëm në deklaratimet e shtetasve të përfshirë në konflikt, por pa analizuar provat e tjera, si dhe shkallën e përgjegjësive të secilit prej të pandehurve. Nga ai nuk janë analizuar veprimet aktive të shtetasve K. A., M. A. dhe E. B.

Subjekti nuk ka analizuar elementet përbërëse të figurës së veprës penale të moskallëzimit të krimit, si dhe nuk ka argumentuar se pse jemi përpara kësaj veprë. Subjekti nuk rezulton të ketë analizuar pamjet filmike.

Në përfundim, Komisioni duke marrë në konsideratë dhe pikën 54 të vendimit nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese<sup>65</sup> vlerëson se vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq nga subjekti i rivlerësimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura duke qenë përpara gabimeve thelbësore dhe serioze që tregojnë mungesë të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, konstatuar këto gabime edhe nga gjykata më të larta, por dhe nga prokurori i çështjes që ka zëvendësuar subjektin.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**59.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dosjeve të administruara nga Komisioni dhe denoncimeve të depozituara, trupi gjykues konstaton vetëm në një çështje gabime thelbësore dhe serioze, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjektit. Shkeljet e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale nuk janë të tilla që mjaftojnë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë ato do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

### **Në lidhje me cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë**

**60.** Në vlerësimin tërësor të procedurave, lidhur me cenimin e besimit të publikut<sup>66</sup>, duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë dhe atë profesional për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana, të cilat të analizuar së bashku e të para në harmoni me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit

<sup>65</sup> Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, Gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (*shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias*).

<sup>66</sup> Komisioni u është referuar vendimeve të Kolegjit nr. 26, datë 21.10.2019 dhe nr. 26, datë 15.10.2020.

në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i atij sistemi.

**60.1.** Në këto rrethana, përfshihen problematika e konstatuar në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë, në lidhje me (i) qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka tentuar të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij dhe të personit të lidhur, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit; (ii) fshehjen nga subjekti i ndërtimit të objektit me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>; si dhe (iii) faktet e sjella në vëmendje nga denoncimi dhe të provuara gjatë hetimit administrativ të procedimit penal objekt i denoncimit, pasqyrojnë gabime procedurale që tregojnë mangësi profesionale, mungesë angazhimi dhe përgjegjshmërie në përfaqësimin e interesit publik, që ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e publikut për organet e drejtësisë.

**60.2.** Në vlerësimin e Komisionit, këto rrethana të cituara më lart, do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash, mbi të cilën mund të konkludohej se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që kanë bërë të mundur aplikimin e nenit 61, pikat 3 të ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit.

### **KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

**61.** Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, konkludon se:

**i.** subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji;

**iii.** nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë;

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar z. Tonci Petkovic, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Lulaj.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 13.1.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ**

**Kryesues**

**Alma FASKAJ**

**Anëtar**

**Genta TAFA (BUNGO)**

**Relatore**

**Sekretare gjyqësore**

**Etmonda Hoxha**